

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Viti i 93-të i botimit
Janar-mars 2025 / Nr. 1

Mbrojtja

FORCA, NDERI, ATDHEU

Transformimi i Ushtrisë
Shqiptare në Shekullin

e Ri



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Viti i 93-të i botimit Janar - mars 2025 / Nr. 1

DREJTOR I QKMBMFA

ARBEN SKËNDERAJ

Shefe e Sektorit të Botimeve &

Kryeredaktore

ANJEZA MUSOLLARI

GRAPHIC DESIGNER

AFËRDITA HYSAJ

REDAKTORE / KORREKTORE

SUELA HODA

BASHKËPUNËTORË

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

PROF. ASOC. DR. TEKI KURTI

KOLONEL HYSNI GJERGJI

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të përdoren për qëllime përfitimë, pa marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të Forcave të Armatosura. Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja>



Mbrojtja

SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji: Strategji, Siguri dhe Gatishmëri Operacionale	4
AFA, laborator i formimit të gjeneratës së oficerit, sfidat dhe prioritetet e 2025	12
Forca Tokësore e Shqipërisë: Rugëtimi dhe Arritjet e një Force të Përcaktuar për Mbrojtjen Kombëtare	18
Forca Detare: Një shekull Jetë dhe Pasion në shërbim të Atdheut, drejt transformimit modern	32
Forca Ajrore, 'Shqiponjat' e Shqipërisë: Emblema e fluturimit në Avancimin e Mbrojtjes	40
Policia Ushtarake: Roli, Misioni dhe Sfidat në Sigurinë Kombëtare	46
Strategji, Siguri dhe Lidership: Një Bisedë Ekskluzive me Përfaqësuesin Ushtarak Kombëtar në ACO SHAPE, gjeneralmajor Petrit Çuni	52
16 vjet Shqipëri në NATO: Rugëtimi, Arritjet dhe Sfidat për të Ardhmen	56
Inovacioni dhe projektet Inovative: Sfidat e Kohës përballë Luftërave Hibride	62
"Kurthi i Mjaltit", gracka e inteligjencës ruse në veprim	66
Një lider i madh i çon njerëzit, jo aty ku duan të shkojnë, po aty ku duhet të jenë	70
SHKOLLA legjendë me histori të lavdishme	74
Shkolla Skënderbej dhe drejtuesit e saj	78
Të duash një ushtarak do të thotë të duash një hero të përditshëm!	86
Intervista/ Pa Arkiv nuk ka Histori, pa Histori nuk ka Komb	90

36

**Komanda
Mbështetëse,
Garantimi i
Sigurisë dhe
Efikasitetit
Operacional**

4

**SHSHPFA, gjeneralletenant
Arben Kingji: Strategji, Siguri
dhe Gatishmëri Operacionale**

12

**Akademia e Forcave të Armatosura:
Laboratori i Gjeneratës së Re të
Liderëve të së Ardhmes**

90

**Intervista/ Pa Arkiv nuk ka Histori, pa
Histori nuk ka Komb**

Baza për krijimin e Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, ishin dokumentet me karakter ushtarak të hartuara nga formacionet politike dhe ushtarake të vendit gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, si dhe ato të veprimtarisë së Forcave të Armatosura Shqiptare në dy dekadat...



**Forca Tokësore e Shqipërisë:
Rrugëtimi dhe Arritjet e
një Force të Përcaktuar për
Mbrojtjen Kombëtare**

Faqe **18**



**Forca Detare: Një shekull
Jetë dhe Pasion në shërbim të
Atdheut, drejt transformimit
modern**

Faqe **32**



**Forca Ajrore, 'Shqiponjat'
e Shqipërisë: Emblema e
fluturimit në Avancimin e
Mbrojtjes**

Faqe **40**

Shtabi i Përgjithshëm **2024-2025:**



SHSHPFA,
gjenralejtënant
Arben Kingji

Strategji, Siguri dhe Gatishmëri Operacionale



Revistës “Mbrojtja” i uroj suksese të mëtejshme në rrugëtimin e saj gati shekullor të pasqyrimin të aktiviteteve të Forcave të Armatosura si vlerë historike e saj!

Ju falënderoj për ‘zërin’ që i jepni çdo ‘Force’ në përkushtimin dhe devotshmërinë e tyre të pa kusht. Dhe në këtë fillim të ri të vitit do të sjell për lexuesin tanë një përmbledhje të përpjekjeve dhe arritjeve të FARSH-së për vitin 2024, si dhe fokusin e punës tonë për vitin 2025.

Rishikimi dhe rivlerësimi i planeve, strukturës, prioritetëve dhe dokumenteve që rregullojnë aktivitetin e FA-së është një proces i vazhdueshëm, por që ka marrë domethënie të shtuar për shkak të ndryshimeve në ambientin e sigurisë, i cili sot paraqitet më kompleks dhe më sfidues se para luftës në Ukrainë.

Thënë kjo, është i domosdoshëm rishikimi i dokumenteve strategjike, doktrinave, vlerësimi i kapaciteteve të mbrojtjes, rishikimi i strukturës, si dhe koordinimi me aleatët dhe NATO-n për të përshtatur qasjen e përbaljes me një ambient sigurie në ndryshim e gjithmonë e më sfidues. Qëllimi është që Forcat e Armatosura të RSH të mund të përmbushin më mirë detyrimet në kuadër të mbrojtjes kombëtare dhe në kuadër të mbrojtjes kolektive, pra NATO-s.

Dëshiroj të theksoj këtu se sot mbrojtja e vendit nuk është më një detyrë vetëm e Forcave të Armatosura, por se kërkon përfshirjen dhe koordinimin me të gjitha institucionet e RSH, e thënë ndryshe kërkohet një qasje gjithëpërfshirëse.

Arritjet kryesore të vitit 2024

Më lejoni të ndalem pak në fokusin e punës së FARSH-së dhe arritjet për vitin 2024.

Me vitin 2024, Forcat e Armatosura kanë përmbyllur një kapitull suksesi që është rezultat i përkushtimit dhe punës së palodhur të burrave dhe grave në

uniformë dhe personelit civil përgjatë gjithë zinxhirit të komandimit, nga niveli strategjik deri në atë taktik. Si gjithmonë Forcat e Armatosura kanë qenë të kudogjendura, duke përmbushur me sukses detyrat e kohës së paqes, që kanë në fokus zhvillimin e një force të aftë dhe shumë-misionesh, të ndërveprueshme dhe në modernizim të vazhdueshëm, një force efikase në mbështetje të popullsisë për përballimin e emergjencave civile, dhe një forcë që kontribuon në mënyrë të konsiderueshme dhe cilësore në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO, BE dhe OKB. Në linjë me Direktivën e Mbrojtjes dhe vizionin tim si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, është punuar për rishikimin e dokumenteve strategjike, përmirësimin e paketës ligjore, modernizimin, zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve dhe aftësive operacionale, përmirësimin e sistemit të rekrutimit, përkujdesjen dhe promovimin e ushtarakëve, si dhe konsolidimin e sistemit të arsimit ushtarak.

Rishikimi i dokumenteve strategjike dhe bazës ligjore Në kuadër të rishikimit të dokumenteve strategjike, në vijim të miratimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK), u rishikua Strategjia Ushtarake (SU) e RSH, e cila u miratua nga Kuvendi i RSH, në muajin korrik të vitit 2024. Përpos reflektimit të sfidave të sigurisë, ky dokument strategjik mbështetet në SSK, Strategjinë Ushtarake të NATO-s me dy konceptet e saj të implementimit të DDA-së dhe NWCC-së, si dhe Modelin e Ri të Forcës. Në harmoni të plotë me përqasjen e Aleancës, si dhe me përcaktimet në SSK, Strategjia Ushtarake e RSH i jep një rëndësi të shtuar qëndrueshmërisë, sipas nenit 3 të Traktatit të Uashingtonit.





SU e vitit 2024 përcakton në njërin anë objektivat strategjike politiko-ushtarake, dhe nga ana tjetër nivelin e ambicies së angazhimit të FARSH-së. Në të përcaktohet edhe mbështetja me burime të mbrojtjes, ku përfshihen burimet njerëzore, materiale dhe financiare në dispozicion të FA-së për të realizuar misionin kushtetues dhe detyrimet në kuadrin e mbrojtjes kolektive.

Bashkëpunimi me Bashkimin Europian është një element i shtuar në SU. Kam kënaqësinë të shtoj se bashkëpunimi me BE-në në fushën e mbrojtjes ka filluar mbarë. Forcat e Armatosura vjet përfituan paketën e parë të ndihmës, e cila po përkthehet në mjete taktike të blinduara për njësitë e manovrës. Ndërkohë që këtë vit ne po punojmë për detajimin e projektit për përthithjen e paketës së dytë mbështetëse.

Po ashtu është hartuar dhe miratuar Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FARSH 2024-2033 (PAZHFA 24-33), i cili për nga hierarkia ndjek Strategjinë Ushtarake dhe është dokumenti kryesor që përcakton drejtimit kryesorë ku do të përqendrohet modernizimi me sisteme dhe pajisje, rritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i infrastrukturës së FARSH-it për 10 vitet e ardhshme, duke marrë në konsideratë edhe detyrimet tona ndaj Aleancës. Ky plan ka për qëllim të kthejë objektivat e përcaktuara në Strategjinë Ushtarake në kapacitete dhe aftësi ushtarake në zbatim të misionit kushtetues, detyrave kombëtare dhe detyrimeve në kuadër të NATO-s. Miratimi i këtij plani ka hapur rrugën për strukturat e FA-së që të hartojnë planet e tyre respektivë të detajuara, planin e vendosjes dhe planet mbështetëse sipas fushave.

Strategjia Ushtarake dhe Plani Afatgjatë i Zhvillimit të FARSH-së, do të shërbejnë si bazë për orientimin tonë në motivimin e personelit, rritjen e kapaciteteve ushtarake, si dhe forcimit të mbrojtjes së vendit dhe zhvillimit e modernizimit të mëtejshëm të forcave tona.

Njëkohësisht, janë ndryshuar një sërë ligjesh e vendimesh të Këshillit të Ministrave, të cilat kanë pasur si synim përmirësimin e trajtimit të personelit me pagë, shtesa mbi pagë, përfitimet

për strehim dhe ushqim, si dhe ruajtjen e mbajtjen e disa specialiteteve të veçanta për personelin oficer dhe nënoficer. Këto ndryshime ligjore kanë rritur interesin e të rinjve për t'iu bashkuar Forcave të Armatosura, dhe ne shikojmë rritje të numrit të rekrutimeve dhe përmirësim të mbajtjes në shërbim të personelit.

Në mënyrë specifike theksoj:

Ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014, Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duke përmirësuar situatën aktuale, duke rregulluar balancat, rritur rekrutimet, mbajtjen e personelit dhe duke rritur përgatitjen dhe aftësitë e personelit ushtarak të Republikës së Shqipërisë.

Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9210, datë 23.03.2004, Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura”, i ndryshuar, ku ndryshimet e propozuara synojnë të përmirësojnë statusin e ushtarakut aktiv, në rezervë e lirim në shoqëri, duke kontribuar kështu në rritjen e motivimit për rrjedhojë në rritjen e interesit të të rinjve e të rejave për t'iu bashkuar FA-së në të ardhmen, apo për të vijuar shërbimin. Ligjin nr. 125/2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Forcës Rezerviste në Republikën e Shqipërisë”, i cili do të shërbejë për të siguruar individë të trajnuar, me qëllim kompletimin e strukturës së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ruajtjen e nivelit të gatishmërisë dhe operacionalitetit të kërkuar, si dhe rritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, të nevojshme në rastet e përkeqësimit të gjendjes së sigurisë, si dhe për plotësimin e detyrimeve kombëtare në kuadër të NATO-s, operacioneve në përgjigje të krizave, operacionet e mbështetjes së paqes, sigurisë rajonale e globale, si dhe operacionet e emergjencave civile.

Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 64/2014, Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Nëpërmjet projektligjit synohet saktësimi i fushës

së përgjegjësisë së autoriteteve të drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nivelet e tyre, duke sjellë në përputhje me nevojat e aktivitetit të përditshëm në menaxhimin e Forcave të Armatosura. Përcaktimi i saktë i pushteteve dhe autoriteteve të drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura në kohë paqe dhe në kohë lufte, ndarja e tyre në mënyrë të barabartë, është çelësi i funksionimit të një strukture të armatosur me një mision të rëndësishëm kushtetues.

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 420, datë 26.6.2024 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i cili me ndryshimet e bëra në muajin tetor rriti ndjeshëm trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për ushtarakët e FA-së, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë motivimin e ushtarakëve që aktualisht shërbejnë në FA, por duke rritur edhe rekrutimet në FA.

Modernizimi:

Në vitin 2024 është punuar për të modernizuar Forcat e Armatosura, ku projektet kryesore janë:

Mbrojtja ajrore me rreze të afërt dhe të mesme, e bazuar në tokë; Helikopterë “Black Hawk”; Mbështetje me zjarr ose siç njihet ndryshe Artileri nga 120-155 mm; Sisteme Ajrore pa pilot; Sisteme kundër sistemeve ajrore pa pilot; Sisteme kundër tanke; Konsolidimi i aftësive të mbrojtjes kibernetike; Armatime dhe pajisje individuale më cilësore dhe më të ndërveprueshme me NATO-n; Mjete të blinduara për njësitë e manovrës; Anije patrulluese për Forcën Detare; Sisteme nënujore për detektimin e minave në ujëra të cekëta; sisteme komunikimi taktik.

Me zhvillimin e këtyre kapaciteteve synohen njëkohësisht rritje e fuqisë luftarake, kapacitetet e mbështetjes së luftimit dhe rritje e kapaciteteve të mbështetjes me shërbime të luftimit. Kjo do ta bëjë FARSH-në më të ndërveprueshme dhe më të qëndrueshme për t’i shërbyer vendit.

Struktura e re: Këto përmirësime të kuadrit ligjor janë zhvilluar paralelisht me implementimin e strukturës

së re, e cila ka si qëllim rritjen e kapaciteteve dhe aftësisë mbrojtëse të vendit tonë, për t’u përballur si duhet me sfidat në rritje të mjedisit të sigurisë.

Në mënyrë të përmbledhur, avantazhet e rishikimit strukturor përfshijnë rritje të kapaciteteve luftarake dhe mbështetëse, mbulim më të mirë të territorit me prezencë ushtarake dhe përmirësim i nivelit të reagimit ndaj emergjencave civile.

Industria ushtarake

Në funksion të rivitalizimit të industrisë tonë të mbrojtjes janë marrë disa hapa të rëndësishme, ku vlen të theksohet krijimi i shoqërisë aksionere KAYO, me funksion projektimin, prodhimin, riparimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, të teknologjive dhe pajisjeve ushtarake, uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit, etj. Po ashtu është krijuar Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes.

Emergjencat Civile

Vëmendje e veçantë gjatë vitit që shkoi i është kushtuar angazhimit në kuadër të emergjencave civile, në mbështetje të autoriteteve civile në qarqet e prekura nga zjarret dhe përmytjet, për kryerjen me sukses të operacioneve për shuarjen e zjarreve, operacioneve në ndihmë të komunitetit në zonat e përmytura, apo operacione të ndryshme të emergjencave civile në mbështetje të komunitetit.

Në këtë drejtim, gjatë vitit 2024 FARSH-të kanë kryer 470 operacione, ku në total janë angazhuar 10228 forca, 1758 mjete dhe 2 helikopterë të Forcës Ajrore.

Këtu gjej rastin të shpreh mirënjohjen për punën që secili prej burrave dhe grave në uniformë kanë bërë në përballjen me këto sfida dhe emergjenca, brenda dhe jashtë vendit. Falë këtij personeli dhe bashkëpunimit me strukturat e tjera të Mbrojtjes Civile në nivel qendror dhe vendor, është bërë e mundur mbrojtja e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit nga dëmtimi ose rreziku i dëmtimit, prej këtyre fatkeqësive.



Stërvitjet

Stërvitjet zënë një pjesë të rëndësishme të aktivitetit të Forcave të Armatosura, qofshin ato kombëtare, dypalëshe, shumëpalëshe apo me NATO-n. Ato i shërbejnë testimit të gatishmërisë, rrisin ndërveprueshmërinë dhe testojnë konceptet e reja. Në aspektin kombëtar, dua të theksoj stërvitjen 3-shkallëshe “Përpjekja e Përbashkët 2024”, të zhvilluar në muajin qershor 2024, ku testuam jo vetëm reagimin e forcave aktive por edhe planet e mbrojtjes kombëtare të harmonizuara me ato rajonale të Aleancës.

Ndër stërvitjet shumëkombëshe apo në kuadër të NATO-s, dëshiroj të theksoj pjesëmarrjen në stërvitjet “Breeze 24”, “Brilliant Jump 24”, “Sea Shield 24”, “Able Staff”, CWIX-24, dhe “Steadfast Foxtrot 24”. Në muajin shtator, në bashkëpunim me palën britanike zhvilluam stërvitjen “Austere Wolf 24”, e cila shërbeu për të vlerësuar dhe përmirësuar procedurat dhe kapacitetet e vendit pritës të Shqipërisë, për mbështetjen që mund t’u afrojë forcave të Aleancës që mund të veprojnë ose kalojnë nëpër territorin e vendit tonë.

Infrastruktura ushtarake

Situata e sigurisë e shtjelluar në hyrje të intervistës ka nxitur NATO-n të rivlerësojë strategjinë e saj të shkurajimit dhe mbrojtjes, duke u përgatitur për një mbrojtje kolektive nëpërmjet planeve rajonale në funksion të planëzimit të kapacitete për realizimin e saj. Në kuadër të këtyre planeve, Forcat tona të Armatosura, përveç kontributit në mbështetjen e planeve rajonale të NATO-s, po vijojnë punën për rishikimin e planeve të mbrojtjes kombëtare.

Këto plane, të harmonizuara me planin rajonal të aleancës për Evropën Juglindore do të ndikojnë në forcimin e mbrojtjes kolektive, ulje të kohës së reagimit të Aleancës, ndaj kërcënimeve dhe



rreziqeve të identifikuara në konceptin strategjik të NATO-s të vitit 2022.

Rol të qenësishëm në mbështetje të këtyre planeve luan dhe infrastruktura jonë ushtarake.

Baza Ajrore Kuçovë, tashmë operationale, përveçse do të shërbejë si qendër për dislokimin, trajnimin dhe aktivitetet e Forcave tona Ajrore, ka një rëndësi të veçantë, pasi është pjesë e bazave ajrore taktike të NATO-s. Ajo do të luajë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e operacioneve dhe stërvitjeve të Aleancës, duke u ofruar nga vendi ynë si kapacitetet i

vendit pritës.

Po kështu, i një rëndësie të veçantë është edhe vendimi për të zhvilluar kompleksin Durrës - Porto Romano, i cili së bashku me infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore do të ofrojë një mundësi të mirë për një lidhje të shpejtë ndërmjet detit Adriatik dhe Detit të Zi, duke rritur lëvizshmërinë ushtarake dhe mbështetur zbatueshmërinë e planeve rajonale të NATO-s.

Këtyre projekteve të rëndësishme, do iu shtohen dhe kapacitetet kombëtare të magazinimit në afërsi

të porteve, aeroporteve, dhe korridoreve kombëtare kryesore të lëvizjes, së bashku me zhvillimin e infrastrukturës stërvitore. Këto janë disa nga masat e marra përveç kontributit tonë në misionet e NATO-s, BE-së dhe OKB-së, i cili është rritur në cilësi, në sasi dhe prezencë në rajone të ndryshme, duke demonstruar përkushtimin tonë të palëkundur ndaj sigurisë kolektive, për të adresuar sfidat e përbashkëta të sigurisë në rajon dhe botë.

Bashkëpunimi dhe partneriteti ushtarak

Bashkëpunimi ushtarak, sidomos ai rajonal, përbën një fushë të rëndësishme të politikës së mbrojtjes së Forcave tona të Armatosura. Duke vlerësuar se siguria rajonale është shumë e ndërlidhur me situatën e përgjithshme të mjedisit strategjik të sigurisë, Ballkani Perëndimor luan një rol të rëndësishëm për stabilitetin në zonën Euro – Atlantike. Kjo ka bërë që Shqipëria dhe FARSH-të, t'i konsiderojnë iniciativat rajonale si të domosdoshme për një mjedis të sigurt dhe nxitje të bashkëpunimit e proceseve integruese të vendeve aspiruese të rajonit. Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak, përveç vijimit të bashkëpunimit me aleatët strategjikë dhe NATO-n, vitin që shkoj Shqipëria kryesoi iniciativën rajonale të Shefave të Shtabit të Ballkanit dhe iniciativën SHBA-Karta e Adriatikut (njohur si A-5), duke i shfrytëzuar ato si një mundësi të mirë për të thelluar partneritetet dhe marrëdhëniet ekzistuese dhe kontribuar në krijimin e kushteve drejt një të ardhmeje më të sigurt dhe më të begatë për vendet dhe njerëzit tanë. Ne kemi shfrytëzuar këto forume edhe për të mbështetur Kosovën për t'iu bashkuar iniciativës SHBA-Karta e Adriatikut, si një vend me orientim të palëkundur drejt integritetit Euro Atlantik, duke theksuar vlerën e shtuar që do të sillte Kosova, jo vetëm në këto iniciativa, por dhe në sigurinë dhe stabilitetin rajonal.

Fokusi për vitin 2025

Kemi planifikuar vijimin e përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit ligjor me qëllim mbajtjen

në gatishmëri të një force të motivuar dhe të trajtuar mirë. Po ashtu, do të vijojë konsolidimi i sistemit arsimor ushtarak, ku rëndësi do t'i jepet përmirësimit të programeve mësimore dhe kurrikulave të qendrave stërvitore.

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve të FARSH-së, do të vijojë puna për implementimin e projekteve ekzistuese dhe fillimin e projekteve të reja të modernizimit të FARSH, sipas prioritetëve që si Shef i Shtabit të Përgjithshëm i kam përcaktuar për këtë vit. Qëllimi është orientimi i procesit të modernizimit drejt paketave të plota të kapaciteteve për të përmbushur më së miri nevojat kombëtare dhe detyrimet ndaj Aleancës.

Gjatë vitit 2025, Shqipëria do të jetë pjesë e stërvitjes më të madhe të drejtuar nga Komanda e Ushtrisë Amerikane për Europën dhe Afrikën (US ARMY EUR-AF), "DefenderEurope-25" si një mundësi e shkëlqyer për t'u trajnuar dhe bashkëpunuar me vendet aleate dhe partnere, me qëllim testimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërveprshmërisë me vendet aleate dhe partnere. Në interes të kësaj stërvitjeje, në muajin korrik 2024, Forcat e Armatosura në bashkëpunim me US ARMY EUR-AF, organizuan në vendin tonë Konferencën Kryesore Planëzuese të stërvitjes "DefenderEurope-25", me pjesëmarrjen e 600 përfaqësuesve nga vendet aleate dhe partnere të NATO-s.

Më tej synojmë të realizojmë Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes si një hap të rëndësishëm për të komplementuar efektet pozitive të dokumenteve strategjikë të rishikuar, strukturës së re, komponentit rezervist, si dhe procesit të modernizimit dhe të investimeve në infrastrukturë.

Në lidhje me detyrimet në kuadër të Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s, do të fillojë puna për implementimin e tyre sipas angazhimeve të ndërmarra nga vendi ynë. Gjithashtu FARSH-të do të vijojnë kontributin në operacionet dhe misionet e NATO-s si dhe në strukturat komanduese të Aleancës si një forcë profesioniste e përkushtuar, e besueshme dhe e ndërveprueshme.



Akademia *e Forcave të Armatosura*

AFA AFA

Akademia e Forcave të Armatosura: Laboratori i Gjeneratës së Re të Liderëve të së Ardhmes



**Komandanti i AFA,
Gjeneral Brigade
Bardhyl Nuredinaj**

Akademia e Forcave të Armatosura të Shqipërisë (AFA), ka kaluar nëpër një rrugëtim të gjatë dhe të ndërlikuar që nga themelimi i saj, më 10 maj 1958, duke reflektuar ndryshimet e mëdha në sistemin politik, ushtarak dhe gjeostrategjik të vendit. Në këto 67 vite, AFA ka evoluar nga një shkollë ushtarake me metoda të kohës komuniste në një institucion modern të përgatitjes së oficerëve, i harmonizuar me standardet e NATO-s dhe partnerëve ndërkombëtarë.



Akademia e Forcave të Armatosura të Shqipërisë (AFA), ka kaluar nëpër një rrugëtim të gjatë dhe të ndërlikuar që nga themelimi i saj, më 10 maj 1958, duke reflektuar ndryshimet e mëdha në sistemin politik, ushtarak dhe gjeostrategjik të vendit. Në këto 67 vite, AFA ka evoluar nga një shkollë ushtarake me metoda të kohës komuniste në një institucion modern të përgatitjes së oficerëve, i harmonizuar me standardet e NATO-s dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Rrugëtimi i AFA-së nga themelimi deri sot

1. Periudha e parë (1958 – 1990): Akademia në epokën komuniste 1958 Themelimi i Akademisë së Lartë Ushtarake, si institucioni kryesor për edukimin e oficerëve të Ushtrisë Popullore të Shqipërisë. Edukimi bazohej në modelet sovjetike dhe kineze, me një fokus të madh në ideologjinë marksiste-leniniste.

Programet përfshinin teori ushtarake, strategji mbrojtjeje dhe taktikë luftarake, me theks në mbrojtjen nga një sulm i mundshëm nga Perëndimi.

Stërvitjet ishin kryesisht të fokusuara në luftën guerile dhe mbrojtjen territoriale. Përgatitja e oficerëve bëhej në izolim total nga akademitë perëndimore.

2. Periudha e tranzicionit (1991 – 2009): Riformatimi dhe orientimi drejt Perëndimit Pas rënies së komunizmit, AFA kaloi në

një fazë tranzicioni të vështirë për shkak të ndryshimeve politike dhe shpërbërjes së modelit të vjetër të edukimit ushtarak.

1992: Reforma të mëdha nisën me ndihmën e aleatëve perëndimorë, veçanërisht nga SHBA, Turqia dhe vendet e NATO-s.

1997: Kriza e madhe e shtetit shqiptar dhe shembja e strukturave ushtarake solli nevojën për një rindërtim të plotë të Akademisë dhe sistemit ushtarak.

2000-2009: Shqipëria intensifikoi bashkëpunimin me NATO-n dhe përfshiu trajnime të standardizuara me akademitë perëndimore.

2009: Shqipëria bëhet anëtare e NATO-s, duke e bërë të domosdoshme një harmonizim të plotë të programeve të AFA-së me sistemin e aleancës.

3. Periudha moderne (2010 – Sot): Akademia sipas modelit të NATO-s 2010 – 2025

AFA transformohet në një qendër trajnimi dhe edukimi të standardeve euro-atlantike për oficerët e ardhshëm.

Modernizimi i kurrikulave, përfshirja e trajnimeve ndërkombëtare dhe digjitalizimi i metodave të mësimdhënies e kanë bërë AFA-në një institucion të avancuar.

2023 – 2024: Fillimi i ndërtimit të një kampusi të ri për AFA-në, bazuar në modelin e “West Point” (SHBA).

Kampusi i ri përfshin Qendrën e Simulimit, e cila lejon trajnim të avancuar përmes teknologjisë.

Investime në infrastrukturë moderne, ambiente të reja studimi dhe terrene sportive.

Rëndësia e këtij rrugëtimi

- Nga një akademi ideologjike e epokës komuniste, AFA është shndërruar në një qendër të specializuar për trajnimin e oficerëve sipas standardeve të NATO-s.

- Nga një shkollë e izoluar, është bërë një institucion që dërgon dhe pranon studentë nga akademitë ushtarake më të mira në botë.

- Nga përgatitja për një luftë guerile, sot fokusohet në operacione ndërkombëtare, misione paqeruajtëse dhe siguri globale. Ky evoluim tregon se AFA ka mbetur një institucion kyç për sigurinë kombëtare dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

AFA po kalon nëpër një fazë të rëndësishme modernizimi, duke ndërtuar një kampus të ri, sipas modelit të akademisë prestigjioze amerikane, “West Point”.

Ky kampus i ri, i vendosur pranë “Bunk’art 1”, në një sipërfaqe prej rreth 40,000 metra katrorë, synon të ofrojë mjedise bashkohore për studentët dhe stafin. Projekti përfshin ndërtimin e një kompleksi modern prej 7,000 m², duke përfshirë godinën e re të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, mensën për studentët, ambiente akomo-

duese, terrene sportive, kinoklub, qendër shëndetësore, palestër dhe poligon qitjeje. Një aspekt i rëndësishëm është edhe krijimi i Qendrës së Simulimit, në bashkëpunim me SHBA-në, e cila do të sigurojë trajnimin e forcave në një mjedis të përshtatshëm dhe me kosto më të ulët krahasuar me stërvitjet në terren.

Kjo fazë përfshin përfundimin e godinës së re të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, si dhe mensën për studentët. Më pas, do të vijohet me financimin e fazës së dytë, për të përballuar kapacitetet në rritje, në mënyrë që sezonin e ardhshëm akademik kampusi të jetë plotësisht funksional.

Ky zhvillim reflekton përkushtimin e AFA-së për të ndjekur standardet më të mira të vendeve të NATO-s dhe për të ofruar një edukim cilësor për gjeneratën e re të oficerëve shqiptarë, duke u bazuar në praktikën më të mira të akademive ushtarake ndërkombëtare.

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) ka luajtur një rol të rëndësishëm në përgatitjen dhe formimin e oficerëve të ardhshëm të Ushtrisë Shqiptare. Ky institucion është baza kryesore e edukimit ushtarak dhe profesional të oficerëve të rinj, duke i pajisur ata me njohuri teorike, aftësi praktike dhe një kulturë ushtarake të përputhshme me standardet e NATO-s.

Roli i AFA-së në formimin e oficerëve të ardhshëm

Formimi profesional dhe akademik: AFA u ofron kadetëve një edukim të gjerë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Programet e saj akademike përfshijnë trajnimin në strategji ushtarake, lidërsip, logjistikë, teknologji të mbrojtjes dhe operacione të kombinuara me standardet e NATO-s.

Trajnimi praktik dhe fizik

- Kadetët kalojnë nëpër një regjim të rreptë fizik dhe ushtarak, që synon përgatitjen e tyre për skenarë të ndryshëm operativë.
- Stërvitjet përfshijnë aftësi në qitje, manovra taktike, mbijetesë në terrene të vështira dhe komandim të trupave në kushte lufte ose misionë paqeruajtës.
- Integrimi me NATO-n dhe partneritetet ndërkombëtare.

Pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, AFA ka përmirësuar programet e saj për t'i përshtatur me praktikën e aleatëve.

Oficerët e rinj shpesh dërgohen për shkëmbime studimore ose trajnime në akademi ushtarake ndërkombëtare, si "West Point" (SHBA), "Sandhurst" (Britani), apo akademitë e vendeve partnere.

Përdorimi i teknologjisë dhe simulimeve ushtarake

Me krijimin e Qendrës së Simulimit, kadetët tani kanë mundësi të praktikojnë operacione luftarake dhe vendimmarrje strategjike në një mjedis virtual, duke reduktuar kostot dhe rritur efikasitetin e stërvitjeve.

Ndërtimi i lidërsipit dhe disiplinës ushtarake

AFA nuk formon vetëm ushtarakë, por edhe liderë të ardhshëm që mund të udhëheqin njësi në operacione ushtarake dhe paqeruajtës.


Trajnimi në vendimmarrje, menaxhimin e krizave dhe strategjitë e komandimit, i përgatit ata për sfida të ndryshme të shërbimit aktiv.

Kontributi i AFA në karrierën e oficerëve

Shumë nga oficerët e dalë nga AFA kanë avancuar në pozicione të larta brenda Forcave të Armatosura, duke përfshirë komandantë batalionesh, këshilltarë ushtarakë dhe pjesëmarrës në misionë ndërkombëtare. Oficerët shqiptarë janë angazhuar në operacione të NATO-s dhe OKB-së në vende si Afganistani, Iraku dhe Kosova, duke dëshmuar profesionalizmin e tyre të lartë. AFA është institucioni kryesor që siguron përgatitjen cilësore të oficerëve shqiptarë, duke ndërtuar një forcë të armatosur moderne, të disiplinuar dhe të përgatitur për sfidat e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.







Prioritetet kryesore të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA)

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) ka si mision kryesor përgatitjen dhe formimin e oficerëve të ardhshëm të Ushtrisë Shqiptare, duke e përshtatur edukimin ushtarak me standardet e NATO-s dhe partnerëve ndërkombëtarë. Prioritetet e saj përqendrohen në disa fusha kryesore:

1. Modernizimi i edukimit ushtarak dhe harmonizimi me NATO-n

Përafrimi i kurrikulave me akademitë më të mira ushtarake përfundimtare si “West Point” (SHBA), “Sandhurst” (Britani), dhe akademitë e vendeve të NATO-s; Integrimi i teknologjisë në procesin mësimor, përfshirë simulime taktike dhe strategjike; Trajnimi në operacione të kombinuara dhe ndërkombëtare për të përgatitur oficerët për misione shumëkombëshe.

2. Rritja e kapaciteteve infrastrukturore dhe teknologjike

Ndërtimi i një kampusi të ri modern, me kushte të përmirësuarara për studentët dhe pedagogët; Zhvillimi i Qendrës së Simulimit, ku oficerët e ardhshëm mund të stërviten në skenarë realë përmes teknologjisë dixhitale; Pajisja e akademisë me laboratorë modernë, poligone të avancuara qitjeje dhe terrene stërvitore të standardeve ndërkombëtare.

3. Përmirësimi i lidershipit dhe aftësive strategjike të oficerëve

Zhvillimi i aftësive të lidershipit dhe komandimit, për të krijuar një brez të ri oficerësh të aftë për të udhëhequr në situata komplekse ushtarake dhe civile; Trajnime të specializuara për menaxhimin e krizave, operacionet e sigurisë dhe mbrojtjen kibernetike; Promovimi i një kulture disiplinore dhe etike ushtarake të bazuar në vlerat e NATO-s dhe demokracisë.

4. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe përfshirja në operacione paqeruajtëse

Rritja e shkëmbimeve akademike me akademi të huaja për të mundësuar trajnime të përbashkëta; Angazhimi i oficerëve shqiptarë në misione të NATO-s dhe OKB-së, si në Kosovë, Afganistan dhe Irak; Marrja pjesë në stërvitje ndërkombëtare për të rritur ndërveprimin me forcat e aleatëve.

5. Përshtatja ndaj sfidave të reja të sigurisë

Trajnimi i oficerëve për luftën kibernetike dhe mbrojtjen nga kërcënimet hibride; Zhvillimi i strategjive për mbrojtjen civile dhe ndihmën në rast fatkeqësish natyrore; Përgatitja për operacione të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar.

AFA synon të krijojë një brez të ri oficerësh të aftë, të mirë trajnuar dhe të përgatitur për sfidat moderne të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Me investime në arsim, infrastrukturë, teknologji dhe bashkëpunim ndërkombëtar, AFA po shndërrohet në një qendër elitare të edukimit ushtarak në rajon.



Forca

Tokësore

FORCA TOKËSORE

Forca Tokësore e Shqipërisë: Rrugëtimi dhe Arritjet e një Force të Përcaktuar për Mbrojtjen Kombëtare



**Komandanti i FT,
Gjeneralmajor
Ilir Xhebexhia**

KRIJIMI DHE RRUGËTIMI I FORCËS TOKËSORE

Forca Tokësore e Shqipërisë ka një histori të gjatë që lidhet ngushtë me zhvillimet politike dhe ushtarake të vendit. Ajo u formua si pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë (FARSH) pas shpalljes së pavarësisë, në vitin 1912 dhe ka kaluar nëpër disa faza të rëndësishme:

Krijimi dhe Rrugëtimi i Forcës Tokësore

Forca Tokësore e Shqipërisë ka një histori të gjatë që lidhet ngushtë me zhvillimet politike dhe ushtarake të vendit. Ajo u formua si pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë (FARSH) pas shpalljes së pavarësisë, në vitin 1912 dhe ka kaluar nëpër disa faza të rëndësishme:

- Periudha e Pavarësisë (1912-1920): Pas shpalljes së pavarësisë, Shqipëria nisi përpjekjet për të krijuar një ushtri kombëtare. Për shkak të luftërave të vazhdueshme dhe ndikimeve të huaja, ushtria ishte e vogël dhe e paorganizuar.
- Periudha e Mbretërisë Shqiptare (1928-1939): Gjatë kohës së Mbretit Zog, u ndërmorën disa reforma për të forcuar ushtrinë, por ajo mbeti e varfër në pajisje dhe trajnim.
- Lufta e Dytë Botërore dhe Periudha Komuniste (1944-1991): Pas çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazistë, ushtria shqiptare u ndërtua sipas modelit sovjetik dhe më pas kinez. Në këtë periudhë, ajo arriti fuqinë më të madhe, me mbi 60,000 ushtarë aktivë dhe një rrjet të gjerë bunkerësh mbrojtës.
- Pas Rënies së Komunizmit (1991-2000): Me ndryshimet demokratike, Shqipëria filloi një proces reformash të thella për modernizimin e ushtrisë, duke zvogëluar numrin e personelit dhe duke përqendruar fokusin në standardet e NATO-s.

Arritjet Kryesore të Forcës Tokësore

1. Reformat dhe Anëtarësimi në NATO (2009)

- Shqipëria u anëtarësua në NATO në prill 2009, duke modernizuar strukturat dhe strategjitë e saj ushtarake. Forca Tokësore ka adoptuar standardet e aleancës dhe ka marrë pjesë në operacione ndërkombëtare.

2. Pjesëmarrja në Misione Ndërkombëtare

- Ushtarët shqiptarë kanë marrë pjesë në misione të rëndësishme të NATO-s dhe OKB-së, si:
 - ISAF dhe Resolute Support Mission në Afganistan
 - KFOR në Kosovë
 - Operacione paqeruajtëse në Irak, Bosnje dhe Afrikë





dhe e integruar në NATO. Me investimet në pajisje, trajnim dhe pjesëmarrje në misione ndërkombëtare, ajo vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Forca Tokësore e Forcave të Armatosura të Shqipërisë (FARSH) ka shënuar disa arritje të rëndësishme dhe ka përcaktuar prioritete kyçe për vitin 2025:

Modernizimi dhe rritja e kapaciteteve:

Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2025 është planifikuar të arrijë në 52.7 miliardë lekë, duke përfaqësuar 2.01% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB).

Mbi 50% e këtij buxheti është dedikuar për rritjen e kapaciteteve dhe modernizimin e flotës dhe armatimit në tokë, ajër dhe det.

- Investime në infrastrukturë: Parashikohet vijimi i 62 projekteve infrastrukturore dhe nisja e 8 projekteve të reja, me fokus në përmirësimin e mjediseve të punës dhe objekteve ushtarake.

- Rritja e pagave për personelin ushtarak: Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit është dedikuar për rritjen e pagave të personelit ushtarak, duke përfshirë rritje që shpeshherë arrijnë deri në dyfishim të rrogës, për të përmirësuar mirëqenien dhe motivimin e tyre.

- Zhvillimi i industrisë ushtarake: Synohet ngritja e kapaciteteve në Mjekës, Gramsh dhe Poliçan, si dhe krijimi i Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes, me qëllim gjenerimin e të ardhurave përmes industrisë ushtarake.



Pjesëmarrja në operacionet ndërkombëtare:

Prioritet mbetet zgjerimi i pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s dhe misionet e reja që Aleanca mund të iniciojë, duke rritur përfshirjen e Forcave të Armatosura në skenën ndërkombëtare. Këto masa dhe arritje tregojnë përkushtimin e Forcave Tokësore dhe të gjithë Forcave të Armatosura të Shqipërisë për të përmbushur detyrat e tyre kushtetuese dhe angazhimet ndërkombëtare, duke kontribuar në sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për vitin 2025, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë zgjeruar pjesëmarrjen e tyre në operacione ndërkombëtare, duke kontribuar në misione të rëndësishme për paqen dhe sigurinë globale.

Disa prej angazhimeve kryesore:

1. Operacioni “ALTHEA” në Bosnjë dhe Hercegovinë
Në shkurt të vitit 2025, Shqipëria dërgoi kontingjentin e saj të parë në operacionin e Bashkimit Evropian “ALTHEA” në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ky kontingjent përbëhet nga 30 trupa të Forcave të

Armatosura Shqiptare, të cilët do të shërbejnë për rreth 6 muaj në kampin “Butmir” në Sarajevë. Ata janë integruar me kompaninë e Forcave të Armatosura të Turqisë, duke forcuar bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

2. Rritja e Kontributit në Misionet Ndërkombëtare
Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë rritur ndjeshëm praninë e tyre në misionet ndërkombëtare, duke arritur në një total prej 500 efektivësh të dislokuar në mënyrë permanente jashtë vendit. Këta ushtarë dhe oficerë janë të angazhuar në operacione në Evropë, Afrikë dhe Lindjen e Mesme, duke dëshmuar përkushtimin e Shqipërisë ndaj paqes dhe sigurisë globale.

3. Forca Rezerviste

Në dhjetor të vitit 2024, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin për krijimin e Forcës Rezerviste, e cila synon të përbëjë 20% të forcës aktive në ushtri, ose rreth 2,100 vetë në 5-6 vitet e ardhshme. Ky zhvillim pritet të rrisë fleksibilitetin operacional të Forcave të Armatosura, duke mundësuar mobilizim të shpejtë gjatë krizave ose emergjencave.

Këto angazhime pasqyrojnë përkushtimin e Shqipërisë



për të kontribuar në paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar, si dhe për të forcuar kapacitetet e saj mbrojtëse në përputhje me standardet e partnerëve ndërkombëtarë.

Struktura e Forcës Tokësore të Shqipërisë

Forca Tokësore është komponenti më i madh dhe më i rëndësishëm i Forcave të Armatosura të Shqipërisë (FARSH). Ajo ka pësuar ndryshime dhe modernizime të shumta për t'u përshtatur me standardet e NATO-s dhe për të përmirësuar kapacitetet e saj operacionale.

1. Komanda e Forcës Tokësore (KFT)

Komanda e Forcës Tokësore drejton dhe koordinon të gjitha njësitë tokësore të Shqipërisë. Ajo ka në varësi disa struktura kryesore, duke përfshirë batalione luftarake, logjistike dhe mbështetëse.

2. Njësitë Kryesore të Forcës Tokësore

Brigada e Parë e Këmbësisë (B1K)

- Një nga njësitë kryesore luftarake të Forcës Tokësore.
- E dislokuar kryesisht në Zall-Herr, Tiranë.
- E pajisur me mjete të blinduara, artileri dhe kapacitete mbështetëse.

Batalioni i Dytë i Këmbësisë (B2K)

- Operon në zona të ndryshme të Shqipërisë për mbrojtjen territoriale dhe detyra ndërkombëtare.
- Ka marrë pjesë në misionet paqeruajtëse në Kosovë, Afganistan dhe Bosnjë.

Batalioni i Tretë i Këmbësisë (B3K)

- Njësi elitare me aftësi të avancuara për luftim urban dhe operacione speciale.
- Bazohet në Poshtënjë, Berat.

Regjimenti i Kavalërisë

- Përgjegjës për përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të blinduara dhe autoblivdave J-LTV dhe M1117 të ardhura nga SHBA-të.
- Specializuar në mbështetje të trupave të këmbësisë me forca të mekanizuara.

Batalioni i Mbështetjes së Përgjithshme

- Ofron mbështetje logjistike dhe teknike për njësitë e Forcës Tokësore.

- Përfshin njësinë e transportit, mirëmbajtjes dhe furnizimit.

Batalioni i Xhenios

- Njësi specializuar për operacione inxhinierike, ndërtim urash, çmontim eksplozivash dhe mbështetje infrastrukturore.

- Ka kontribuar në misione të NATO-s dhe BE-së për çminimin e zonave të luftës.

Poligoni dhe Qendra e Trajnimit

- E vendosur në Biza dhe Zall-Herr, përdoret për stërvitje intensive të forcave ushtarake.
- Stërvitje të përbashkëta me forcat amerikane, gjermane dhe turke.

Forca Tokësore e Shqipërisë është një forcë moderne, e adaptuar me standardet e NATO-s, me një strukturë të organizuar për të mbrojtur sovranitetin kombëtar dhe për të marrë pjesë në operacione ndërkombëtare. Rritja e investimeve dhe trajnimet e vazhdueshme kanë përmirësuar ndjeshëm kapacitetet e saj luftarake dhe mbështetëse.









Komanda

Mbështetëse

KOMANDA MBËSHTETËSE

**Komanda
Mbështetëse,
Garantimi i
Sigurisë dhe
Efikasitetit
Operacional**



**Komandanti i KM,
Gjeneral Brigade
Aleksandër Pando**

MISIONI I KOMANDËS MBËSHTETËSE ËSHTË TË MBËSHTESË ME SHËRBIME TË TRUPAVE TË LUFTIMIT, TË LUFTIMIT TË KOMANDAVE NË KOHË PAQE/KRIZE/LUFTE, NË INTERES TË PLOTËSIMIT TË MISIONIT TË TYRE, SI DHE NË OPERACIONE TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE NË MISIONET NDËRKOMBËTARE.



Misioni i Komandës Mbështetëse është të mbështesë me shërbime të trupave të luftimit, të luftimit të Komandave në kohë paqe/krize/luftime, në interes të plotësimit të misionit të tyre, si dhe në operacione të Emergjencave Civile dhe në misionet ndërkombëtare. Disa prej detyrave të saj janë: Të sigurojë në çdo kohë aftësi operationale dhe gatishmëri luftarake në kapacitetet e nevojshme, për t'iu përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit

kushtetues; Të mbështesë aktivitetet e Forcave të Armatosura të RSH me të gjitha klasat e furnizimit (1-5) dhe me shërbime logjistike; Të sigurojë kapacitete të nevojshme operationale për kryerjen e operacioneve luftarake, emergjencave civile, kërkim - shpëtimit, operacioneve humanitare dhe ato në ndihmë të komunitetit në bashkëpunim me strukturat e tjera të FA-së; Të sigurojë kapacitete të nevojshme operationale për përmirësimin e infrastrukturës së

FA-ve të RSH; Të sigurojë kapacitete të nevojshme operacionale për kërkimin, zbulimin, çminimin dhe asgjësimin e municioneve të rrezikshme dhe lëndëve plasëse në operacionet brenda dhe jashtë vendit; Të sigurojë mbështetjen e strukturave të FA-së me riparime, mirëmbajtje të përgjithshme të specializuara të mjeteve motorike tokësore, në operacione brenda dhe jashtë vendit në kohë paqe, krize, lufte e emergjence civile; Të mbështesë me transport strukturat e FA-së brenda dhe jashtë vendit; Të sigurojë mbështetjen shëndetësore të personelit ushtarak aktiv në rezervë dhe pension, familjeve të tyre si dhe punonjësve civil të FA-së;

Të administrojë dhe menaxhojë municionet, armatimin, teknikën dhe pajisjet rezervë të FA-ve të RSH; Të ruajë dhe administrojë materialet, vlerat monetare, pajisjet në përdorim e rezervë, sipas klasave dhe niveleve të furnizimit; Të sigurojë nëpërmjet BCU-së, trajnimin dhe përgatitjen e personelit ushtarak dhe civil për detyra specifike që dërgohen me misione jashtë vendit; Të arsimojë, trajnojnë, stërvitë dhe të kualifikojë oficerët, nënoficerët dhe ushtarët e strukturave të FA-së në specialitetin furnizim, transport, mirëmbajtje, xhenio, personel-administratë, armatim - municion dhe shëndetësi në interes të përmbushjes së misionit të tyre.

Batalioni i Xhenios

Batalioni i Xhenios përbëhet nga Shtabi i Batalionit, i cili ka në përbërje specialistë xhenierë, infrastrukture, EOD, logjistike, operacionesh, zbulimi, ndërlidhje etj. Operacionet xheniere kryen nga Kompania e Punimeve Xheniere nëpërmjet togave të transportit, mjeteve të rënda dhe ndërtimit.

Operacionet EOD planifikohen dhe zhvillohen nga shtabi dhe kompania EOD me përbërje prej 5 togash

EOD.

Detashmenti i Urave është nënreparti, i cili bën të mundur ndërtimin e urave me konstruksion metalik të tipit "Bailey".

Kompania e Mbështetjes është nënreparti që mbështet shtabin dhe nënrepartet e tjera për realizimin e detyrave me shërbime logjistike dhe ato teknike.

Batalioni i Xhenios, përveç operacioneve dhe detyrave për përmirësimin e infrastrukturës ushtarake, është



angazhuar edhe në operacionet e Emergjencave Civile, ku mund të përmendim operacionet për shuarjen e zjarreve në Sazan dhe Mirditë (2022), operacionet, plazhet e pastra ku janë angazhuar forca dhe mjete të batalionit në vijën bregdetare nga Velipoja në Sarandë, operacionet për rehabilitimin e infrastrukturës së dëmtuar nga reshjet në Qarkun Tropojë (2022).



Operacionet EOD që kryen Batalioni i Xhenios janë gjithashtu në interes të mbrojtjes ekologjike dhe mjedisore. Çdo vit kompania EOD asgjëson municione dhe eksplozivë të gjetur në të gjithë Shqipërinë, ku mund të përmendim operacionin aktual për pastrimin nga municionet e paplasura të shtratit të lumit Bënçe në Tepelenë, ku deri tani janë gjetur rreth 40 tonë municione që datojnë nga Lufta e Dytë Botërore.

Pararoja e FA-së në ndihmë të komunitetit, disa prej angazhimeve

Përveç operacioneve që kryen për përmirësim infrastrukturë në Forcat e Armatosura, Batalioni i Xhenios është i angazhuar dhe për ndërtimin e urave tip 'Bailey' nëpër bashki dhe komuna, në zona të thella për të mundësuar përmirësimin e infrastrukturës lokale dhe lidhjen e fshatrave. Gjithashtu ky batalion ka

punuar për përmirësimin e rrugëve dhe infrastrukturës në komunitet. Batalioni i Xhenios ka kapacitetet njerëzore dhe logjistike për realizimin në kohë të këtyre detyrave. Ndërtimi i këtyre urave bëhet në koordinim dhe mbështetje të bashkive ku ndërtohen urat. Për rritjen e kapaciteteve operacionale, Batalioni i Xhenios ka gjeneruar dhe kërkesat operacionale për kompletimin me pajisje dhe teknika aktuale për realizimin e misionit.

Aftësimi i personelit për t'u përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit

Efektivat xhenierë dhe ato EOD (Asgjësimit i Municioneve Eksplozive) angazhohen në detyra që kanë një shkallë rrezikshmërie shumë të lartë për jetën e tyre për të reduktuar dhe eliminuar rrezikun që vjen nga municionet dhe eksplozivët e paplasura që kërcënojnë personelin, instalimet ushtarake, operacionet, popullsinë e pronën, si



brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të operacioneve të NATO-s, BE-së dhe OKB-së. Përveç detyrave dhe operacioneve të shumta EOD, që këta efektiva zgjidhin gjatë gjithë vitit, Batalioni i Xhenios që nga viti 2017 vazhdon angazhimin me një togë EOD në misionin

e NATO-s, efP (Enhanced Forward Presence), Prezenca e Përparuar e Shtuar në Letoni. Për realizimin e misionit EOD për eliminimin e kërcënimeve dhe rreziqeve që vijnë në municionet e paplasura, prioritet për Batalionin e Xhenios ka qenë dhe mbetet trajnimi dhe kualifikimi i personelit EOD me kurset dhe kualifikimet përkatëse. Batalioni i Xhenios mbështet zhvillimin e kurseve EOD në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse, ku zhvillohen kurset EOD Niveli I, II dhe III.

Krahas përmirësimit të infrastrukturës në njësitë dhe repartet e FA-së, Batalioni i Xhenios ka kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës në disa komuna e bashki të vendit për ndërtimin e rrugëve dhe urave mekanike, pastrimin e zonave (hotspot) dhe asgjësimin e municioneve tepër dhe jashtë nevojave të FA-së. Misioni i Batalionit të Xhenios është siguri dhe mbajtja në gatishmëri e kapaciteteve të nevojshme operacionale për kryerjen e operacioneve të emergjencave civile, humanitare dhe ato në ndihmë të popullsisë, mbështetja e strukturave të Forcave të Armatosura për zhvillimin e infrastrukturës, kërkimi, zbulimi, çminimi dhe asgjësimi i municioneve të rrezikshme dhe lëndëve plasëse në operacione brenda dhe jashtë vendit.





Forca
Detare

FORCA DETARE

**Forca Detare:
Një shekull
Jetë dhe
Pasion në
shërbim të
Atdheut, drejt
transformimit
modern**



**Komandanti i FD/RB,
Nënadmiral
Adnand Agastra**

Forca Detare e Shqipërisë (FDSH) ka një histori mbi 100-vjeçare, duke luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e sovranitetit detar dhe interesave kombëtare në ujërat territoriale të Shqipërisë. Nga krijimi i saj në vitin 1925 deri më sot, FDSH ka kaluar nëpër periudha sfidash dhe modernizimi, duke synuar forcimin e kapaciteteve të saj operationale dhe bashkëpunimin ndërkombëtar



Forca Detare e Shqipërisë (FDSH) ka një histori mbi 100-vjeçare, duke luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e sovranitetit detar dhe interesave kombëtare në ujërat territoriale të Shqipërisë. Nga krijimi i saj në vitin 1925 deri më sot, FDSH ka kaluar nëpër periudha sfidash dhe modernizimi, duke synuar forcimin e kapaciteteve të saj operacionale dhe bashkëpunimin ndërkombëtar

Rrugëtimi Historik i Forcës Detare

Fillimet (1925-1944): U krijua si një degë e vogël e ushtrisë shqiptare me disa mjete lundruese të thjeshta. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, marina shqiptare u vu nën ndikimin e forcave pushtuese.

Periudha Komuniste (1945-1990): FDSH u zgjerua ndjeshëm me ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe më pas të Kinës. U pajis me anije luftarake, nëndetëse dhe një infrastrukturë të avancuar për kohën. Pasi Shqipëria doli nga Traktati i Varshavës (1968), marina pësoi një izolim të thellë. Forca Detare e Shqipërisë

ka pasur një histori të pasur me mjete lundruese të ndryshme, që nga periudha e Mbretërisë Shqiptare deri në ditët e sotme. Gjatë dekadave, flota detare është furnizuar me anije nga Bashkimi Sovjetik, Kina dhe më vonë nga vendet e NATO-s.

Disa nga mjetet historike që kanë qenë pjesë e FDSH-së përfshijnë:

Nëndetëset Sovjetike “Projekt 613” (Klasa “Whiskey”)

Periudha e Shërbimit: 1958-1997

- Shqipëria kishte katër nëndetëse të kësaj klase, të dhuruara nga Bashkimi Sovjetik në vitet '50.
- Këto nëndetëse ishin stacionuar në Bazën Detare të Pashalimanit dhe ishin pjesë e flotës më të fuqishme të Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë.
- Pas prishjes me Bashkimin Sovjetik në vitin 1961, Shqipëria i mbajti nëndetëset dhe i përdori deri në vitet '90.
- Sot, një prej tyre është ekspozuar në Pashaliman si



pjesë e trashëgimisë historike detare.

Anijet Luftarake të Klasës “Shangai” (Kineze)

Periudha e Shërbimit: 1965-2000

- Anije patrullimi të prodhuara nga Kina, të përdorura për mbrojtjen bregdetare.
- Kishin armatim të lehtë dhe ishin të përshtatshme për operacione të shpejta në ujërat territoriale.
- FDSH i përdori deri në fillim të viteve 2000, kur u nxorën jashtë shërbimit.

Anijet Torpeduese “OSA-I” dhe “OSA-II” (Sovjetike & Kineze)

Periudha e Shërbimit: 1960-1995

- Anije të vogla sulmuese të pajisura me torpedo dhe raketa kundër anijeve.
- Fillimisht furnizuar nga Bashkimi Sovjetik, më pas u morën versione të tjera nga Kina.
- Të përdorura kryesisht për mbrojtjen bregdetare dhe operacione stërvitore.

Anijet e Transportit “G-124” dhe “G-134” Periudha e Shërbimit: 1970-2000

- Anije transporti të ndërtuara në Kinë, të përdorura për furnizime logjistike dhe transport të personelit ushtarak.
- Kishin kapacitet për të mbajtur trupa dhe pajisje ushtarake në operacione të ndryshme.

Anija e Patrullës “Iliria” (Klasa “Damen Stan” 4207)

Periudha e Shërbimit: 2008 - Sot

- Edhe pse është pjesë e flotës moderne, Iliria është anija e parë e ndërtuar posaçërisht për Shqipërinë nga Holanda.
- Është një nga mjetet më të avancuara të Forcës Detare dhe ka shërbyer në operacionet e NATO-s dhe BE-së për sigurinë detare.

Anijet e Vjetra të Epokës së Luftës së Parë Botërore 1914-1939

Në periudhën e parë të shekullit XX, Shqipëria



kishte disa mjete të vogla lundruese të përdorura nga ushtria austro-hungareze dhe italiane. Pas krijimit të Forcës Detare, më 1925, u përdorën anije të vogla për patrullimin e bregdetit.

Flota historike e Shqipërisë ka kaluar nëpër disa faza, nga pajisjet sovjetike dhe kineze gjatë periudhës komuniste, deri te modernizimi i flotës pas viteve 2000. Sot, shumë nga mjetet historike ndodhen në bazat detare ose janë hequr nga përdorimi, por ato përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të historisë detare të vendit.

Transformimi Pas 1990

Me rënien e komunizmit, shumë mjete dhe baza detare u braktisën ose u dëmtuan. Shqipëria nisi një proces modernizimi dhe riorganizimi të marinës, duke u përqendruar te mbrojtja e kufijve dhe operacionet e sigurisë detare. U anëtarësua në NATO në 2009, duke rritur bashkëpunimin me flotat perëndimore.

Sfidat Kryesore të FDSH

Pajisja dhe Modernizimi: Shumë mjete të flotës janë të vjetra dhe kërkojnë zëvendësim. Ka nevojë për investime në anije patrullimi, sisteme radarësh dhe pajisje të mbrojtjes bregdetare.

Siguria Detare: Trafikimi i paligjshëm i njerëzve, droga dhe kontrabanda janë sfida që kërkojnë monitorim të vazhdueshëm në Adriatik dhe Jon.

Integrimi në Operacione Ndërkombëtare: Si pjesë e NATO-s, Shqipëria ka përgjegjësi për patrullimin dhe ruajtjen e sigurisë në rajonin e Mesdheut Lindor. Infrastruktura dhe Baza Detare: Nevojitet modernizimi i bazave detare, si ajo e Pashalimanit dhe Porto Romanos.

Trajnimi dhe Burimet Njerëzore: FDSH duhet të rrisë kapacitetet e personelit për të operuar me teknologji të reja dhe të marrë pjesë në misione ndërkombëtare.

Objektivat për 2025

Pajisje dhe Teknologji të Reja: Modernizimi i flotës me anije të reja patrullimi dhe sisteme mbrojtëse më

të avancuara.

Bashkëpunim me NATO-n dhe BE-në: Rritja e pjesëmarrjes në operacionet e sigurisë detare dhe misionet e përbashkëta me aleatët.

Përmirësimi i Infrastrukturës: Rindërtimi i bazave dhe modernizimi i sistemeve të komunikimit dhe vëzhgimit detar.


Sigurimi i Kufijve Detarë: Përmirësimi i aftësive për të parandaluar kërcënimet e sigurisë, si trafiku i paligjshëm dhe ndotja detare.

Trajnime dhe Edukim: Programet e reja të trajnimit për personelin, me fokus në operacionet moderne detare dhe teknologjitë e avancuara. Forca Detare e Shqipërisë ka bërë përparime të mëdha në 100 vitet e saj, por për të përmbushur objektivat e 2025-ës dhe të ardhmen, nevojitet një përkushtim i madh për modernizim, bashkëpunim ndërkombëtar dhe përmirësimin e kapaciteteve operacionale. Shqipëria, si pjesë e NATO-s dhe si vend me një pozitë strategjike në Mesdhe, duhet të vazhdojë të investojë në fuqizimin e marinës, për të siguruar sovranitetin dhe sigurinë e ujërave të saj territoriale.

Gjatë historisë së saj, Forca Detare e Shqipërisë ka pasur disa komandantë dhe drejtues të rëndësishëm që kanë luajtur një rol kyç në zhvillimin dhe modernizimin e saj.

Disa nga Komandantët e Forcës Detare Shqiptare

1. **Gjeneralmajor Kudret Çela** – Një nga komandantët që ka drejtuar Forcën Detare gjatë periudhës së tranzicionit pas viteve '90, duke kontribuar në rimëkëmbjen e saj.
2. **Gjeneralmajor Ylber Dogjani** – Ka shërbyer në një periudhë kyçe të modernizimit dhe integritetit të FDSH në NATO.
3. **Gjeneral brigade Edmond Hoxha**, një tjetër figurë e rëndësishme që ka udhëhequr përmirësimin e kapaciteteve operacionale të marinës shqiptare.
4. **Gjeneral brigade Artur Meçollari**, ka pasur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e strategjive të mbrojtjes detare dhe në bashkëpunimin me NATO-n dhe BE-në.
5. **Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia**, i angazhuar në përmirësimin e mbrojtjes bregdetare dhe sigurisë detare.



6. Kundëradmiral Adnan Agastra mori detyrën e Komandantit të Forcës Detare të Shqipërisë në dhjetor të vitit 2021. Gjatë drejtimit të tij, ai ka synuar disa objektiva kyçe për modernizimin dhe forcimin e kapaciteteve detare të vendit:

- **Modernizimi i Flotës Detare:** Ka punuar për përmirësimin dhe pajisjen e flotës me mjete më moderne dhe të afta për të përballuar sfidat e sigurisë detare bashkëkohore.
- **Rritja e Bashkëpunimit Ndërkombëtar:** Ka thelluar marrëdhëniet me forcat detare të vendeve aleate dhe partnere, veçanërisht në kuadër të NATO-s, për të forcuar sigurinë dhe stabilitetin në rajonin e Adriatikut dhe Jonit.
- **Përmirësimi i Trajnimit dhe Stërvitjes:** Ka ve-



ndosur theks të veçantë në ngritjen e kapaciteteve njerëzore përmes programeve të avancuara të trajnimit dhe stërvitjeve të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë.

- **Siguria dhe Mbrojtja e Kufijve Detarë:** Ka intensifikuar përpjekjet për monitorimin dhe mbrojtjen e ujërave territoriale shqiptare nga kërcënimet e ndryshme, duke përfshirë trafikimin e paligjshëm dhe aktivitete të tjera të jashtëligjshme.

Disa prej Operacioneve Kryesore të Forcës Detare të Shqipërisë

Forca Detare e Shqipërisë (FDSH) ka qenë aktive në disa operacione kombëtare dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në sigurinë detare, misionet humanitare dhe operacionet e NATO-s. Disa nga operacionet më të rëndësishme përfshijnë:

Operacionet e NATO-s dhe BE-së Operacioni “Sea Guardian” (Deti Mesdhe, pas 2016)

- FDSH ka marrë pjesë në këtë operacion të NATO-s për patrullimin dhe sigurinë detare në Mesdhe.
- Qëllimi kryesor është parandalimi i trafikimit të paligjshëm, terrorizmit dhe rreziqeve të tjera detare.
- Anijet shqiptare patrullojnë dhe raportojnë për aktivitete të dyshimta.

Operacioni “Active Endeavour” (2001-2016)

- Operacion i NATO-s kundër terrorizmit detar pas sulmeve të 11 Shtatorit 2001.
- FDSH ndihmoi në monitorimin e trafikut detar në Mesdhe për të parandaluar aktivitete të paligjshme.

Operacionet e BE-së “Eunavfor Med”

- FDSH ka qenë pjesë e misioneve të BE-së për ndalimin e trafikimit të emigrantëve në Mesdhe dhe parandalimin e rrjeteve kriminale që operojnë në ujërat ndërkombëtare.

Operacione të Sigurisë dhe Luftës Kundër Trafikimit

Monitorimi i Ujërave Territoriale

- Forca Detare patrullon detin Adriatik dhe Jon për të parandaluar trafikun e drogës dhe emigracionin e paligjshëm.
- Ka bashkëpunim të ngushtë me FRONTEX, NATO-n dhe autoritetet italiane për ndjekjen e rrjeteve të kontrabandës.

Operacioni Kundër Trafikimit të Drogës (Shqipëri-Itali, 2014 e në vazhdim)

- FDSH ka luajtur një rol kyç në ndalimin e gomoneve që transportonin drogë nga Shqipëria drejt Italisë.
- Përdorimi i anijeve patrulluese dhe bashkëpunimi me GUARDIA DI FINANZA ka ndihmuar në uljen e ndjeshme të trafikimit detar.

Operacione Humanitare dhe Shpëtimi në Det

Ndihma Pas Tërmetit të 26 Nëntorit 2019

- Anijet e FDSH-së u angazhuan për transportin e ndihmave dhe personelit në zonat e prekura nga tërmeti. Shpëtimi i Emigrantëve në Det (vitet e fundit)
- FDSH ka ndihmuar në shpëtimin e emigrantëve dhe refugjatëve që kanë mbetur në ujërat e hapura të Mesdheut.

Operacionet e Kërkim-Shpëtimit në Adriatik

- FDSH ndërhyr në raste emergjencash për të ndihmuar anijet civile në rrezik, si përmbytje apo aksidente detare.

Mbrojtja e Infrastrukturës Strategjike Sigurimi i Rafinerisë së Porto Romanos dhe Bazës së Pashalimanit

- FDSH ka detyrën të mbrojë infrastrukturën kritike detare të Shqipërisë nga kërcënimet e mundshme.

Patrullimi në Zonat Ekskluzive Ekonomike (ZEE)

- Për të mbrojtur burimet natyrore dhe për të parandaluar shkeljet nga anije të huaja.

Forca Detare e Shqipërisë ka luajtur një rol aktiv në sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në luftën kundër krimit të organizuar, operacionet humanitare dhe sigurinë detare në Mesdhe. Me modernizimin e vazhdueshëm dhe integrimin e saj në misionet e NATO-s dhe BE-së, FDSH po bëhet një forcë gjithnjë e më e rëndësishme në rajon.







Forca
Ajrore

FORCA AJRORE

**Forca Ajrore,
'Shqiponjat'
e Shqipërisë:
Emblema e
fluturimit në
Avancimin e
Mbrojtjes**



**Komandanti i FAj,
Gjeneralmajor
Ferdinand Dima**

Përpjekjet për të futur aviacionin në shërbim të ushtrisë kanë qenë të hershme, që në vitin 1921, por me gjithë përpjekjet e dëshirat e drejtuesve të lartë ushtarakë, kjo gjë u mundësua vetëm pas çlirimit të vendit tonë.

Përpjekjet për të futur aviacionin në shërbim të ushtrisë kanë qenë të hershme, që në vitin 1921, por me gjithë përpjekjet e dëshirat e drejtuesve të lartë ushtarakë, kjo gjë u mundësua vetëm pas çlirimit të vendit tonë. Data zyrtare e krijimit të Aviacionit Luftarak Shqiptar është, 24 prill 1951, dita kur piloti Peço Polena realizoi fluturimin me avionin e parë luftarak shqiptar të montuar dhe të përgatitur nga specialistët e vendit tonë, i cili ishte avion me helikë, me motor me djele të brendshme, të cilët për kohën ishin mjaft efikas. Ky fluturim historik u realizua në Aerodromin e Laprakës, Tiranë.

Kjo armë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, pësoi ndryshime, transformime dhe modernizime të vazhdueshme, duke u pajisur me teknikën luftarake moderne të kohës dhe duke ngritur disa reparte të tjera të aviacionit Ushtarak.

Konkretisht, pas aerodromit të Laprakës, u krijuan edhe këto reparte të bazës ajrore: Reparti i parë i Aviacionit reaktiv në maj 1955 në Kuçovë; Regjimenti i aviacionit i Rinasit, në korrik 1959; Shkolla e Lartë e Aviacionit, e cila u hap në maj 1962 në Vlorë; Regjimenti i Helikopterëve, në dhjetor 1967, në Farkë dhe Baza Ajrore e Gjadrit në Shkurt 1974, e cila ishte një bazë tërësisht e tunelizuar dhe kishte dy skuadrilje MIG-19 dhe një skuadrilje MIG-21.

Aviacioni Luftarak Shqiptar në atë kohë numëronte mbi 200 avionë e helikopterë, të cilët ishin të prodhimit lindor dhe operonin në të gjithë bazat ajrore të vendit tonë.

Misioni, struktura dhe detyrat e Forcës Ajrore?

Misioni i Forcës Ajrore është sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për mbrojtjen e sovranitetit të hapësirës ajrore të Republikës Shqipërisë në bashkëpunim me strukturat e NATO-s, mbështetja ajrore taktike për operacionet luftarake e jo luftarake të FA-së dhe NATO-s, sigurimi i shërbimit meteorologjik, sigurimi i shërbimit të kërkim-shpëtimit ajror dhe transportit të personaliteteve të larta shtetërore.

Misioni i Forcës Ajrore realizohet nëpërmjet strukturave të saj përbërëse, siç janë: Qendra e Kontroll-Raportimit, e cila ka për detyrë vëzhgimin, monitorimin e hapësirës ajrore si dhe paralajmërimin në kohë për rrezikun ajror; Baza Ajrore Farkë, e cila është baza kryesore operationale, Baza Ajrore Kuçovë, e cila ka shërbyer si bazë mbështetëse për zhvillimin e stërvitjeve ajrore të përbashkëta dhe së fundmi do të rritet roli i saj si një bazë ajrore taktike

e NATO-s, Shërbimi Meteorologjik Ushtarak, i cili mbulon me parashikim të motit, të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe Qendra Stërvitore, e cila është një strukturë e rëndësishme arsimore që shërben për zhvillimin e kurseve institucionale dhe profesionale të personelit të Forcës Ajrore.

Baza Ajrore e Kuçovës, një aset i FA-së - Krijimi dhe roli i saj si bazë taktike e NATO-s

Baza e Kuçovës ishte reparti i parë i Aviacionit me avionë reaktivë, e cila u krijua, më 15 maj 1955, dhe fillimisht përbëhej nga dy skuadrilje avionësh reaktiv Mig-15. Në korrik të vitit 1957, për herë të parë në këtë pistë u ul avioni bombardues "IL -28", i cili hyri në armatimin e Aviacionit tonë Luftarak.

Vetëm 2 vjet pas krijimit të regjimentit, në Kuçovë, filloi përgatitja e pilotëve të klasit të parë. Në këtë bazë janë stërvitur dhe janë kualifikuar të gjithë pilotët e Forcës Ajrore, të cilët, pas përfundimit të shkollës së aviacionit, shkonin dhe kryenin qindra orë fluturimi me avionët e kësaj baze, ditën dhe natën, në kushte të ndryshme meteorologjike. Vit pas viti regjimenti (baza ajrore) filloi të modernizohet, ku në vitin 1966 u pajis edhe me një skuadrilje avionësh të tipit MIG-17. Në të njëjtin vit, gjithashtu në këtë bazë ajrore, filluan punimet për ndërtimin e Uzinës së Riparimit të Avionëve (URA). Riparimi kapital i motorëve në Uzinën e Aviacionit, përbën një moment historik për kohën, pasi hapi rrugën e vazhdimit intensiv të stërvitjes së pilotëve, si dhe forcimin e gatishmërisë luftarake në repartet e aviacionit luftarak shqiptar.

Uzina e Riparimit të Aviacionit, përveç se ishte në gjendje të kryente riparimet e nivelit të tretë për avionët UTI MIG-17, AN-2, JAK-18, njëkohësisht mbështeti edhe riparimin e pajisjeve të reparteve të Mbrojtjes Ajrore, radiolokacionit dhe raketave, pasi në URA kishte pajisje dhe teknikë moderne si dhe laboratorë e makineri bashkëkohore. Uzina shërbeu deri në dhjetor të vitin 2004, e cila daton dhe me mbylljen e fluturimeve me avionët me krah fiks.

Modernizimi i bazës Ajrore Kuçovë përmblodh rristurimin dhe ndërtimin e një sërë projektesh që janë të domosdoshëm për funksionimin dhe operacionalitetin e një baze taktike ajrore.

Këto projekte kanë të bëjnë më së shumti me përmirësim dhe modernizim të infrastrukturës ekzistuese dhe të aseteve, që kjo bazë i ka trashëguar nga e kaluara.



Konkretisht në këtë bazë do të zbatohen projektet e mëposhtme:

- Rikonstruksioni i pistës ekzistuese, ndërtimi i shesheve të armatim-çarmatimit, ndërtim i shesheve të parkimit të avionëve si dhe ndërtim i taxiway
- Sistemi i furnizimit dhe shpërndarjes së karburantit të avionëve
- Ndërtimi i depove të armatim-municionit
- Ndërtimi i stacionit të mbrojtjes nga zjarri
- Rikonstruksioni i Kullës së Kontrollit

Mbështetja jonë për modernizimin e kësaj baze është në nivelin maksimal dhe po punohet me të gjithë kapacitetet e mundshme njerëzore dhe logjistike me palët e kontraktuara nga Aleanca (nëpërmjet Agjencisë së Prokurimeve dhe Mbështetjes së NATO-s (NSPA)), për realizimin e të gjithë projekteve sipas afateve të vendosura nga kjo e fundit. Krahas investimit të NATO-s edhe qeveria shqiptare ka akorduar fonde për ta sjellë këtë bazë në të gjitha parametrat dhe standardet e një baze taktike ajrore të NATO-s. Mund të përmendim këtu projektin për ndërtimin e perimetrit të sigurisë apo projektet për sistemin e furnizimit me ujë dhe sistemin e furnizimit me energji elektrike të saj. Pista e Bazës Ajrore të Kuçovës ka një gjatësi prej 2800 ml, dhe gjerësi prej 60 ml. Kjo pistë është ndërtuar me ndihmën dhe eksperiencën e specialistëve të huaj, me të cilët kemi pasur bashkëpunim në kohën që është ndërtuar dhe ka pësuar rikonstruktime të mëvonshme, duke rritur parametrat e saj dhe siguruar ulje të avionëve ushtarakë taktikë gjuajtës-bombardues si dhe



avionëve ushtarakë transporti të tonazhit të mesëm.

Sipërfaqja e përgjithshme e Bazës Ajrore të Kuçovës është afërsisht 280 hektarë. Kjo bazë ka vazhduar të ruhet dhe administrohet, si një aset shumë i rëndësishëm dhe i vyer për Forcat e Armatosura dhe kryesisht për Forcën Ajrore. Atje, aktualisht, ruhen në tunelet përkatëse avionët luftarakë të tipit Mig, të cilët janë konservuar, nuk janë më në gjendje operationale dhe janë për t'u trajtuar si skrap.

Për zbatimin e suksesshëm të misionit dhe detyrave të Forcave Ajrore, është i rëndësishëm një personel ushtarak dhe civil i trajnuar mirë, i aftë ushtarakisht dhe profesionalisht

Realizimi i misionit të Forcës Ajrore kërkon angazhimin e një sërë strukturash dhe një



numër të konsiderueshëm personeli të trajnuar për kryerjen e detyrave të ndryshme speciale. Konkretisht Forca Ajrore kryen detyrat në përbushje të misionit të saj kushtetues dhe realizon mbulimin Ajror të Hapësirës Ajrore Shqiptare në bashkëpunim edhe me strukturat operationale të NATO-s, në mënyrë të pandërprerë dhe me rigorozitet.

Ajo realizon zbulim të pandërprerë të Hapësirës Ajrore Shqiptare, kryen transport të trupave dhe grupeve taktike ushtarake operationale, luan një rol kryesor në përballimin e Emergjencave Civile në çdo kohë në detyra të ndryshme si në transportin nga ajri të të sëmurëve rëndë apo të plagosurve nga zona të largëta të vendit tonë, në transportimin nga ajri të ndihmave emergjente në zona të izoluar nga bora, në evakuimin nga ajri në zonat e përmytura, në shuarjen e zjarreve në pyje, kullota etj.

“Arsimimi e mëson individin se si të mendojë, kurse trajnimi, se si të veprojë për ta realizuar”. Në këtë kuadër, sa e rëndësishme është stërvitja dhe a i kemi në mbështetjen në burimet logjistike dhe kapacitet njerëzore për ta realizuar me efikasitet këtë proces?

Trajnimi dhe stërvitja është procesi më i rëndësishëm dhe i pandarë për çdo pjesëtar të Forcave të Armatosura, që të mbajë dhe të përmirësojë aftësitë e fituara. Trajnimi i personelit të Forcës Ajrore, është detyrë e Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore, Kuçovë, e cila nëpërmjet kurseve institucionale dhe funksionale, realizon rritjen e profesionalizmit të

personelit sipas specialiteteve si teknikë mirëmbajtje për helikopterët, kontrollor të trafikut ajror, operator të shfrytëzimit të radarit dhe specialistë parashikues moti. Personeli trajnuar i Qendrës Stërvitore, është një staf i mirë kualifikuar, i cili i jep personelit që trajnohet në këtë qendër njohuritë e duhura për të përballuar detyrat dhe sfidat për realizimin e misionit të Forcës Ajrore si dhe i pajis ata edhe me të reja që koha sjell për armën e aviacionit. Për sa i përket mbështetjes logjistike siç dihet tashmë, ekzistojnë disa vështirësi në drejtim të mirëmbajtjes së mjeteve ajrore, pasi flota jonë ajrore përbëhet nga një shumëllojshmëri tipash të helikopterëve dhe secili prej tyre kërkon specialistë të veçantë për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Gjithsesi me mbështetjen e MM dhe SHP, janë realizuar të gjitha procedurat përkatëse për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes pranë kompanive të huaja jashtë vendit, të cilat janë të certifikuar për kryerjen e shërbimeve të niveleve të larta nga kompanitë prodhuese të helikopterëve.

16-vjetori i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe roli i vendit tonë në Aleancë

Përzgjedhja që Aleanca i ka bërë vendit tonë për të bashkëpunuar në drejtim të transformimit të Bazës Ajrore të Kuçovës, si Bazë Ajrore Taktike të saj, e tregon më së miri besueshmërinë që ofron vendi ynë në drejtim të stabilitetit dhe sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu del në pah bashkëpunimi serioz dhe i qëndrueshëm, që Forcat e Armatosura kanë treguar dhe vazhdojnë të tregojnë me Aleancën nëpërmjet misioneve ushtarake që kemi realizuar dhe që vazhdojmë të realizojmë. Shqipëria ka treguar se anëtarësimi i saj në organizatën më të madhe politiko-ushtarake, ishte një arritje me meritë dhe një vlerësim serioz që vendi ynë i bën nismave të tilla të rëndësishme për vendin dhe të ardhmen e tij. Gjatë këtyre 16 viteve që Forcat e Armatosura aderojnë në NATO, është parë se si ushtarakët tanë janë rreshtuar me dinjitet dhe profesionalizëm në krah të ushtarakëve të vendeve më të përparuara, duke marrë pjesë në shumë operatione dhe stërvitje të përbashkëta. Shqipëria, si anëtare me të drejta të plota në NATO, qysh prej vitit 2009, ka përgjegjësitë dhe detyrat e saj për të kontribuar në misionin dhe detyrat e kësaj organizate politiko-ushtarake, për mbrojtjen dhe sigurinë rajonale dhe më gjerë. Konkretisht, vendi ynë ka kontribuar prej vitesh, në

shumë misione dhe operacione të ndryshme që ka organizuar NATO, si në Afganistan, Irak, Gjeorgji, Letoni, Kosovë etj.

NATO ka përzgjedhur për të bashkëpunuar me ne, pasi tashmë Shqipëria është një vend partner që ka treguar dhe vazhdon të tregojë besueshmëri, stabilitet, qëndrueshmëri dhe seriozitet në bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh.

Shqipëria si një vend i vogël dhe me kapacitete modeste ushtarake, ka kontribuar në NATO nëpërmjet pjesëmarrjes së personelit ushtarak në misione të ndryshme ushtarake dhe paqeruajtëse, me ekspertizë specialistësh për trajnim dhe stërvitje ushtarakësh si dhe me specialistë për demilitarizimin e zonave të minuara në disa zona të nxehta të rajonit dhe më gjerë. Edhe ristrukturimi e modernizimi i Bazës Ajrore Kuçovë, në bashkëpunim me NATO-n dhe kthimi i saj në një Bazë Ajrore Taktike të NATO-s, tregon angazhimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë për përmbushjen e detyrimeve që vendi ynë ka ndaj kësaj organizate. Ristrukturimi dhe modernizimi i Bazës Ajrore të Kuçovës, ka rëndësi të madhe për vendin tonë pasi e rendit Shqipërinë në krah të vendeve anëtare që kanë më shumë potenciale, resurse dhe kapacitete ushtarake. Gjithashtu kjo bazë, ka një rëndësi të madhe për NATO-n, pasi ajo do të rrisë aftësitë operacionale të saj, për të operuar me më shumë efektivitet në çdo nevojë të mundshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë si dhe do të shërbejë për trajnimin dhe stërvitjet e përbashkëta të ushtarakëve tanë me ato të NATO-s.

Objektivat e Forcës Ajrore dhe roli i saj në këtë bashkëpunim

Forca Ajrore ka në objektivat e saj kompletimin edhe me mjete të tjera ajrore krahas atyre që kemi aktualisht. Ardhja e helikopterëve “Black Hawk”, e vendos personelin fluturues përballë dhe përkrah kolegëve të Aleancës dhe do t’i angazhojë ato për rritjen e përkushtimit dhe vlerësimit që i duhet bërë trajnimit dhe stërvitjes me mjetet ajrore të gjeneratës moderne, siç janë helikopterët “Black Hawk”. Gjithashtu, prioritet i rëndësishëm për Forcën Ajrore është edhe ulja e moshës mesatare të pilotëve aktualë, duke trajnuar një numër të konsiderueshëm oficerësh me moshë të re për t’u bërë pilotë të helikopterit ushtarak.

Pse të rinjtë shqiptarë duhet të bëhen pjesë e Forcave Ajrore?

Të rinjtë shqiptarë duhet të njihen me avantazhet e të qenit pjesë e Forcave të Armatosura nëpërmjet fushatës sensibilizuese për rekrutimet në FA. Angazhimi dhe përfshirja e tyre në FA do t’i jepte atyre, mundësinë e fitimit të një profesioni, do t’i siguronte atyre të ardhura mbi mesataren, të krahasuara me pozicionet e tjera të punës në fushat jashtë FA-së, do t’i përgatiste ata për t’u përballuar me vështirësitë dhe do t’i bënte më të fortë e më të durueshëm për përballimin e problematikave të ndryshme.

Gjithashtu përfshirja e të rinjve tanë, në radhët e FA-së, do t’i jepte atyre mundësinë e njohjes dhe bashkëpunimit me kolegët e vendeve të ndryshme të



Aleancës dhe jo vetëm, me njohjen e përmirësimit e komunikimit në gjuhët ndërkombëtare dhe sprovimin e përdorimit të tyre në jetën praktike.

Të rinjtë shqiptarë duhet ta shikojnë me prioritet që të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura, veçanërisht në radhët e Forcave Ajrore, pasi është edhe më tërheqëse, duke qenë se kemi të bëjmë me një forcë në zhvillim të vazhdueshëm, që ka në përdorim teknikë dhe pajisje të reja e moderne, të cilat kërkojnë përkushtim dhe të japin kënaqësi në përdorimin e tyre.



Policia

Ushitarake

POLICIA USHTARAKE

Policia Ushtarake: Roli, Misioni dhe Sfidat në Sigurinë Kombëtare



**Komandanti i Policisë Ushtarake,
Nënkolonel
Dhimitër Selmanaj**

Policia Ushtarake festoi 33-vjetorin e krijimit të saj. Përgjatë 33 viteve të historisë së saj, Policia Ushtarake ka treguar se është një nga repartet elitë të Forcave tona të Armatosura.

Ruajtja e rendit ushtarak, garantimi i zbatimit të ligjit, angazhimi në luftën kundër terrorizmit dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse e humanitare, janë misioni kryesor i kësaj njësie.



Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura u formua, më 1 shkurt 1992. Pas viteve '90, ashtu si në të gjithë vendin, edhe në FA u kryen një sërë reformash, ndër to: miratimi i akteve ligjore, nënligjore, si dhe ndryshime strukturore, ku pjesë e këtyre ndryshimeve ishte dhe krijimi i Policisë Ushtarake (PU) në përbërje të FA-së.

Formimi i kësaj strukture kishte si qëllim forcimin e rregullit dhe të disiplinës në FA dhe u pa si domosdoshmëri për transformimin e ushtrisë, sipas standardeve të vendeve të NATO-s. Me krijimin e PU-së, objekti i punës së saj ishte kontrolli i trafikut ushtarak, ruajtja e rendit ushtarak në FA, me synim forcimin e disiplinës ushtarake në FA.

Në dhjetor të vitit 1994, me Urdhër nr. 482, datë 10.12.1994 të MM, "Për organizimin e Policisë Ushtarake", strukturës së PU-së iu bashkëngjiti struktura e Policisë Kriminale dhe ajo e Mbrojtjes nga Zjarri. Në fillim të vitit 1995 u transformua në drejtori të PU-së, me drejtor gjeneral brigade Bajram Malaj. Me mbështetje ligjore, nënligjore si dhe me profesionalizëm gjithnjë në rritje, PU u radhit ndër repartet më të mira të FA-së.

Pas ngjarjeve të vitit 1997, PU pati një rritje të jashtëzakonshme mbi bazën e një projekti me Delegacionin Italian të Ekspertëve (DIE), për herë të parë, me asistencën e specialistëve italianë u krijua batalioni i PU-së në Tiranë, i cili u kompletua me bazën materiale e logjistike të nevojshme dhe u konceptua sipas modelit të batalioneve të karabinierisë italiane. Krijimi i batalionit të PU-së në Tiranë, shënon një hap cilësor në veprimtarinë e kësaj strukture moderne dhe nga më cilësore të kohës, gjë që u duk qartë në ngjarjet e vitit 1998, kur PU-ja jo vetëm që nuk u dëmtua por ajo mori në ruajtje disa nga institucionet kryesore të shtetit si: Radio-Televizioni Shqiptar, Telekomin, Prokurorinë e Përgjithshme si dhe disa institucione ndërkombëtare.

Në këtë periudhë, PU ishte një nga institucionet e pakta moderne që ishte ndërtuar deri në atë kohë dhe që ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm në rivendosjen e shtetit ligjor në Shqipëri.

Kompletimi i batalionit të PU-së në Tiranë, me teknikën e nevojshme dhe automjete të blinduar tip IVECO-90, luajti një rol të jashtëzakonshëm në ngjarjet e vitit 1998 në Shqipëri. I pamohueshëm mbetet roli i kësaj strukture në vitin 1999, në kohën e krizës së Kosovës, ku PU mbajti peshën kryesore në pritjen, shoqërimin, trajtimin e refugjatëve pranë kampingeve të ngritura në Kukës, Tiranë, Durrës dhe qytete të tjera të vendit, mbajtjen nën kontroll të situatës në zonat Kukës, Krumë, Tropojë, sidomos pranë postave kufitare, duke zgjidhur mjaft



situata të vështira, shoqërimin e mjaft autokolonave dhe personaliteteve që lëviznin për në veri dhe kthim, si dhe mbajtjen nën kontroll të rrjetit rrugor në të gjithë vendin e veçanërisht në veri. Ngjarjet e vitit 1997, 1998 dhe ato të krizës kosovare janë ngjarjet më të rëndësishme në historinë e PU-së.

Për kryerjen e këtyre detyrave, PU u mbështet dhe në miratimin e Ligjit nr. 8404, datë 15.09.1998, për një shtesë në Ligjin nr.7978, datë 26.07.1995, "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Në fund të vitit 2000, me suprimimin e strukturës së Drejtorisë së Policisë Ushtarake, me Urdhër nr.1, datë



05.01.2001të MM, “Për organizimin e regjimentit të Policisë Ushtarake”, u krijua regjimenti i PU-së me komandant nënkolonel Namik Goga. Kjo strukturë e ushtroi aktivitetin e saj deri në shtator të vitit 2003, duke bërë ruajtjen dhe sigurimin e të gjitha stërvitjeve që zhvilloheshin në territorin e vendit tonë.

Në shtator të vitit 2003, kjo strukturë u transformua në strukturën e batalionit me qendër në Tiranë, me komandant batalioni nënkolonel Xhevahir Abdia, i cili e ushtroi detyrën deri në vitin 2005. Në vitin 2005 komandant batalioni u emërua nënkolonel Drini Nikolla, i cili e ushtroi këtë detyrë deri në vitin 2008.

Në korrik të vitit 2007, batalioni i PU-së ishte pjesë organike e Komandës Mbështetëse, me varësi drejtimi administrativ në Komandën Mbështetëse dhe Komandim Operacional nga SHPFA. Në përbërje të këtij batalioni ishin 4 seksione të PU-së në rrethet Shkodër, Durrës, Berat, Vlorë dhe 5 nën seksione të PU-së, në rrethet Kukës, Burrel, Elbasan, Korçë dhe Gjirokastrë,

Në vitin 2008, komandanti i batalionit të PU-së emërohet kolonel Xhevdet Zeneli. Në maj struktura e Policisë Ushtarake kaloi në: Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura, në përputhje të plotë me Ligjin nr. 9069, datë 15.05.2003, “Për Policinë Ushtarake në FA”. Në qershor të vitit 2012, komandant i PU-së emërohet kolonel Syrja Gjoka. Në gusht të vitit 2012, komandant i PU-së emërohet kolonel Ylli Zyla. Në shtator të 2013, komandant i PU-së emërohet kolonel Xhevdet Zeneli. Veprimtaria e PU-së përcaktohet nga misioni dhe detyrat që parashikohen në ligjin, “Për Policinë Ushtarake në FARSH” dhe “Kodi Penal Ushtarak”. Hartimi dhe miratimi në Kuvend i këtij ligji në vitin 2003, shënon një ristrukturim të plotë të kësaj strukture. Gjatë kësaj periudhe është punuar për kompletimin e PU-së me personel të motivuar, arsimuar në vendet anëtare të NATO-s, si në Turqi, Itali, Gjermani. Realizimi i

misionit dhe detyrave funksionale është mbështetur në aktet ligjore e nënligjore.

Gjatë këtyre viteve, PU është trajnuar nga specialistë të karabinierisë italiane, policisë ushtarake amerikane, gjermane dhe turke.

Prej vitesh, njësia e PU-së po përgatit me një program të veçantë një nënrepart të nivelit togë NRF (NATO Response Force), si forcë e gatshme për të vepruar në përbërje të strukturës përkatëse të NATO-s, e aftë dhe e pajisur për shtatshmëri për të përmbushur detyrat. Gjithashtu, PU ka kryer një mision në operacionin ushtarak “ISAF”, në Kabul, Afganistan. Kontingjenti i kësaj toge përbëhej nga një efektivi prej 22 vetash.

Një kontribut të madh, efektivi i PU-së ka dhënë në emergjencat civile, ku kanë treguar gatishmëri dhe profesionalizëm në kryerjen e detyrave të marra.

Tashmë, struktura e PU-së është e përgatitur për të vepruar në të gjithë spektrin e misionit, detyrave, si edhe të marrë pjesë në operacione paqeruajtëse dhe humanitare.

- Ruajtja e rendit ushtarak në FARSH, zbulimi, parandalimi, ndjekja e veprimtarisë kriminale, angazhimi në luftën kundër terrorizmit, marrja pjesë në operacionet paqeruajtëse dhe humanitare, si dhe mbrojtja e pronës shtetërore në administrim dhe përdorim të Forcave të Armatosura nga veprimet e kundërligjshme.
- Siguron rendin ushtarak jashtë reparteve ushtarake në mjediset publike e jopublike.
- Mbron jetën, shëndetin dhe dinjitetin e ushtarakut nga çdo veprim i paligjshëm, kur ato cenohen për shkak të detyrës.
- Mbron pronën shtetërore në administrim dhe përdorim të FA-së, nga veprimtari të kundërligjshme.
- Ndërhyn për të mënjanuar aktet e terrorizmit në FA.
- Punon për zbulimin, parandalimin dhe ndjekjen e veprimtarisë kriminale ndaj pjesëtarëve të FA-së, pronës

dhe objekteve ushtarake.

- Zbaton vendimet e gjykatës, aktet e Prokurorisë Ushtarake për kërkimin, kapjen dhe sjelljen forcërisht të ushtarakëve që i fshihen procedimit penal ose i shmangen vuajtjes së dënimit.
- Kontrollon dhe siguron transportin ushtarak.
- Kontrollon lëvizjen dhe shfrytëzimin e mjeteve dhe teknikës ushtarake.
- Kontrollon e merr masa për zbatimin e legjislacionit të Masave të Ndërhyrjes kundra Zjarrit (MNZ).
- Siguron zbatimin e rendit ushtarak gjatë zhvillimit të stërvitjeve, veprimtarisë dhe ceremonive ushtarake të organizuara nga SHPFA.
- Shoqëron e siguron personalitetet e larta ushtarake të FA, si dhe delegacionet e huaja të njehsuara me to.
- Kryen detyra në interes të forcave ushtarake shqiptare që kryejnë misione jashtë shtetit, si dhe të forcave të huaja ushtarake që veprojnë në Shqipëri në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Kryen e mbështet operacionet humanitare.

33 - vjetori i krijimit e gjen Policinë Ushtarake me një rritje të trajtimit financiar për të gjitha kategoritë e personelit si dhe me përmirësim të infrastrukturës, mjeteve dhe pajisjeve. Nën drejtimin e komandantit,



nënkolonel Dhimitër Selmanaj, po punohet për të forcuar standardet profesionale dhe njëherazi për të mbajtur në nivele të larta disiplinën dhe zbatimin e ligjit. Sepse, Policia Ushtarake është një forcë e besueshme dhe e gatshme për t'u mbështetur nga qytetarët dhe Forcat e Armatosura.



INTERVISTA



Strategji, Siguri dhe Lidership: Një Bisedë Ekskluzive me Përfaqësuesin Ushtarak Kombëtar në ACO SHAPE, gjeneralmajor Petrit Çuni

Gjeneralmajor Petrit Çuni lindi, më 6 shtator 1969, në Shkodër. Ai nisi karrierën e tij ushtarake në vitin 1984, në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”. Pas përfundimit të studimeve në vitin 1988, ai vazhdoi edukimin në Akademinë e Forcave Tokësore “Skënderbej”, në Tiranë, ku u diplomua në vitin 1992. Gjeneral Çuni ka një karrierë të gjerë ushtarake, duke shërbyer si në pozicione shtabi ashtu edhe në ato komanduese. Pas diplomimit, ai mori detyrën si Zëvendëskomandant Kompanie në Batalionin e Tankeve në B. Curri. Në vitin 1993, u emërua Komandant i Batalionit të Tankeve, dhe më pas ka vazhduar shërbimin në njësitë e tankeve deri në korrik 2003. Në vitin 2003, emërohet Shef i Operacioneve dhe Stërvitjes të b1k në Brigadën e Reagimit të Shpejtë (BrRSh). Brenda pak muajsh, ai u ngrit në detyrë si Zëvendëskomandant i b1k të BrRSH. Në këtë periudhë, gjeneral Çuni ka qenë Komandant i Kontingjentit Shqiptar të Paqeruajtësve në Bosnje dhe Hercegovinë, duke marrë pjesë në 2 misione të NATO-s, SFOR dhe EUFOR, në vitet 2004 dhe 2006. Këto misione i mundësuan të fitonte përvojë të gjerë në operacionet ndërkombëtare dhe të bashkëpunonte me forcat e tjera të NATO-s.



Intervistoi:

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

Përveç eksperiencës operationale, zhvillimi profesional i gjeneral Çunit ka vazhduar me ndjekjen e arsimimit si brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 1997, ai ndoqi Kursin e Komandantit të Batalioni në Shkollën e Tankeve në Munster, Gjermani. Më vonë ai ndoqi studimet e avancuara ushtarake në Gjermani, duke ndjekur Akademinë e Drejtimit të Bundeswehr-it, në Hamburg, ku u diplomua në qershor 2009. Pas përfundimit të studimeve, po në të njëjtën Akademi në vitin 2009, ka përfunduar Kursin për Sigurinë Europiane. Zhvillimi i tij profesional vazhdoi me kurse të ndryshme të lidhshpimit dhe metodologjisë, duke përfshirë Programin për Studime të Avancuara të Sigurisë në Qendrën “George C. Marshall” në vitin 2010, Kursin Orientues për Oficerin e Shtabit të NATO-s në vitin 2015 dhe Kursin e politikave për oficerët e lartë në vitin 2021 në shkollën e NATO-s, Gjermani. Gjeneral Çuni ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në arsimin dhe zhvillimin profesional të oficerëve shqiptarë. Në vitin 2009, ai u emërua Zëvendëskomandant i Universitetit Ushtarak “Skënderbej”, përpara se të bëhej Komandant i këtij institucioni, në vitin 2011. Në këtë detyrë, ai punoi për modernizimin e kurrikulave ushtarake dhe përafrimin e tyre me standardet e NATO-s. Më pas, ai shërbeu si Pedagog Përgjegjës i Kursit të Lartë të Oficerit në Akademinë e Forcave të Armatosura. Në vitin 2013, gjeneral Çuni mori një detyrë të rëndësishme ndërkombëtare si Përfaqësues Kombëtar në Komandën e Forcës së Bashkuar të NATO-s (JFC) në Brunssum, Holandë, ku punoi për tre vjet, duke përfaqësuar Shqipërinë në strukturat strategjike të Aleancës. Pas kthimit në Shqipëri, ai u emërua Drejtor i Drejtorisë së Politikave NATO, BE dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Mbrojtjes. Më pas u caktua Shef i Shtabit të Forcës Tokësore, ku fill pas një viti do të emërohej Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Prej vitit 2019, gjeneralmajor Petrit Çuni është Përfaqësuesi Ushtarak Kombëtar i Shqipërisë në Komandën Strategjike të NATO-s (ACO SHAPE) në Belgjikë, duke përfaqësuar interesat e vendit në strukturat më të larta të Aleancës. Me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në vitin 2021 ai u gradua ‘gjeneral brigade’, ndërsa në shkurt të vitit 2025, u promovua në gradën ‘gjeneralmajor’. Gjatë karrierës së tij të gjatë dhe të suksesshme, gjeneralmajor Çuni është nderuar me disa dekorata kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjeneralmajor Petrit Çuni, përmes kësaj interviste vjen për shtypin ushtarak dhe jo vetëm, për të sjellë në vëmendje rëndësinë e këtij institucioni dhe misionin, të cilin, prej korrikut të vitit 2019, vazhdon ta përmbushë me sukses, profesionalizëm dhe devotshmëri të lartë.

I nderuar Gjeneral!

Cili është roli dhe misioni kryesor i Përfaqësuesit Ushtarak Kombëtar (PUK) në ACO SHAPE?

Përfaqësuesi Ushtarak Kombëtar (PUK) është figura qendrore e përfaqësimit të Shqipërisë në NATO, në nivel ushtarak operacional dhe strategjik. Ky pozicion ka një rëndësi të veçantë pasi përfaqëson Shqipërinë në Komandën Operacionale të Aleancës (ACO), një nga dy komandat strategjike të NATO-s, që merret me planifikimin dhe ekzekutimin e operacioneve të Aleancës.

Misioni kryesor i PUK është të sigurojë që interesat kombëtare mbrohen, Shqipëria dhe FARSH përfaqësohen dhe të promovohen në mënyrën më të mirë të mundshme kudo dhe kurdoherë dhe më konkretisht në diskutimet, vendim-marrjet në tavolinën me 32 anëtarë të NATO-s.

Kjo arrihet përmes: Pjesëmarrjes aktive në forume ushtarake, takime dhe vendimmarrje në ACO SHAPE, gjithashtu në koordinim me PURSH në NATO, Bruksel, siguron që Shqipëria të ketë zërin e saj në politikat dhe strategjitë ushtarake të Aleancës; Koordinimit dhe ndërldhjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe ACO, SHAPE; Mbështetjes së personelit shqiptar të emëruar në ACO dhe menaxhimit të çështjeve administrative dhe financiare të tyre; Sigurimit të informacionit të përditësuar për autoritetet shqiptare mbi zhvillimet e fundit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes brenda NATO-s, gjithashtu edhe zhvillimeve në Zonën e Përgjegjësisë (AOR) së aleancës. Në një kuadër më të gjerë, PUK luan një rol të rëndësishëm në forcimin e pozitës së Shqipërisë si një aleate e denjë, pro aktive e NATO-s, duke ofruar dhe evidencuar kontributin e Shqipërisë dhe FARSH-së në mbrojtjen kolektive të Aleancës.

Si ndikon PUK në marrëdhëniet e Shqipërisë me NATO-n në aspektin ushtarak dhe strategjik?

PUK është hallka kryesore e komunikimit ndërmjet Shqipërisë dhe ACO në aspektin ushtarak dhe strategjik. Roli i tij është parësor për të siguruar që politika e mbrojtjes dhe angazhimi ushtarak i Shqipërisë të jenë në harmonizim me prioritetet e NATO-s, duke patur në fokus interesat kombëtare dhe forcimin e pozicionit të vendit si një partner i besueshëm i Aleancës.

Disa nga drejtimit kryesore përmes të cilave PUK ndikon në marrëdhëniet e Shqipërisë me NATO-n janë: Mbajtja e vazhdueshme e komunikimit me homologët (PUK të vendeve aleate) e vendeve anëtare të NATO-s, nëpërmjet ndërtimit të një marrëdhënie besimi dhe ndërveprimi reciproke, në mënyrë që t'i shërbejë sa më mirë shkëmbimit të përvojave, eksperiencës dhe interesave të përbashkëta;

Angazhimi në planifikimin strategjik të NATO-s – PUK siguron që prioritetet e sigurisë kombëtare të Shqipërisë të integrohen në dokumentet dhe planet strategjike të Aleancës;

Koordinimi i stërvitjeve dhe operacioneve – Shqipëria / FARSH është e angazhuar në misione të NATO-s si KFOR në Kosovë, operacionet detare në Detin

Egje, forcave të përparuara (FLF) në kufijtë lindorë të Aleancës etj.; Ndikimi në vendimmarrjet e NATO-s – PUK siguron që përfaqësuesit e Shqipërisë në NATO të kenë akses në informacionin e nevojshëm dhe që pozicioni i Shqipërisë të jetë i qartë në çështjet kyçe të sigurisë dhe mbrojtjes.

Si përfaqësohen interesat e Shqipërisë brenda strukturave të NATO-s përmes jush?

PUK përfaqëson Shqipërinë në të gjitha forumet ushtarake të ACO SHAPE, ku diskutohen dhe miratohen vendimet për operacionet dhe strategjitë e Aleancës. Kjo përfshin: Pjesëmarrjen në takime dhe konferenca të nivelit strategjik të NATO-s, ku PUK prezanton, mbron qëndrimet dhe angazhimet e Shqipërisë në këtë nivel; Negocimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjeve të Mirëkuptimit (MoU), Marrëveshje teknike (TA), Notave të Aderimit (NoJ), të cilat lidhen me praninë e Shqipërisë në NATO dhe kontributin e saj në operacionet e Aleancës;

Komunikimin me DPPM, SHPFA, AISM dhe Forcat për të përcjellë materiale, informacione dhe dokumente mbi zhvillimet dhe përditësimet e herë pas herëshme të NATO-s, të cilat mund të kërkojnë pasqyrim dhe reflektim në dokumentet strategjike dhe planet tona kombëtare;

Përfaqësia Ushtarake Kombëtare siguron që qëndrimi i Shqipërisë të gjejë reflektim në dokumente dhe vendimmarrje në nivel operacional-strategjik.

Në cilat linja kryesore veprimi operon PUK për të përmbushur misionin e tij?

PUK operon në katër linja kryesore:

- Përfaqësimi
- Koordinimi dhe Ndërlidhja
- Ekspertiza dhe Këshillimi
- Elementi Mbështetës Kombëtar

Këto linja veprimi përbëjnë katër shtyllat kryesore të veprimtarisë së PUK gjatë përmbushjes së misionit.

Si funksionon koordinimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe komandave të NATO-s?

Për sa i përket pjesës së parë të pyetjes, koordinimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, theksoj se procesi i komandim-kontrollit dhe koordinimi është i mirë përcaktuar në dy dokumente të miratuara, si Rregullorja për Atashetë Ushtarake dhe Përfaqësuesit Ushtarake dhe civilë të MM së RSH, si dhe në Procedurën Standarde të Veprimit (PSV) të Përfaqësuesit Ushtarake Kombëtare në ACO, SHAPE dhe strukturat e vartësisë.

Çfarë roli ka PUK në menaxhimin e angazhimeve të Shqipërisë në operacionet dhe misionet e NATO-s?

Zyra e PUK ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin e operacioneve dhe angazhimeve të Shqipërisë në NATO. Është pika hyrëse e dokumenteve, kërkesave, informacioneve që Komanda e ACO, SHAPE u drejton vendeve anëtare; Bën vlerësimin e tyre dhe i adreson ato në DPPM dhe SHPFA me rekomandimet dhe opsionet e mundshme; Bën menaxhimin dhe koordinimin e personelit shqiptar në misionet dhe operacionet e NATO-s dhe BE; Bën ndjekjen e gjendjes së trupave shqiptare në terren, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesit shqiptarë (SNR) në operacione për të siguruar mbështetjen e nevojshme; Gjithashtu bën raportimin dhe analizimin e sfidave dhe

mësimeve të nxjerra nga misionet, për të përmirësuar më tej pjesëmarrjen dhe performancën e angazhimeve në misionet dhe operacionet e ardhshme.

Sa i rëndësishëm është komunikimi dhe bashkëpunimi me përfaqësuesit e tjerë ushtarakë të vendeve anëtare?

Komunikimi dhe bashkëpunimi me përfaqësuesit e tjerë ushtarakë të vendeve anëtare të NATO-s është jetik për një përfaqësim efektiv të Shqipërisë brenda Aleancës. Kjo përfshin: Krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit me homologët nga vendet e tjera të NATO-s, për të ndarë informacione dhe praktika më të mira mbi çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë, koordinimin e qëndrimeve strategjike mbi çështje kyçe të sigurisë, për të siguruar që Shqipëria të jetë pjesë e diskutimeve dhe vendimmarrjeve të rëndësishme të NATO-s, pjesëmarrjen aktive në takime dhe forume ndërkombëtare, ku përcaktohen prioritetet dhe planet e NATO-s për operacionet dhe mbrojtjen kolektive, si dhe forcimin e marrëdhënieve dypalëshe me vendet aleate, për të zgjeruar mundësitë e bashkëpunimit ushtarak, përfshirë stërvitjet e përbashkëta, projektet e mbrojtjes dhe asistencën teknike.

Cilat janë sfidat kryesore që përballeni në përmbushjen e detyrave tuaja si PUK?

Disa nga sfidat kryesore që PUK përballët përfshijnë përshtatjen me mjedisin e sigurisë në ndryshim të vazhdueshëm, duke iu referuar zhvillimeve të fundit gjeopolitike dhe sfidave me të cilat përballët arkitektura e sigurisë botërore, siç është agresioni i pajustifikuar rus në Ukrainë, terrorizmi ndërkombëtar dhe kërcënimet hibride.

Sfidë tjetër janë kërkesat në rritje për reagim të shpejtë dhe të sinkronizuar ndaj sfidave të sigurisë në Zonën e Përgjegjësisë së NATO-s, të cilat në të njëjtën kohë përkthehen në burime njerëzore, materiale dhe teknike të gatshme dhe të certifikuara.

Thënë këto, pavarësisht nga sfidat që përballemi në punën e përditshme, me bashkëpunim me autoritetet vendim-marrëse në MM dhe SHPFA, jemi përgjigjur në kohë dhe me angazhime konkrete ndaj kërkesave të ACO.

Si e vlerësoni rolin e Shqipërisë në NATO dhe çfarë përmirësimesh mund të bëhen në nivel strategjik?

Për të ilustruar pjesën e parë të pyetjes Tuaj, më lejoni të huazoj një thënie të ish-Sekretarit të Mbrojtjes të SHBA-ve, Jim Mattis, i cili gjatë vizitës zyrtare të Ministrit të Mbrojtjes së Shqipërisë në SHBA, ka deklaruar:

“Shqipëria ka treguar se madhësia gjeografike ka shumë më pak rëndësi se angazhimi në Aleancë. Si një aleate e vendosur, Shqipëria godet më fort se sa pesha e saj”. Thënia e tij thotë shumë, dhe është ikonike për Shqipërinë dhe FARSH-në, duke dashur t'i shtoj kësaj edhe faktin që sot, Shqipëria përfaqësohet në të gjitha NCS dhe NFS, duke plotësuar në masën 100 % angazhimin e saj me personel në këto struktura (Një nga vendet e pakta).

Për pjesën e dytë se çfarë përmirësimesh mund të bëhen në nivel strategjik, mund t'iu referohem dokumenteve strategjike të miratuara së fundmi nga Parlamenti i Shqipërisë dhe Planin Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave të Armatosura të RSH 2024-2033. Mjafton t'u përmbahemi dhe të jetësojmë kërkesat dhe prioritetet e këtyre dokumenteve, në këtë mënyrë kemi bërë të mundur arritjen e objektivave në nivel taktik, operacional dhe strategjik.

A ka ndonjë strategji të re për të forcuar përfaqësimin dhe ndikimin e Shqipërisë në strukturat ushtarake të NATO-s?

Punën e vazhdueshme të Ministrisë së mbrojtjes dhe SHPPA për të forcuar përfaqësimin e Shqipërisë në strukturat ushtarake të NATO-s, e tregon më së miri numri i lartë i personelit ushtarak në struktura dhe operacione të NATO-s, të cilët kanë marrë vlerësime maksimale nga NATO për punën dhe profesionalizmin e tyre. Në dijeninë time DPPM në MM dhe SHPPA janë në proces vlerësimi, rishikimi të pozicioneve aktuale dhe atyre të mundshme që Shqipëria mund të marrë në të ardhmen.

Çfarë mundësish ofron NATO për trajnimin dhe zhvillimin profesional të personelit ushtarak shqiptar?
NATO ofron një gamë të gjerë mundësish për trajnimin dhe zhvillimin profesional të personelit ushtarak shqiptar, duke siguruar që ata të jenë të përgatitur sipas standardeve më të larta të Aleancës. Këto mundësi përfshijnë:

1. Kurse dhe Akademi Ushtarake të NATO-s

Kolegji i Mbrojtjes i NATO-s (NATO Defense College - NDC, Romë, Itali) – Ky institucion prestigjioz ofron kurse strategjike për oficerë të lartë, duke përfshirë tematika si menaxhimi i krizave, lidhshëpi dhe operacionet e NATO-s.

Shkolla e NATO-s në Oberammergau, Gjermani – Ofron trajnime mbi politikën e mbrojtjes, strategjinë ushtarake dhe operacionet e NATO-s.

2. Trajnime në kuadër të Forcave të Reagimit të Aleancës (ARF - Allied Response Force)

Oficerët dhe ushtarakët shqiptarë marrin pjesë në stërvitje të përbashkëta me vendet aleate, duke përmirësuar aftësitë e tyre në operacione të përbashkëta ushtarake.

Këto trajnime përqendrohen në fusha të tilla si luftimi urban, mbrojtja kibernetike dhe operacionet speciale.

3. Programe për Lidhshëpin dhe Menaxhimin Ushtarak
Këto programe sigurohen nëpërmjet bashkëpunimeve dypalëshe me Akademitë respektive. Kursi për Shtabin e Përgjithshëm të NATO-s – Siguron trajnime për oficerët që do të shërbejnë në pozicione të larta strategjike.

4. Mbështetje për trajnimet në Shqipëri

Baza Ajrore e Kuçovës, si një bazë taktike e NATO-s, në të ardhmen mund të shërbejë për të zhvilluar trajnime të avancuara për pilotët dhe personelin teknik shqiptar, nëpërmjet Grupeve të Trajnimit të Lëvizshme (Mobile Training Team).

Shqipëria gjithashtu organizon stërvitje të përbashkëta në poligonin kombëtar të Bizës, duke trajnuar forcat speciale dhe njësitë e këmbëtorisë sipas standardeve të NATO-s.

5. Programet e Trajnimit për Luftën Kibernetike dhe Mbrojtjen nga Kërcënimet e Reja

NATO ka rritur fokusin në mbrojtjen kibernetike, dhe oficerët shqiptarë janë përfshirë në programe trajnimi për identifikimin dhe neutralizimin e kërcënimeve kibernetike. Shqipëria është pjesë e qendrave të ekselencës të NATO-s, për sigurinë kibernetike dhe luftën hibride.

Nëpërmjet këtyre programeve, personeli ushtarak shqiptar rrit aftësitë e tij profesionale dhe teknike, duke siguruar që Shqipëria të kontribuojë në mënyrë më efektive në operacionet e NATO-s.

Si po kontribuon Shqipëria në objektivat e NATO-s për mbrojtjen kolektive dhe sigurinë ndërkombëtare?
Siç e kam theksuar edhe në përgjigjet e dhëna më sipër,

Shqipëria kontribuon në mënyrë mjaft domethënëse në NATO dhe për këtë ka marrë vlerësime maksimale. Për t'i dhënë një përgjigje pak më të detajuar pyetjes, po listoj disa nga angazhimet aktuale që Shqipëria jep në kuadër të mbrojtjes kolektive dhe sigurisë ndërkombëtare:

1. Pjesëmarrja në Operacionet e NATO-s

Misioni KFOR në Kosovë – Trupat shqiptare kanë ndihmuar në ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë në rajon. Pjesëmarrja në Letoni dhe Bullgari në kuadër të FLF – Shqipëria ka dërguar trupa për të forcuar mbrojtjen e krahut lindor të NATO-s.

Operacioni detar i NATO-s në Detin Egje – Njësitë detare shqiptare janë angazhuar në patrullime për të mbështetur përpjekjet kundër trafikimit të paligjshëm dhe kërcënimeve detare.

Misioni “NATO Mission Irak” – Shqipëria ka dërguar personel, të cilët luajnë rolin e këshilluesit për autoritetet e Irakut.

Misioni “ALTHEA” në Bosnje Hercegovinë – Shqipëria ka dërguar trupa në mbështetje të misionit të BE.

Pjesëmarrja në Komandën e NATO-s, për Ndihmë dhe Trajnim për Ukrainën “NSATU”.

Pjesëmarrja në misionin “INTERFLEX”, UK.

2. Rritja e Buxhetit të Mbrojtjes dhe Modernizimi i Forcave të Armatosura

Shqipëria ka arritur 2% të PBB-së për mbrojtjen, duke përmbyshur objektivin e NATO-s për shpenzimet ushtarake.

Investime në teknologjinë ushtarake – Shqipëria ka blerë dronë të avancuar “Bayraktar TB2” për të përmirësuar aftësitë e mbikëqyrjes dhe mbrojtjes.

Modernizimi i Forcave Ajrore dhe Tokësore – Vendosija e bazës ajrore të NATO-s në Kuçovë dhe pajisja e forcave tokësore me mjete të reja luftarake ka rritur ndjeshëm kapacitetet operacionale të FARSH.

3. Mbështetja për Partnerët e NATO-s dhe Sigurinë Rajonale

Shqipëria ka mbështetur fuqishëm Ukrainën në luftën e saj kundër agresionit rus, duke ofruar ndihmë ushtarake dhe humanitare.

Angazhimi në iniciativat rajonale të sigurisë – Shqipëria merr pjesë në nisma të NATO-s për Ballkanin Perëndimor, duke promovuar stabilitetin në rajon, si dhe është një zë i fuqishëm mbështetës për Republikën e Kosovës dhe rrugën e saj drejt aderimit në këto iniciativa rajonale, në Programin e NATO-s të Partneritetit për Paqe (PfP) dhe në organizmat e BE-së. Si faktor kryesor stabiliteti në rajonin e Ballkanit, Shqipëria vazhdon të luajë këtë rol, duke promovuar iniciativë në funksion të paqes, stabilitetit dhe bashkëpunimit midis vendeve të rajonit, siç ishte dhe nënshkrimi i Deklaratës së Përbashkët të Ministrave të Mbrojtjes së Shqipërisë, Kosovës dhe Kroacisë, e firmosur më 18 mars në Tiranë.

4. Sigurimi i Infrastrukturës Strategjike të NATO-s

Baza Ajrore e Kuçovës, tashmë realitet, është një projekt i rëndësishëm që e vendos Shqipërinë në hartën strategjike të NATO-s. Kjo bazë do të shërbejë si një bazë taktike dhe operacionale për Aleancën.


Projekti në zhvillim i Porto Romano-s, si pjesë integrale e Korridorit të VIII që lidh Detin Adriatik me Detin e Zi, i është ofruar tashmë NATO-s për t'u përdorur si infrastrukturë portuale për mbështetjen e operacioneve detare dhe njëherësh si një korridor strategjik i lëvizjes, për afrimin e shpejtë të trupave në zonën e përgjegjësisë së KFOR-it dhe në drejtimin jug-lindor. Projekti i zhvillimit dhe modernizimit të bazës detare të Pashalimanit, si një bazë detare e përfshirë në Listën e Përzgjedhjes së Infrastrukturës Detare (MFSL) nga MARCOM.

16 Vjet Shqipëri

në NATO: Rrugëtimi, Arritjet dhe Sfida për të Ardhmen

Siguria dhe mbrojtja kombëtare e Shqipërisë kanë pësuar ndryshime të rëndësishme gjatë dekadave të fundit, veçanërisht pas integritit të vendit në NATO, në vitin 2009. Ky anëtarësim ka ndikuar në rritjen e kapaciteteve mbrojtëse, modernizimin e strukturave ushtarake dhe forcimin e bashkëpunimit me aleatët strategjikë.





Deklaratë

Republika e Shqipërisë u bë anëtare zyrtare e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), më 1 Prill 2009, duke sjellë rritjen e nivelit të stabilitetit dhe të sigurisë në rajonin Euro-Atlantik.

Me anëtarësimin në Aleancë, Shqipëria hyri në Fazën e Integritimit. Objektivat e saj kryesore ishin integrimi i Forcave të Armatosura Shqiptare në Strukturën Komanduese dhe Strukturën e Forcës të NATO-s, si dhe për të siguruar që Shqipëria kontribuon në misionin e Aleancës në përputhje me procedurat standarde të NATO-s.

Për të arritur këto objektiva Forcat e Armatosura të Shqipërisë zhvilluan një Plan Integrimi që u mbështet me një Program Pune të Integruar të NATO-s, i cili u drejtua fillimisht nga Komanda e Forcës së Bashkuar e Aleancës në Napoli, ndërsa në fazën finale nga Shtabi i Komandës Supreme të Aleancës për Transformim.


Faza e Integritimit është përbushur me sukses dhe Shqipëria do të ruajë në vijimësi kapacitetet e saj të deklaruara.

Në konfirmim të përbushjes së objektivave të Fazës së Integritimit, sot më 25 Tetor 2013, deklarojmë përfundimin zyrtar të Fazës së Integritimit në NATO për Republikën e Shqipërisë.


Xhevat Gjoksheli
General Major
Shtafi i Dëshmive të Përgjithshme të
Forcave të Armatosura të Shqipërisë




Jean-Paul Palomares
General, French Air Force
Komandant Suprem i Atlantikut për Transformim
Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut



Declaration

The Republic of Albania became a formal member of the North Atlantic Treaty Organization (NATO) on 1 April 2009 resulting in an increased level of stability and security in the Euro-Atlantic area.

Upon joining the Alliance, Albania entered the Integration Phase. Its main goals were the integration of the Albanian Armed Forces into the NATO Command and Force structures and to ensure that Albania contributes to the Alliance mission in accordance with NATO standard procedures.

To achieve these objectives, the Albanian Armed Forces developed an Integration Plan that was supported by NATO's Integrated Work Programme, led initially by Allied Joint Force Command Naples and, in its final phase, by Headquarters, Supreme Allied Commander Transformation.

The Integration Phase has been successfully completed and Albania will now maintain their declared capabilities.

As an affirmation of fulfilment of the Integration Phase objectives, today, the 25th day of October in the year 2013, we hereby declare the formal end of the NATO Integration Phase for the Republic of Albania.


Jean-Paul Palomares
General, French Air Force
Supreme Allied Commander Transformation
North Atlantic Treaty Organization




Xhevat Gjoksheli
Major General, Albanian Army
Chief of General Staff
Albanian Armed Forces



Faktorët kryesorë që ndikojnë në Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shqipërisë:

1. Integrimi në NATO dhe Partneritetet Strategjike

NATO ka sjellë një transformim të thellë në konceptin e mbrojtjes së Shqipërisë, duke e bërë atë pjesë të një sistemi kolektiv të sigurisë.

Mbështetja e aleatëve ka ndihmuar në trajnimin e personelit ushtarak dhe modernizimin e pajisjeve ushtarake.

Pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare ka forcuar ndërveprueshmërinë me forcat e tjera të NATO-s.

2. Modernizimi i Forcave të Armatosura

Investimet në teknologji ushtarake: Shqipëria ka marrë hapa për përmirësimin e pajisjeve dhe infrastrukturës ushtarake.

Rritja e kapaciteteve ajrore: Përmes modernizimit të Forcës Ajrore, me përfshirjen e bazës së Kuçovës, që do të shërbejë si një qendër taktike e NATO-s në rajon.

Forca Tokësore dhe Marina: Shqipëria ka punuar për përmirësimin e flotës detare dhe strukturave të mbrojtjes tokësore për të garantuar sigurinë e kufijve dhe hapësirës ujore.

3. Mbrojtja Kibernetike dhe Siguria Digjitale

Kërcënimet kibernetike janë kthyer në një sfidë globale, dhe Shqipëria ka nisur të zhvillojë kapacitete për të mbrojtur sistemet kritike të informacionit.

* Sulmet kibernetike të vitit 2022 theksuan nevojën për një strategji të fortë mbrojtjeje kibernetike.







4. Roli i Forcave të Armatosura në Stabilitetin Rajonal

Shqipëria ka një angazhim aktiv në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Ballkan përmes pjesëmarrjes në misione paqeruajtëse. Bashkëpunimi me Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi ka forcuar sigurinë rajonale dhe ka krijuar mundësi për mbrojtje të përbashkët.



Rrugëtimi i Përbashkët me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë

1. Strategjia e Sigurisë Kombëtare dhe Reforma Ushtarake

- Transformimi në një ushtri moderne dhe fleksibile, e cila i përshtatet standardeve të NATO-s.
- Theksimi i mbrojtjes kolektive: Forcat e Armatosura janë të fokusuara në mbrojtjen territoriale dhe angazhimet ndërkombëtare.

2. Thellimi i Bashkëpunimit me NATO-n dhe Partnerët Strategjikë



- Shqipëria synon të rrisë rolin e saj në misionet ndërkombëtare të aleancës, duke ofruar burime dhe trupa ushtarake.
- Baza ajrore e Kuçovës është një shembull konkret i integritit më të madh me strukturat e NATO-s.

3. Inovacioni Teknologjik dhe Modernizimi i Armatimeve

- Përdorimi i dronëve ushtarakë dhe sistemeve të mbrojtjes ajrore për të rritur gatishmërinë dhe efikasitetin operativ.
- Investimi në sisteme të avancuara të zbulimit dhe komunikimit për të rritur ndërveprueshmërinë me aleatët.

4. Rritja e Kapaciteteve të Personelit Ushtarak

- Trajnime të specializuara për ushtarakët shqiptarë në akademitë e vendeve të NATO-s.

- Rritja e numrit të rekrutimeve dhe nxitja e të rinjve për të ndjekur një karrierë në Forcat e Armatosura.

5. Siguria Kibernetike dhe Mbrojtja e Infrastrukturës Kritike

- Zhvillimi i strategjive dhe strukturave për të mbrojtur vendin nga kërcënimet kibernetike.

- Rritja e kapaciteteve për identifikimin dhe neutralizimin e sulmeve digjitale.

Një e Ardhme më e Fortë dhe më e Sigurt

Rrugëtimi i përbashkët i sigurisë dhe mbrojtjes së Shqipërisë është i ndërlidhur ngushtë me zhvillimin e Forcave të Armatosura dhe integrimin e tyre në sistemet ndërkombëtare të sigurisë. Me investime të vazhdueshme në teknologji, trajnime dhe modernizim, Shqipëria synon të jetë një partner i besueshëm në NATO dhe një faktor stabiliteti në rajon.

Bashkëpunimi me aleatët dhe përgatitja për sfidat e së ardhmes do të jenë faktorët kryesorë që do të përcaktojnë suksesin e mbrojtjes kombëtare në vitet që vijnë.

Inovacioni

dhe Projektet

Inovative: Sfida e Kohës
përballë Luftërave Hibride



Në epokën e ndryshimeve të shpejta teknologjike dhe sfidave të ndërlikuara gjeopolitike, inovacioni është bërë një faktor kyç në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Luftëra hibride, të cilat përfshijnë një kombinim të metodave konvencionale dhe jo konvencionale, si sulmet kibernetike, dezinformimi dhe lufta ekonomike, kërkojnë qasje të reja strategjike dhe teknologjike për t'u përballuar me sukses.

Roli i Inovacionit në Sigurinë Kombëtare dhe Ndërkombëtare

Inovacioni nuk është më një opsion, por një domosdoshmëri në arkitekturën e mbrojtjes. Shtetet po investojnë gjithnjë e më shumë në inteligjencën artificiale (AI), teknologjitë kibernetike, mbrojtjen kundër dezinformimit dhe zhvillimin e platformave të reja të luftës elektronike për të mbrojtur infrastrukturën kritike dhe sigurinë kombëtare.

Luftërat Hibride dhe Karakteristikat e Tyre

Lufta hibride nuk është më një kërcënim i së ardhmes, ajo është realiteti i sotëm. Kjo qasje përfshin:

- Dezinformimin dhe luftën psikologjike, ku përdoren mediat sociale dhe platformat digjitale për të ndikuar në opinionin publik.
- Sulmet kibernetike ndaj institucioneve shtetërore, infrastrukturave kritike dhe sektorit privat.
- Luftën ekonomike dhe presionin energjetik, duke përdorur bllokada financiare dhe ndërprerje të furnizimeve si armë strategjike.
- Përdorimin e forcave të ndërmjetme, si grupet mercenare dhe organizatat e fshehta për të destabilizuar rajone të caktuara.

Përballë këtyre sfidave, qeveritë dhe institucionet e sigurisë duhet të investojnë në:

Zhvillimin e inteligjencës artificiale për të analizuar dhe zbuluar kërcënimet në kohë reale.

Forcimin e mbrojtjes kibernetike, duke ndërtuar sisteme

të mbrojtjes inteligjente për rrjetet shtetërore dhe kritike.

Përdorimin e teknologjive të avancuara të vëzhgimit dhe analizës së të dhënave për të parashikuar sulmet e mundshme hibride.

Ndërtimin e strategjive të edukimit dhe rezistencës ndaj dezinformimit dhe propagandës.

Rëndësia e Projekteve Inovative

Projektet inovative në fushën e mbrojtjes po luajnë një rol vendimtar në parandalimin dhe kundërpërgjigjen ndaj kërcënimeve hibride. Disa nga teknologjitë kyçe përfshijnë:

Rrjetet e inteligjencës artificiale për analizën e të dhënave të mëdha (big data) në mbrojtje dhe siguri; Dronët autonomë dhe robotika ushtarake për operacione inteligjente në terren; Teknologjitë kuantike dhe blockchain për sigurinë e komunikimeve dhe transmetimin e të dhënave; Sistemet e vëzhgimit hapësinor dhe satelitor për monitorimin e lëvizjeve ushtarake dhe rreziqeve strategjike.

Bota po përballë me një realitet të ri, ku inovacioni është mburoja kryesore kundër luftërave hibride. Për të mbetur të sigurt dhe konkurrues në këtë fushë, shtetet duhet të investojnë në teknologji, të bashkëpunojnë me partnerët ndërkombëtarë dhe të ndërtojnë mekanizma të qëndrueshëm mbrojtjeje. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet një mbrojtje efektive kundër rreziqeve që vijnë nga luftërat e reja të shekullit XXI.

Mbrojtja Kibernetike dhe Zhvillimet Inovative

Në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur, mbrojtja kibernetike është kthyer në një nga shtyllat kryesore të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Sulmet kibernetike janë bërë më të sofistikuara, duke kërcënuar institucionet shtetërore, infrastrukturën kritike dhe sektorin privat. Për të përballuar këto kërcënimet, inovacionet teknologjike luajnë një rol



thelbësor në përmirësimin e mekanizmave mbrojtës. Mbrojtja kibernetike (Cybersecurity) është përpjekja për të mbrojtur sistemet kompjuterike, rrjetet dhe të dhënat nga sulmet kibernetike, të cilat mund të përfshijnë: Hacking dhe sulmet me malware (si viruset, ransomware dhe spyware).

Sulmet DDoS (Distributed Denial-of-Service), që synojnë bllokimin e shërbimeve online.

Sulmet e phishing – mashtrime që synojnë vjedhjen e të dhënave të ndjeshme.

Shkeljet e të dhënave dhe rrjedhja e informacionit përmes sulmeve mbi bazat e të dhënave.

Manipulimi i informacionit dhe dezinformimi, veçanërisht në kontekste politike dhe ekonomike.

Sfida dhe e Ardhmja e Mbrojtjes Kibernetike

Pavarësisht përparimeve teknologjike, sfidat kryesore në mbrojtjen kibernetike mbeten:

- Evolucion i vazhdueshëm i sulmeve kibernetike, që kërkon përditësime të vazhdueshme të sistemeve mbrojtëse.
- Mungesa e specialistëve të sigurisë kibernetike, duke krijuar një nevojë të madhe për trajnime dhe investime në burime njerëzore.
- Përdorimi i AI-së nga aktorët keqdashës, duke bërë më të vështirë identifikimin e sulmeve të sofistikuar.

Mbrojtja kibernetike nuk është më një çështje e thjeshtë teknologjike, por një strategji kombëtare

dhe ndërkombëtare. Inovacionet si AI, blockchain, Zero Trust Security dhe mbrojtja e infrastrukturës kritike janë thelbësore për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme dhe të mbrojtur ndaj kërcënimeve hibride.

Investimi në teknologji dhe trajnimin e ekspertëve është kyç për sigurinë e të dhënave dhe të institucioneve.

Shtetet dhe organizatat duhet të bashkëpunojnë për të ndarë informacionin mbi kërcënimet kibernetike dhe për të ndërtuar sisteme mbrojtëse të përbashkëta. E ardhmja e sigurisë kibernetike do të varet nga aftësia jonë për të përdorur inovacionin si mburojë kundër sulmeve gjithnjë e më të sofistikuar.

Si përballet Ushtria Shqiptare me kërcënimet kibernetike dhe luftën hibride?

Në epokën e digjitalizimit dhe sfidave të reja të sigurisë, Ushtria Shqiptare po përballet me një mjedis gjithnjë e më kompleks të kërcënimeve, ku sulmet kibernetike dhe luftërat hibride janë bërë mjete kryesore të shteteve dhe aktorëve keqdashës. Për këtë arsye, modernizimi dhe inovacioni në mbrojtjen kibernetike dhe strategjitë e sigurisë kombëtare janë kthyer në prioritet të rëndësishme.

Sfidat Kibernetike për Shqipërinë

Shqipëria, si pjesë e NATO-s, është një objektiv i mundshëm për sulme kibernetike dhe fushata hibride, sidomos nga aktorë shtetërorë dhe jo-shtetërorë që synojnë të ndikojnë stabilitetin e saj politik, ekonomik dhe ushtarak. Disa nga sfidat kryesore përfshijnë:

Sulmet kibernetike ndaj institucioneve shtetërore: Sidomos kundër Ministrisë së Mbrojtjes, infrastrukturës kritike dhe rrjeteve të komunikimit ushtarak.

Fushatat e dezinformimit dhe manipulimi i informacionit: Përdorimi i mediave sociale për të ndikuar në opinionin publik dhe për të përhapur lajme të rreme.

Siguria e rrjeteve ushtarake dhe komunikimeve të klasifikuara: Rreziku i ndërhyrjeve dhe përgjimeve në sistemet strategjike.

Përdorimi i luftës hibride nga aktorë të huaj: Duke kombinuar sulmet kibernetike, dezinformimin dhe ndërhyrjet ekonomike për të destabilizuar sigurinë

kombëtare.

Çfarë masash po merr Ushtria Shqiptare?

Për të përballuar këto sfida, Forcat e Armatosura të Shqipërisë (FA) dhe institucionet e sigurisë po investojnë në modernizimin e mbrojtjes kibernetike dhe strategjitë inovative të sigurisë.

Disa nga hapat kryesorë përfshijnë:

Zhvillimi i Mbrojtjes Kibernetike

Strukturat ushtarake po forcojnë kapacitetet e mbrojtjes kibernetike për të mbrojtur infrastrukturën strategjike. Shqipëria si vend anëtar i NATO-s ka akses në platforma të avancuara të mbrojtjes kibernetike dhe informacione të inteligjencës kibernetike. Duke përdorur teknologji të enkriptuara për të mbrojtur komunikimet strategjike.

Roli i Luftës Hibride në Sigurinë e

Shqipërisë

Lufta hibride është një kombinim i metodave të ndryshme që synojnë të destabilizojnë një shtet, si: Dezinformimi dhe manipulimi mediatik për të krijuar ndasi dhe pasiguri.

Presioni ekonomik dhe ndërhyrjet në sektorët strategjikë si energjia dhe infrastruktura.

Sulmet kibernetike ndaj sistemeve të qeverisjes dhe mbrojtjes kombëtare.

Si po reagon Shqipëria?

Forcimi i strategjive të komunikimit publik për të luftuar dezinformimin.

Monitorimi i vazhdueshëm i kërcënimeve hibride

dhe kibernetike nga institucionet e sigurisë.

Përmirësimi i bashkëpunimit me aleatët strategjikë për të shkëmbyer informacione mbi kërcënimet e reja.

A është Ushtria Shqiptare gati për sfidat e reja?

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në modernizimin e mbrojtjes kibernetike, por mbetet ende sfida për të ndërtuar kapacitete më të avancuara teknologjike dhe ekspertizë kombëtare në këtë fushë.

Si anëtare e NATO-s, Shqipëria ka përfitime nga mbështetja ndërkombëtare, por ka ende nevojë për investime të mëdha në infrastruktura digjitale të sigurisë dhe trajnimin e ekspertëve në luftën hibride. Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit të personelit ushtarak për mbrojtjen kibernetike është thelbësore për të forcuar sigurinë kombëtare. Me strategji të qarta, investime në teknologji dhe bashkëpunim të ngushtë me aleatët, Ushtria Shqiptare mund të forcojë mbrojtjen ndaj sulmeve kibernetike dhe kërcënimeve hibride në dekadat e ardhshme. Lufta moderne nuk zhvillohet vetëm në fushën e betejës, por edhe në hapësirën kibernetike. Ushtria Shqiptare, përmes reformave dhe partneriteteve strategjike, po modernizon mbrojtjen e saj për të përballuar kërcënimet e reja. Sfida kryesore mbetet zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve teknologjike dhe ekspertizës për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm mbrojtjeje në epokën e luftës hibride.



GJEOPOLITIKË



“KURTHI I MJALTIT”, GRACKA E INTELIGJENCËS RUSE NË VEPRIM



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Në mars të 2025, në Kosovë u kap një grup me spiunë serbë të BIA-s, të cilët kishin depërtuar deri në strukturat e sigurisë së Kosovës. Krahas metodave klasike të përdorura nga ato për të grumbulluar informacion të “ndjeshëm” lidhur me sigurinë kombëtare të Republikës së Kosovës, ata përdorën edhe joshjen seksuale, për të futur në kurth objektivat e tyre dhe më pas t'i bënë atyre presion, duke kërcënuar me publikimin e tyre.

Përveç Kosovës edhe Britania e Madhe, Italia, Gjermania, Ukraina dhe republikat baltike kanë raportuar intensifikim të luftës ruse me këtë armë “morale” të inteligjencës pas agresionit në Ukrainë, si mjet në veglat e luftës së doktrinës “Gerasimov”. Si raste studimorë kemi marrë një përpjekje të inteligjencës ruse të tipit “Mata Hari” në JFC Napoli dhe një tjetër “kurth” kundër një oficeri estonez në vitet e fundit. Çfarë është kjo armë e vjetër e shërbimeve të inteligjencës? “Honey trap” ose “spiunazhi nën çarçafë” është quajtur në gjuhën e inteligjencës joshja e seksuale e ushtarakëve kundërshtarë, me qëllim shantazhin dhe përmes tij rekrutimin dhe marrjen e informacionit sekret që iu intereson. Kjo është përdorur në të gjithë luftërat dhe konfliktet, e vjetër sa profesioni më i vjetër në botë - prostitucioni. Që nga Mata Hari, 100 vite më parë në luftën e parë botërore deri tek Maria Adela Kufeld Rivera që u infiltrua në bazën e NATO-s në Napoli, në vitin 2022.

Para se të zhdukej, në gusht 2022, Maria Adela Kufeld Rivera pushtoi shumë zemra dhe shkaktoi një numër zhgënjimesh romantike, shkruan gazeta “La republika” për agjentin ruse. Për këtë personazh që është një tjetër mënyrë e luftës së inteligjencës mund të kemi një tjetër punim. Në këtë artikull do të analizojmë kujdesin dhe teknikat që rusët përdorin në rekrutimin e oficerëve me vlerë të ushtrive të tyre kundërshtarë dhe specifikisht me Estoninë fqinje. Në një artikull të titulluar “Psikologjia e tradhtisë”, Alan Studner, një psikolog i CIA-s që ka analizuar dezertorët, duke përfshirë Oleg Penkovsky, kolonelin e GRU, i cili në vitin 1961 doli vullnetar për t’u bërë spiun anglo-amerikan, argumentoi se ushtarakët që tradhtuan dhe ranë pre e grackave të inteligjencës, ishin në një farë mënyre të pakënaqur. Estonia qëndron në vijën e parë të përpjekjeve për të frenuar revanshimin rus.

Aty ku të tjerët kohët e fundit kanë bërë zhurmë kritike ndaj Bashkimit Evropian ose NATO-s, estonezët i shohin këto institucione dhe pjesëmarrjen e tyre në to, si domosdoshmëri ekzistenciale dhe e vetmja gjë që e pengon shtetin baltik të mos gëlltitet sërish nga fqinji i tij gjigant, Rusia. Rusët etnikë përbëjnë një të katërtën

e popullsisë së Estonisë dhe kur vendi fitoi pavarësinë nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1991, iu desh të krijonte organe të tëra ligjzbatuese nga e para. Metsavas u rrit në Lasnamäe, një enklavë rusisht-folëse e kryeqytetit të Estonisë. Babai i tij, Pjotr Volin, kishte shërbyer në rojën kufitare sovjetike përpara, dhe nëna e tij lindi në Rusi dhe emigroi në Estoni pasi u martua me Volin. Shumica e rusëve etnikë në Estoni, jetojnë në zona ose komunitete homogjene. Si shumica e fëmijëve të zonës, në vitet 1980, edhe Metsavas ndoqi shkollën fillore në gjuhën ruse. Megjithatë, Metsavas u rekrutua nga ushtria. Ai donte të imitonte yjet amerikanë të filmave aksion, si Arnold Schwarzenegger dhe Chuck Norris, filmat e të cilëve i pëlqenin. Gjyshi nga babai i Metsavas kishte ndryshuar mbiemrin e familjes në Volin si një shfaqje të besnikërisë ideologjike ndaj Moskës - volya në rusisht do të thotë “vullnet”. Sapo Estonia fitoi pavarësinë e saj, Metsavas e ndryshoi përsëri mbiemrin dhe u përfshi në forcat e sigurisë estoneze.

Ai kishte mbaruar akademinë ushtarake estoneze dhe ishte bërë specialist artilerie, duke kaluar tranzit nga një bazë në juglindje të Talinit, përsëri në kryeqytet dhe më tej në Finlandë, ku iu nënshtrua trajnimit të mëtejshëm të artilerisë. Major Denis Metsavas ishte bashkuar me ushtrinë estoneze në 2008, por vinte rregullisht në Rusi për të vizituar familjen e nënës së tij, pasi ai ishte një etni ruse, fliste rrjedhshëm estonezisht dhe rusisht dhe lëvizte lehtësisht në Smolensk. Një mbrëmje, ishte jashtë me kushëririn e tij në një klub nate në Smolensk, ku majori estonez Metsavas u njoh me një grua tërheqëse, që nuk e kishte takuar më parë. Pasi kishin kaluar natën bashkë, në momentin që ai doli jashtë shtëpisë në mëngjes, dy burra të veshur me rroba civile iu afruan dhe u identifikuan si oficerë policie. Ata i treguan atij një deklaratë në të cilën grua me të cilën Metsavas kishte kaluar natën, pretendonte se e kishte përdhunuar. Ai mund të përballlet me 15 vjet burg në një burg rus nëse dënohet. Në komisarjat një nga oficerët nxori një kamerë dixhitale me një ekran që e tregonte Metsavas në shtrat me gruan. Sapo pa videon, majori estonez e kishte të qartë se ishte përfshirë në një “kurth mjalti”, një operacion rekruti-

mi seksual nga GRU. Rusët e GRU-së i thanë se mund ta zgjidhnin problemin nëse bashkëpunonte. Majori ra dakord, por nga oficerët nuk iu kërkua asnjë informacion në lidhje me karrierën e tij ose ushtrinë estoneze për momentin. Ai nuk u prangos, beqar në atë kohë, ai nuk i tregoi askujt për takimin me GRU-në në Rusi dhe u kthye në Estoni. Në vjeshtë të vitit 2008, teksa po dilte nga shtëpia e nënës së tij në Talin, një burrë iu afrua dhe i foli rusisht. “Të kujtohet ajo që ndodhi në Smolensk, dhe premtimi për të bashkëpunuar?”. Në dhjetor 2008, ai udhëtoi për në Shën Petersburg dhe u takua nga një oficer të GRU-së, i cili u prezantua me emrin Anton, më pas u dërgua në një shtëpi të sigurt “Safe House”, ku u pyet për jetën e tij personale, fazat e hershme të karrierës së tij si dhe pyetje befasuese të thjeshta në lidhje me ushtrinë e Estonisë si: Sa obusë kishin estonezët? A mund t’i emërtojë ai ndërtesat individuale në një hartë të instalimeve ushtarake ku shërben? “Mund t’i gjeshe ato gjëra në internet shumë lehtë, pse mi kërkoni mua”, mendoi ai. Metsavas iu ofrua një shumë e vogël parash që bashkëbiseduesit i thanë se do të mbulonin shpenzimet e tij dhe u kthye në shtëpi. Ai shkëmbim i parë në dukje i padëmshëm; ishte një plan paraprak i realizuar, pra rekrutimi kishte ndodhur. Majori estonez Metsavas kishte pranuar para, në shkëmbim të dhënies së informacionit një agjencie zbulimi armik. Gjatë gjithë bisedës, rusët me të cilët ai foli diskutuan për familjen e Metsavas të cilën ata dinin hollësisht. “Ata kurrë nuk e thanë qartë se diçka e keqe mund të ndodhte me prindërit e tij nëse nuk bashkëpunonte, por kjo kuptohej qartë. GRU, përmes oficerit të çështjes, Anton, ishte shumë e interesuar të dinte informacione sekrete për Ukrainën dhe Gjeorgjinë, dy vende ku Metsavas kishte udhëtuar si oficer ndërlidhës i artilerisë. Ndërsa karriera e majorit përparonte, vlera e tij për rusët vetëm u rrit, dhe ajo që filloi si pyetje e thjeshtë, u bë e ndërlikuar, më e detajuar dhe më e rrezikshme. Oficerët e GRU-së bënë pyetje në lidhje me aleatët ushtarakë estonezë, veçanërisht SHBA-në dhe Mbretërinë e Bashkuar, dhe çfarë armësh dhe municionesh ruanin ata në tokën estoneze. Ekspertiza e Metsavas ishte e dobishme për Moskën, sepse Estonia megjithëse nuk ka shumë forca detare apo ajrore, ajo është e aftë në luftën me artilerinë tokësore. GRU donte të dinte për aktivitetet e SHBA-së jashtë Estonisë dhe nuk ishte shumë e shqetësuar për aftësitë e mbrojtjes vendase të Estonisë, por për mbështetjen që merrte nga aleatët më të fortë. Në vitin 2012, Metsavas u

vendos në Afganistan si një oficer ndërlidhës i kompanisë i vendosur në provincën Helmand. Pas kthimit në shtëpi, ai u caktua në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Estoneze në Talin, ku shërbeu si oficer shtabi në Drejtorinë e Artilerisë, pjesë e një departamenti për përgatitjen e një strategjie të përgjithshme të mbrojtjes kombëtare. Pozicioni i tij me akses për të për të parë informacion të klasifikuar ishte i kufizuar. Megjithatë, diçka e brendshme kishte ndryshuar në qëndrimin e tij: ai kishte parë nga afër se si ishte lufta, i rreshtuar përkrah shokëve estonezë, me të cilët kishte rrezikuar jetën, kundër një kundërshtari të përkushtuar ideologjikisht që ishte Al Qaida. Ndërsa ishte në Afganistan, ai kishte marrë trefishin e pagës së tij normale, si bonus për ushtarët estonezë në zonat aktive të luftës dhe mendonte se së shpejti do të kishte para të mjaftueshme për t’u tërhequr nga ushtria, për rrjedhojë edhe nga spiunazhi i tij për Rusinë. Në kohën kur Metsavas ishte në Afganistan, agjentët e GRU-së ishin takuar me babanë e tij, Volin, i cili ndjehej “Homo sovieticus”, prandaj ai ra dakord të ndihmonte Moskën në këmbim të parave për të paguar trajtimin e gruas së tij të sëmurë. GRU i tregon Metsavas për babanë e tij dhe kjo bëri që majori estonez të mos tërhiqej më dhe të vazhdonte të vidhte dokumente nga Shtabi i Përgjithshëm, duke ia kaluar IO (Intelligence Officer) Anton në Shën Petersburg. Tre muaj pasi pushtoi Krimenë nga Ukraina në vitin 2014, Rusia rrëmbeu një oficer të kundërzbulimit të KAPO-s që është shërbimi i inteligjencës ushtarake estoneze, i cili, ishte vendosur në kufirin juglindor të Estonisë për të goditur një rrjet të kontrabandës së cigareve. Oficeri estonez i inteligjencës kaloi një vit në burgun famëkeq Lefortovo të Moskës përpara se të shkëmbehej, në stilin e Ura e Spiunëve, me një tjetër ish-oficer të KAPO-s, i cili kishte spiunuar për FSB-në e Rusisë. Këto qenë shkaqet që qeveria estoneze të lëshojë një urdhër për të gjithë personelin shtetëror dhe atë ushtarak, ‘të ndalohej vizitat në Rusi’. Metsavas pas këtij urdhri, do të duhet të marrë leje të posaçme, të kontrollohet dhe nënshkruajë e përshkruajë për të gjithë udhëtimin e tij përtej kufirit. Nëse ky urdhër do të kishte ndodhur disa vite më parë, Metsavas nuk do të kishte më takime me Anton dhe kështu ky do rezultonte një fund de fakto, i lidhjes së tij me GRU. Por babai i Volin, që jetonte në Talin, i cili nuk i nënshtrohej urdhrat të ndalimit të lëvizjes për në Rusi, u bë korrieri i djalit të tij agjent dhe do t’ia dorëzonte informacionin Antonit në Shën Petersburg.

Rekrutimi brenda familjes dhe trashëgimi i spiunazhit ka qenë dhe mbetet një metodë e GRU-së, por edhe e BIA-s serbe, e cila në rastin e majorit estonez u përdor përsëri. Vendimarrja e Metsavas është e vështirë të racionalizohet, pasi në shumë raste, ai mund të kishte hequr dorë, ose t'i dorëzohej inteligjencës estoneze me qëllim që t'i servite Rusisë informacione të dobëta, të shtrembëruara etj.

Në rastin e Metsavas, prindërit e tij rusë padyshim luajtën një rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe edukimin e tij. “Kapaciteti për ngulitjen dhe edukimin e besnikërisë, përfshihet në personalitetin e fëmijës në zhvillim, mbetet i pranishëm edhe nëse është i pavetëdijshëm gjatë gjithë jetës dhe vetëm në adoleshencë regjimi dhe jeta sociale ia zënë vendin e prindit”. Pasi Rusia aneksoi Krimenë, nxiti një kryengritje “separatiste” në rajonin e Donbasit të Ukrainës lindore dhe mbolli trazira në pjesën më të madhe të pjesës tjetër të vendit me një fushatë të gjerë dezinformimi dhe propagande. Fushatë kjo, që siç vërtetohet më vonë, do t'i shërbente planeve të Rusisë për të pushtuar Ukrainën. Rusët dyfishuan përpjekjet e tyre, dhe për të humbur çdo dyshim përdorën ushtarakë estonezë të rekrutuar që të flisnin kundër Rusisë. U dallua në mes të këtyre Metsavas. Në atë kohë, ai ishte një veteran 15-vjeçar i ushtrisë estoneze dhe kishte përfunduar një mision me NATO-n në Afganistan. Metsavas u bë zëdhënësi de fakto i ushtrisë estoneze për komunitetin etnik rus të vendit. Ai fitoi famë, në shfaqje televizive në gjuhën ruse dhe duke dhënë intervista në radio për mbrojtjen e Estonisë dhe përgatitjet stërvitore të NATO-s. Ai foli në një shkollë të mesme lokale mbi patriotizmin dhe demokracinë, duke i paralajmëruar studentët estonezë kundër propagandës ruse. Për më shumë se një dekadë; ndërkohë që përfaqësonte ushtrinë estoneze në televizion, ndërsa shërbente me uniformë në një zonë lufte, ndërsa sulmonte trollët rusë në Facebook; Metsavas kishte vazhduar të spiunonte për Kremlinin. I vetmi shpjegim logjik për veprimet e tij është se besnikëria nuk garantohet nga shtetësia estoneze apo betimi i një ushtari për shtetin estonez. Besnikëria më shumë bazohet në ndjenjën e përkatësisë etnike dhe në lidhjen e gjakut me paraardhësit. Lista e atyre që Metsava ka tradhtuar është e gjatë. Janë kolegët e tij, shokët e tij ushtarakë, njerëzit që ai i quajti miqtë e tij, të cilëve u shërbeu në një zonë lufte, janë studentët që ai dha mësim, dhe diaspora ruse në Estoni. Ai në gjyq,

nuk fajësoi askënd përveç vetes për sjelljen e tij. IO i GRU-së Antoni thjesht po bënte punën e tij. Metsavas deklaroi se ishte i frikësuar kur e takoi Antonin për herë të parë, sepse ai dinte gjithçka për jetën dhe familjen e tij. Antoni u përpoq dhe e arriti të jetë një kombinim i mikut, terapistit dhe baba-rrëfimitarit, por qëllimi i tij mbeti konstant: të bindë agjentin e tij që të shkatërrojë veten ngadalë, metodikisht dhe pa kthim. Metsavas u dënua për spiunazh për shërbimin e inteligjencës ushtarake të Rusisë GRU dhe u dënua me 15 vjet e gjysmë burg. Ai u deklarua fajtor në gjyqin e tij megjithëse bashkëpunoi me kundërzbulimin e Estonisë, duke ofruar detaje se si ai u zgjodh nga Moska, për bisedat e tij me GRU-në prej kohësh, si dhe për informacionin e klasifikuar që ai i kaloi në Rusi. Rekrutimi i Metsavas dhe më tepër, jetëgjatësia e tradhtisë së tij, ndriçuan se sa pragmatikë, cinikë dhe dinakë mund të jenë oficerët e GRU-së, në një luftë të ftohtë kundër Perëndimit, një luftë që estonezët e besojnë, se ajo kurrë nuk ka përfunduar realisht pas rënies së Bashkimit Sovjetik. Duke analizuar me detaje profesionale këto raste konkretë sa më lart, është shumë i prekshëm, këshillues parandalues dhe evident edhe për ushtarakët shqiptarë, kryesisht ato përfaqësues në misione jashtë vendit. Jashtë atdheut ushtaraku ynë është në një farë mënyre i pakontrolluar, i lirë, por duhet të dijë se është i ekspozuar ndaj grackave të inteligjencës së huaj ruse, kineze, serbe etj., të planifikuara dhe ngritura nga ata me shumë kujdes dhe profesionalizëm. Rrëfimi dhe pranimi i këtij gabimi njerëzor tek kundërzbulimi pranë AISM, është hapi i parë për cilin do që bie në këtë grackë. Për atë kohë sa nuk është konsumuar tradhtia dhe nënshkruar bashkëpunimi me një agjenci armike të zbulimit, çdo gjë mund të rikuperohet. Kjo është rruga më e drejtë, e vetme dhe më e duhura për çdo ushtarak shqiptar, i cili nga pakujdesia, nga padija, pija apo rrethanat, ka rënë në këtë kurth apo të ngjashëm me të. Ndoshta edhe publikimi i këtij punimi mund të shërbejë, si një rast reflektimi, ndërgjegjësimi dhe denoncimi, pasi kjo nuk është çështje e moralit “të thyer” por, armë speciale e një lufte hibride, që edhe pas vitit 2025 ka premisa të rritet. Në qoftë se nuk kemi raportime në polici, gjykatë, shtyp etj., kjo nuk do të thotë se ky rrezik nuk ekziston për efektivet e FARSH-it. Nëse nuk hiqet dorë në fazën e parë të “gabimit”, rruga e tradhtisë ndaj atdheut është pa kthim dhe pendesa e mëvonshme, nuk ka më asnjë efekt.

NJË LIDER I ÇON NJERËZIT ATY KU DUAN TË SHKOJNË

NJË LIDER I MADH I ÇON NJERËZIT, JO ATY KU DUAN TË SHKOJNË, PO ATY KU DUHET TË JENË

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

Lidershipi është një element thelbësor për funksionimin dhe suksesin e çdo organizate, qoftë ajo ushtarake, politike, ekonomike apo sociale. Ne kemi nevojë për lidërsip për disa arsye kryesore që ndikojnë në zhvillimin dhe efektivitetin e grupeve dhe institucioneve. Liderët ofrojnë një vizion të qartë dhe një drejtim strategjik, duke ndihmuar grupet ose organizatat të ecin përpara me qëllime të qarta. Pa një lidërsip të mirë, individët dhe grupet mund të humbasin fokusin dhe të mos arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Një ushtri, pa një lider të fortë mund të jetë e paorganizuar dhe e paaftë për të përballuar sfidat e betejës.

Në biznes, Një kompani pa një CEO vizionar mund të humbasë konkurrencën në treg.

Një lider i mirë motivon dhe frymëzon njerëzit për të arritur qëllimet e tyre. Ai ndihmon individët të kapërcejnë frikën, të tejkalojnë vështirësitë dhe të punojnë me përkushtim.

Një trajner sportiv frymëzon ekipin e tij të japë më të mirën në çdo ndeshje. Një mësues i aftë mund të frymëzojë nxënësit të ndjekin ëndrrat e tyre.

Lidershipi është thelbësor për strukturën dhe organizimin e një ekipi. Një lider e ndan punën, vendos përparësi dhe siguron që të gjithë të punojnë së bashku drejt një objektivit të përbashkët.

Një lider ushtarak siguron që njësitë të jenë të koordinuara në një operacion. Në situata të ndërlikuara ose krize, një



lider i aftë merr vendime të shpejta dhe të drejta. Pa një lider efektiv, vendimet mund të jenë të ngadalta, të pasakta ose të ndikuara nga kaosi. Në një situatë emergjente, një komandant ushtarak vendos për lëvizjet e trupave për të shmangur rrezikun.

Lidershipi është thelbësor në çdo fushë të jetës. Ai siguron drejtim, motivim, organizim, vendimmarrje të zgjuar dhe përshtatje ndaj ndryshimeve. Pa lidership të fortë, shoqëritë, organizatat dhe kombet mund të dështojnë të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Një lider i mirë nuk është vetëm një komandues, por një vizionar, motivues dhe drejtues që ndihmon të tjerët të ecin përpara me besim dhe sukses.

Lidershipi Ushtarak

Lidershipi ushtarak është një aspekt kyç në menaxhimin dhe komandimin e forcave të armatosura. Ai përfshin aftësinë për të motivuar, drejtuar dhe organizuar ushtarët në kushte të ndryshme, shpesh në situata me rrezik të lartë dhe nën presion ekstrem. Lidershipi ushtarak është zhvilluar ndër shekuj dhe është përshtatur me ndryshimet në teknologji, strategji dhe politika ushtarake.

Karakteristikat Kryesore të Lidershipit Ushtarak

Lidershipi ushtarak karakterizohet nga disa cilësi themelore që e dallojnë nga format e tjera të lidershipit:

Vendosmëria dhe Qartësia në

Vendimmarrje

Një lider ushtarak duhet të jetë i aftë të marrë vendime të shpejta dhe të sakta, shpesh me informacion të kufizuar dhe nën presion. Një vendim i mirë në kohën e duhur mund të jetë diferenca midis fitores dhe humbjes në një betejë.

Integriteti dhe Disiplina

Lidershipi ushtarak kërkon një nivel të lartë etike dhe përgjegjësie. Oficerët dhe komandantët duhet të jenë modele të disiplinës, duke zbatuar dhe respektuar rregullat dhe normat ushtarake.

Aftësia për të Frymëzuar dhe Motivuar

Një lider i suksesshëm ushtarak nuk është vetëm një komandant, por edhe një burim frymëzimi për trupat e tij. Kjo bëhet përmes shembullit personal, komunikimit efektiv dhe aftësisë për të krijuar një ndjenjë uniteti dhe misioni të përbashkët.

Përshtatshmëria dhe Fleksibiliteti

Në një mjedis që ndryshon vazhdimisht, siç janë fushëbetëjat, një lider ushtarak duhet të jetë në gjendje të përshtatet me situatat e reja dhe të

ndryshojë strategjinë sipas nevojës.

Modelet e Lidershipit Ushtarak

Lidershipi ushtarak mund të klasifikohet në disa modele, në varësi të qasjes që përdor lideri për të drejtuar trupat e tij:

Lidershipi Autokratik

Ky është një stil i udhëheqjes ku komandanti merr vendime pa konsultuar vartësit. Ky model është i dobishëm në situata ku është e nevojshme një përgjigje e shpejtë dhe e unifikuar, por mund të jetë problematik në situata që kërkojnë kreativitet dhe fleksibilitet nga ushtarët.

Lidershipi Transformues

Liderët transformues frymëzojnë dhe motivojnë ushtarët duke krijuar një vizion të qartë dhe duke promovuar inovacionin. Ky stil lidershipi ndihmon në krijimin e një kulture të përkushtimit dhe zhvillimit të aftësive.

Lidershipi Demokratik (Bashkëpunues)

Në këtë stil, liderët përfshijnë vartësit në procesin e vendimmarrjes. Edhe pse ky model nuk është gjithmonë i mundur në operacione të drejtpërdrejta ushtarake, ai mund të jetë efektiv në fazat e planifikimit dhe trajnimit.

Si dhe stili i lidershipit që funksionon në çdo situatë. Liderët duhet të përshtaten me rrethanat dhe të ndryshojnë qasjen e tyre sipas nivelit të pjekurisë dhe kompetencës së trupave të tyre.

Sfidat e Lidershipit Ushtarak në Kohët Moderne

Me zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet në natyrën e konflikteve, lidershipi ushtarak përballët me sfida të reja si: Luftërat Asimetrike dhe Konfliktet Hibride. Luftërat moderne nuk zhvillohen vetëm midis ushtrive konvencionale, por përfshijnë edhe konflikte hibride, ku grupet paramilitare, kibernetika dhe operacionet psikologjike luajnë një rol të rëndësishëm. Liderët ushtarakë duhet të jenë të përgatitur për të menaxhuar situata të ndërlikuara dhe të paparashikueshme.

Teknologjia dhe Lidershipi Ushtarak

Përdorimi i inteligjencës artificiale, dronëve dhe luftës kibernetike ka ndryshuar natyrën e komandimit dhe kontrollit. Liderët modernë duhet të jenë të aftë të kuptojnë dhe të përdorin teknologjitë e reja në avantazhin e tyre.

Liderët ushtarakë duhet të jenë të aftë të menaxhojnë stresin dhe të ruajnë moralin e trupave edhe në situata ekstreme. Konfliktet e gjata, traumat psikologjike dhe

presionet politike mund të ndikojnë në performancën dhe efektivitetin e ushtrisë.

Historia ka prodhuar shumë liderë të shquar ushtarake që kanë lënë gjurmë me aftësitë dhe strategjitë e tyre: Aleksandri i Madh ishte një nga gjeneralët më të mëdhenj të historisë, i njohur për aftësinë e tij për të udhëhequr trupa të ndryshme dhe për të përdorur strategji inovative.

Napoleon Bonaparti, i famshëm për taktikat e tij ushtarake dhe aftësinë për të motivuar ushtarët e tij. George S. Patton, gjeneral amerikan në Luftën e Dytë Botërore, i njohur për stilin e tij agresiv dhe strategjitë efektive në fushëbetejë.

Lidershipi ushtarak është një disiplinë e ndërlikuar që kërkon një kombinim të aftësive strategjike, emocionale dhe teknike. Një lider i suksesshëm ushtarak duhet të ketë integritet, vendosmëri, fleksibilitet dhe aftësi për të frymëzuar trupat.

Në kohët moderne, sfidat e reja si teknologjia, konfliktet asimetrike dhe presionet politike kërkojnë që liderët ushtarake të jenë më të adaptueshëm se kurrë më parë. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, parimet themelore të lidërshiptit ushtarak mbeten të njëjta, vendimmarrje e shpejtë, disiplinë e hekurt dhe aftësia për të motivuar dhe drejtuar forcat me sukses.

Disa prej lidërshipteve me dominim në ushtrinë shqiptare

Lidershipi ushtarak shqiptar ka kaluar nëpër disa periudha të rëndësishme historike, duke pasur figura të shquara që kanë ndikuar në zhvillimin e forcave të armatosura dhe në mbrojtjen e sovranitetit të vendit.

Skënderbeu (Gjergj Kastrioti), Udhëheqësi i Lidhjes së Lezhës (1443-1468)

Skënderbeu është figura më e njohur e historisë ushtarake shqiptare dhe një nga strategët më të mëdhenj të Mesjetës.

Ai u kthye nga Perandoria Osmane për të udhëhequr shqiptarët kundër pushtimit osman, duke përdorur taktika të luftës guerile dhe mbrojtje të fortifikuar.

Kontributi i tij konstatohet në: Bashkimin e principatave shqiptare nën Lidhjen e Lezhës; Mbajtjen e Shqipërisë së pavarur për mbi 25 vjet kundër Perandorisë Osmane; U bë një simbol i rezistencës dhe lidërshiptit ushtarak.



Ali Pashë Tepelena (1740-1822), Sundimtari i Janinës

Ali Pashë Tepelena ishte një figurë karizmatike dhe një udhëheqës ushtarak që ndërtoi një shtet gjysmë të pavarur brenda Perandorisë Osmane. Ai ishte një strateg i shkëlqyer dhe shquhej për aftësinë e tij për të ndërtuar një ushtri të fuqishme lokale.

Kontributi i tij: Krijoi një ushtri të organizuar dhe modernizoi strukturat ushtarake; Luftoi kundër osmanëve dhe fuqive të tjera rajonale për të ruajtur pavarësinë e tij. Ishte një lider i aftë diplomatikisht dhe ushtarakisht.

Isa Boletini (1864-1916), Hero i Pavarësisë

Isa Boletini ishte një nga komandantët kryesorë të luftës për pavarësinë e Shqipërisë.

Ai organizoi dhe drejtoi luftëtarët shqiptarë kundër Perandorisë Osmane dhe forcave serbe.

Kontributi i tij: Pjesëmarrje aktive në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 1912; Luftoi kundër forcave serbe për të mbrojtur trojet shqiptare. U bë një figurë simbolike e rezistencës kombëtare.

Ahmet Zogu (1895-1961), Mbret dhe Udhëheqës i Ushtrisë Shqiptare

Ahmet Zogu, fillimisht kryeministër dhe më pas mbret i Shqipërisë, pati një rol të rëndësishëm në krijimin e ushtrisë shqiptare moderne gjatë viteve 1920-1930.

Kontributi: Organizoi dhe centralizoi ushtrinë shqiptare; Forcoi institucionet ushtarake dhe krijoi Akademinë Ushtarake; Mbajti një politikë të mbrojtjes kombëtare kundër ndërhyrjeve të jashtme.

Enver Hoxha (1908-1985), Komandant i Ushtrisë Partizane dhe Udhëheqës i Shtetit

Enver Hoxha ishte lideri i Luftës Nacionalçlirimtare dhe komandanti kryesor i forcave



partizane që luftuan kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Kontributi: Udhëhoqi luftën partizane dhe çlirimin e Shqipërisë më 1944; Pas luftës, krijoi një ushtri të madhe me bazë ideologjike komuniste; Konstruktivi i bunkerëve dhe doktrina e “mbrojtjes popullore” përgatiti vendin për çdo sulm të mundshëm të jashtëm.

Mehmet Shehu (1913-1981), Gjeneral dhe Kryeministër

Mehmet Shehu ishte një nga komandantët kryesorë të Luftës Nacionalçlirimtare dhe më vonë u bë kryeministër i Shqipërisë, duke mbajtur kontroll të fortë mbi ushtrinë.

Kontributi: Reformoi ushtrinë dhe e forcoi në bazë të modelit sovjetik dhe kinez; Ndërtoi sistemin e fortifikimeve dhe bunkerëve në Shqipëri.

Ishte një nga strategët më të rreptë të epokës komuniste.

Kudusi Lama, Gjeneral i Ushtrisë Shqiptare gjatë viteve 1990

Kudusi Lama ishte një nga figurat kyçe në riorganizimin e ushtrisë shqiptare pas rënies së komunizmit. Ai ndihmoi në transformimin e ushtrisë nga një model komunist në një ushtri më të standardizuar sipas NATO-s.

Kontributi: Modernizoi strukturat ushtarake të Shqipërisë; U angazhua në integrimin e ushtrisë shqiptare në standardet perëndimore; Mbështeti reformat për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO.

Bajram Begaj, President dhe ish-shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare

Bajram Begaj, i cili ka shërbyer si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Arma-

tosura të Shqipërisë dhe më pas u zgjodh President i Republikës, ka luajtur një rol kyç në transformimin e ushtrisë shqiptare në epokën moderne.

Kontributi: Drejtoi modernizimin dhe profesionalizimin e ushtrisë shqiptare; Përforcoi partneritetin me NATO-n dhe fuqizoi rolin e Shqipërisë në misionet ndërkombëtare;



betare; Përfaqësoi një brez të ri të liderëve ushtarakë të angazhuar në standardet globale të mbrojtjes.

Lidershipi ushtarak shqiptar ka evoluar nga strategji mesjetare si Skënderbeu te liderët modernë të integruar në NATO. Çdo periudhë historike ka prodhuar liderë që kanë përshtatur strategjinë dhe organizimin ushtarak sipas sfidave të kohës.

Sot, Shqipëria është pjesë e NATO-s dhe ushtria e saj po kalon një fazë modernizimi dhe profesionalizimi, duke reflektuar një qasje të re strategjike për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Lidershipët e rinj të ushtrisë shqiptare dhe botëkuptimi i tyre në drejtim

Lidershipi i ri i Forcave të Armatosura të Shqipërisë po përfaqëson një qasje moderne dhe të integruar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe angazhimet e vendit në aleanca si NATO. Ky transformim reflekton një botëkuptim të orientuar drejt profesionalizmit, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përshtatjes ndaj sfidave të reja të sigurisë.

Karakteristikat kryesore të këtij botëkuptimi

Profesionalizimin dhe Edukimi i Avancuar: Liderët e rinj ushtarakë theksojnë rëndësinë e arsimit të lartë ushtarak dhe trajnimeve specifike për të rritur aftësitë strategjike dhe operacionale.

Integrimin në Strukturat Ndërkombëtare: Me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, lidershipi ushtarak është fokusuar në harmonizimin e procedurave dhe standardeve me ato të aleatëve, duke marrë pjesë aktive në misione paqeruajtëse dhe stërvitje të përbashkëta.

Përdorimi i Teknologjisë së Avancuar: Adoptimi i teknologjive moderne në komunikim, mbikëqyrje dhe logjistikë është një prioritet për të përmirësuar efikasitetin dhe reagimin e shpejtë të forcave të armatosura.

Përshtatja ndaj Kërcënimeve të Reja: Liderët e rinj janë të vetëdijshëm për sfidat e sigurisë kibernetike, terrorizmit dhe kërcënimeve asimetrike, duke zhvilluar strategji për t'u përballur me to në mënyrë efektive.

Transparenca dhe Llogaridhënia: Në përputhje me reformat demokratike, ushtria po promovon një kulturë transparence dhe llogaridhënieje, duke forcuar besimin e publikut dhe duke siguruar një menaxhim të përgjegjshëm të burimeve. Ky botëkuptim i ri synon të sigurojë që Forcat e Armatosura të Shqipërisë të jenë të gatshme dhe të afta për të mbrojtur interesat kombëtare, duke kontribuar njëkohësisht në paqen dhe stabilitetin rajonal dhe global.



SHKOLLA **LEGJENDË** ME HISTORI TË LAVDISHME



Prof. Asoc. Dr. **BERNARD ZOTAJ**



28 marsi 1945, është një ditë e paharruar e shënuar dhe simbol, ditë historike në kujtesën e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

28 marsi 1945, është një ditë e paharruar e shënuar dhe simbol, ditë historike në kujtesën e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Në këto ditë hapi dyert shkolla e pionierëve të luftës, me 200 partizanë të vegjël, midis të cilëve dhe 7 vajza. Komandanti i parë i shkollës, Thoma Frashëri, thërriti një staf të zgjedhur mësuesish e komanduesish, me të cilët shkroi historinë e ditëve dhe të viteve të para të shkollës.

Në program u vendosën plotësisht lëndët e arsimit të përgjithshëm dhe lëndë të formimit ushtarak. Në tërë veprimtarinë e saj, shkolla kishte një trupë pedagogjike e komanduese të nivelit të lartë. Mësuesit dhe oficerët ishin të përgatitur, kërkuar, këmbëngulës dhe të përkushtuar në kryerjen e detyrës. Shumë prej tyre ishin diplomuar jashtë shtetit në perëndim, si në Itali, Gjermani, Austri dhe BS. Të pajisur me njohuri, të gjera shkencore, trupa pedagogjike bëri përpjekje të vijueshme që dijet e fituara t'ua jepnin me devotshmëri e përkushtim çdo skënderbegasi. Mësuesit dhe kuadrot ushtarakë, i gjeje pranë skënderbegasve, duke treguar kujdes të veçantë.

Në fillesat e para të saj, shkolla nuk kishte bazë materiale mësimore, as kabinete e laboratorë. Por falë punës pasionante e këmbëngulëse të oficerëve e mësuesve, shkolla u modernizua. Programi arsimor i shkollës realizonte ndërthurjen e arsimit të mesëm me atë të edukimit fizik e ushtarak. Stërvitja ushtarake ishte e planifikuar dhe zhvillohej me intensitet të lartë. Në këtë drejtim, një vend të

rëndësishëm zinte përgatitja rreshtore, përgatitja e zjarrit, njohja dhe përdorimi i armëve me të cilat ishte e pajisur ushtria, aftësimi i nxënësve për qitje, si dhe përgatitja taktike. Në çdo veprim që kryenin skënderbegasit vihej re një organizim i përsosur ushtarak. Rreshtimi dhe parakalimi çdo ditë të hënë, marshimet pas Malit të Dajtit, pjesëmarrja në stërvitje me trupa, në spartakiada e manifestime, në parada, vizitat në fabrikat e uzinat ushtarake, në regjimentet e Aviacionit e të Flotës Detare, në reparte ushtarake, formonin dhe shtonin më shumë dashurinë e skënderbegasve për karrierën e tyre ushtarake.

Në vitin 1954 përfundon studimet matura e parë, e cila do të mbahet mend për rezultatet e larta të saj dhe që nga ky vit, skënderbegasit kishin mundësi të vazhdonin studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe më vonë në të Marinës e Aviacionit. Sukseset dhe arritjet e Shkollës “Skënderbej” nuk mund të realizoheshin pa kontributin e pazëvendësueshëm të stafit pedagogjik e ushtarak të shkollës. Atyre iu takon çdo sukses i arritur. Çdo arritje e skënderbegasve e ka bazën tek mësimet që morën nga mësuesit e tyre të mrekullueshëm, të cilët ishin më të zgjedhurit në Tiranë e më gjerë. Ata nuk ishin vetëm mësues e pedagogë, por siç thotë populli me tërë kuptimin e fjalës, ishin shpirt njeriu, që dinin të administronin me kujdes ndjenjat e skënderbegasve.

Pas viteve '60 Shkolla “Skënderbej” u bë burimi kryesor i furnizimit të shkollave ushtarake në vend. Misioni i saj ishte përgatitja e nxënësit me kulturë

të përgjithshme ushtarake, duke vënë në themel të programit mësimor lëndët kryesore të arsimit të përgjithshëm, për të vazhduar studimet e larta jo vetëm në shkollat ushtarake, por dhe në universitetin shtetëror. Shkolla dhe stafi drejtues tregonte kujdes të veçantë për pajisjen e skënderbegasve me kulturë të përgjithshme qytetare dhe ushtarake. Kështu në programin mësimor, krahas lëndëve të formimit të përgjithshëm arsimor si gjuhë shqipe, letërsi, histori, gjeografi, gjeometri, trigonometri, algjebër, analizë matematike, astronomi, biologji, kimi, fizik, gjuhë e huaj anglisht, rusisht, punë mekanike, kujdes tregohej për lëndët ushtarake dhe përgatitjen fizike që shërbente në përballimin e vështirësive të profesionit të ushtarakut.

Në vitin 1961 në shkollën “Skënderbej” u shtuan dhe grupet mësimore për mjekësi dhe kulturë. Ndërsa në vitin 1963 për nevojat e ushtrisë pranë shkollës u krijua një kompani që studionte në shkollat profesionale Politeknikumi “7 nëntori”, Shkolla e Mesme Ekonomike, Politeknikumi Mjekësor dhe Shkolla e Kulturës.

Prej vitit 1968 e në vazhdim, maturantët me rezultate të larta në mësim, ndiqnin studimet në Universitetin e Tiranës. Shumë skënderbegas dolën në jetë inxhinierë, mjekë, ekonomistë, gazetarë, kineastë, operatorë, historianë, fizikanë, redaktorë letrarë, artistë, trajnerë, etj. Të gjithë punuan e drejtuan sektorë të ndryshëm të ushtrisë, si dhe në jetën civile në pushtet dhe në ekonominë shqiptare. Koha ka treguar dhe vërtetuar se kuadrot që dolën nga kjo shkollë e justifikuan plotësisht besimin e familjeve dhe të shoqërisë në shërbim të detyrës të mbrojtjes së vendit. Nga bankat e saj kanë dalë ushtarakë madhorë, gjeneralë, profesorë, shkencëtar, pedagogë, deputetë, politikanë, ambasadorë, aviatorë, poetë, shkrimtarë, biznesmenë etj.

Shkolla Ushtarake “Skënderbej” nuk mund të qëndronte e shkëputur nga problemet e zhvillimit të vendit. Skënderbegasit punuan dhe kontribuan në ndërtimin e veprave të pesëvjeçarëve, në hapjen e rrugëve, në veprat energjetike dhe në ndërtimin e hekurudhave. Aktivitetet ku mori pjesë Shkolla “Skënderbej” ishin: tharja e kënetës së Maliqit në vitin



1950, hapja e tokave të reja në Bizë të Martaneshit në vitin 1966, ndërtimi i rrugës së Malësisë së Madhe në vitin 1968, hapja e tarracave për agrume në brigjet e Jonit në Lukovë e Ksamil në vitin 1971, tarraca këto që për vite me radhë do të thirrreshin me emrin e shkollës “Skënderbej”, ndërtimi i hekurudhës Librazhd-Përrenjas në sektorin e Qukësit në vitin 1973, etj. Shkolla ka marrë pjesë në mjaft aksione në ndihmë të bujqësisë në fshatrat e Lezhës, Lushnjës e Fierit. Kjo listë e kontributeve të shkollës nuk është e plotë, sepse aktivitetet e saj janë të panumërta.

Skënderbegasit kanë të drejtë të krenohen me shkollën, sepse kjo shkollë, krijoi një traditë të shkëlqyer në përgatitjen e kuadrove për vendin, dhe ka lënë gjurmë në Forcat e Armatosura. Me programet e saj në përmirësim çdo vit mësimor mundësoi përgatitjen e oficerit të edukuar, të disiplinuar, të aftë dhe me botëkuptim atdhetar, në shërbim të



atdheut. Të gjitha këto cilësi u manifestuan në vite, por në mënyrë të veçantë në vitet '90, në kohën e transformimeve të thella të ndryshmit të sistemit shoqëror. Gjatë këtij procesi spikati figura e oficerit qytetar, korrekt, besnik ndaj popullit dhe vendit, e që përkrahu proceset demokratike në vend.

Në shtator të vitit 1992, shkolla mbylli dyert për nxënësit e saj skënderbegas, ëndrrat e të cilëve u ndërpre në mes. Drejtori i fundit i shkollës Shkëlqim Dervishaj, ka theksuar se mbylljen e shkollës në mënyrë krejt arbitrare e të papritur, pa marrë parasysh mundësitë që krijonin zonat nga vinin nxënësit, për arsimin e mëtejshëm të tyre, e quan një vendim të keq. Në atë vit, drejtori shprehet se nuk mund ta mendonin e as ta besonin se ky monument historik do të etiketohej si shkollë “jeniçerësh”, në një kohë kur ishte përgatitur një armatë kuadrosh nga më të diturit e nga më atdhetarët, me kontribute të çmuara në jetën e vendit. Për fat të keq, shumë mendje të çoroditura e dashakeqe, nuk e kanë kuptuar dhe nuk duan të kuptojnë shpirtin e rrallë dhe krejtësisht demokratik të skënderbegasit, ku valon vetëm e përparua dhe atdhedashuria. Shkolla “Skënderbej” nuk ekziston më, por askush nuk mund ta errësojë lavdinë e saj. Në fakt, vendi, e veçanërisht ushtria, humbën një legjendë, që iu deshën 47 vjet për t'u bërë ikona e arsimit shqiptar, simboli i dijes dhe i kulturës, i edukimit ushtarak dhe atdhetar. Shkolla Ushtarake “Skënderbej” i ka sot dyert e mbyllura dhe nuk mund të hyhet në gjirin e saj. Sot ka një shoqatë, e cila ka hapur dyert e dritaret për të gjithë skënderbegasit, mësuesit e oficerët që punuan e kontribuan për ta bërë shkollën elitë të arsimit shqiptar, që me të drejtë ka merituar titullin “Nderi i Kombit”.

Po mbushen 33 vite që nuk ka më Shkollë të Mesme Ushtarake “Skënderbej”, nuk ka më skënderbegas, imazhi i adoleshentëve me uniformë. Kjo i përket të kaluarës. Por shkolla “Skënderbej” tashmë ka hyrë në historinë e kombit dhe në këtë histori mban një kontribut të rëndësishëm e të veçantë.





SHKOLLA SKËNDERBEJ DHE DREJTUESIT E SAJ



Prof. Asoc. Dr. **ZAHO GOLEMI**



Në kuadër të 80-vjetorit të krijimit të shkollës ushtarake “Skënderbej”, që ishte dhe mbeti në historinë e arsimit ushtarak shqiptar një shkollë-legjendë e edukimit të së ardhmes së ushtrisë popullore shqiptare, një pioniere arsimit dhe fidanishte e ushtrisë, që në 47 vite (1945-1992) ka përgatitur 34800 të diplomuar nxënës elitarë; që në një vit kishte rreth 1500-2000 nxënës, ku përgatiteshin me dije të përgjithshme arsimore dhe ushtarake.

Në kuadër të 80-vjetorit të krijimit të shkollës ushtarake “Skënderbej”, që ishte dhe mbeti në historinë e arsimit ushtarak shqiptar një shkollë-legjendë e edukimit të së ardhmes së ushtrisë popullore shqiptare, një pioniere arsimit dhe fidanishte e ushtrisë, që në 47 vite (1945-1992) ka përgatitur 34800 të diplomuar nxënës elitarë; që në një vit kishte rreth 1500-2000 nxënës, ku përgatiteshin me dije të përgjithshme arsimore dhe ushtarake. Ka 33 vite që nuk funksionon më SHMU “Skënderbej”, nuk ka më “begsa” me imazhin e adoleshentëve me uniformë, një imazh i patriotizmit shqiptar që nuk do të shuhet kurrë.

Në plejadën e arsimit ushtarak shqiptar shkolla “Skënderbej” zë një vend nderi, respekti dhe mirënjohje. Nëse bëjmë një përshkrim të shkurtër të arsimit ushtarak të para LANÇ-it, janë disa stacione të rëndësishme sikurse është edukimi ushtarak për shqiptarët me natyrë luftëtari, si një “..trajtë e përbashkët, karakteri, një atribut i qëndrueshëm i këtij kombi”, si “kasta luftëtare e Ballkanit me armë në dorë”, sipas Eqrem Çabej. Ndërkohë që njihet edukimi ushtarak në kohën e Motit të Madh të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, edukimi ushtarak në shtet-pashallëqet e Shkodrës (1757-1831) dhe Janinës (1786-1822) me elementë të veçuar të edukimit e arsimit ushtarak, e theksuar kjo në shkollën e Bonilës në Janinë për kavaleri, këmbësori/zbulim, artileri dhe xhenio. Kjo përpjekje e Ali Pashë Tepelenës për ngritjen e institucionit të mirëfilltë ushtarak zbulohet edhe përmes arkivave, ku në një letër që Pashai i Janinës i shkruan

Napoleon Bonopartit: “..kërkoj dy oficerë artilerie dhe dy bombahedhës që të shërbejnë si organizatorë dhe mësues të trupave të artilerisë në ushtrinë time..”. (Hamdi Bushati, Shkodra dhe motet, Vëllimi II, 1999, faqe 33). Në Shkodër, më 1902, Valiu dhe Komandanti i Divizionit osman të Shkodrës, Shaqir Pasha hapi një shkollë ushtarake që u emërtua “Mejtepi Ruzhdije i Asqerie”, që do nxiste vijimin e studimeve ushtarake për nxënësit shqiptarë. Tradita vijoi me austro-hungarezët më 1916, kur vendi ishte ndarë në zona midis forcave pjesëmarrëse në LIB dhe Komandës austro-hungareze, e cila zgjodhi 40 djem shqiptarë që u dërguan për studime në Austri (“Shqipënia më 1937”, Vëllimi II (1912-1937), Tiranë, 1938, fq. 89). Arsimit ushtarak institucional në Shqipëri i përket vitit 1919 me çeljen e shkollës ushtarake që përgatiste oficerë e xhandarë; më 1928, çelët Shkolla e parë Mbretërore Ushtarake. Shkollat ushtarake u bënë pjesë e përhershme e strukturës organizative të Forcave të Armatosura. Ato vazhduan të përcaktoheshin mbi bazën e ligjeve të shtetit. Programet e shkollave ushtarake ishin të orientuara nga vendet perëndimore. Tradita e arsimit ushtarak shqiptar u pasurua më tej në vitet e LANÇ-it, kur më 8.11.1944, në prag çlirimi, në qytetin e çliruar të Beratit, u çel Kursi i Parë i Oficerëve. Ky kurs do të shërbente si pikënisje edhe për hapjen e shkollave apo akademive të tjera ushtarake. Pra edukimi ushtarak nuk është një rastësi në Shqipëri. Ai ka origjinalitetin e tij dhe mbështetet në një përvojë të gjatë shumëvjeçare, për të mbërritur tek “Shkolla e Pionierëve të Luftës”, e pasuar nga SHMU “Skënderbej”.



Shkollat Ushtarake, ky imediat i kohës i pas LANÇ-it Përshkollën “Skënderbej” dhe skënderbegasit e shkollës së “Pionierëve të Luftës” dhe më tej Skënderbegasit, është shkruar dhe do të shkruhet, pasi kjo shkollë u çel plot optimizëm më 1945 dhe u mbyll dhunshëm më 1992 nga politika e kohës. Ishte realisht ndër shkollat më të mira të vendit dhe një vatër e rëndësishme, ku përgatiteshin kuadrot e ardhshëm të ushtrisë shqiptare, duke zënë një vend të rëndësishëm në historinë e arsimit dhe të mbrojtjes së vendit.

Furia e luftës antifashiste partizane u finalizua me çlirimin e vendit, më 29 nëntor 1944. Shqipëria e përflakur nga lufta kërkonte drejtim dhe përsosjen e kuadrit ushtarak të dalë nga lufta. Disa ditë pa përfunduar lufta, kursi i parë i perfeksionimit të oficerëve kishte për synim përgatitjen e drejtuesve ushtarakë të nënkomandantëve të batalioneve dhe kompanive të Divizioneve I dhe III Sulmues si dhe disa Brigadave sulmuese partizane, ku morën pjesë 220 pjesëmarrës. Ndërsa dhjetë ditë pas çlirimit, më 8.12.1944, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së u dërgonte njësitë të ushtrisë një letër, ku shkruhej: “...të bënin gati partizanë 12-15-vjeçarët për t’i dërguar në shkollë”. Drejtuesit më të lartë të luftës çlirimtare e poqën plotësisht mendimin për krijimin e shkollës ushtarake dhe, më 28 mars 1945, në Tiranë çelën “Shkollën e pionierëve të Luftës”, me 200 partizanë të vegjël, edhe shtatë vajza, në godinat që mbanin erën e luftës, gjysmë të prishura. Klasat dhe fjetoret ishin sheshet dhe fushat e stërvitjes. Drejtuesit e shkollës ishin të orientuar më shumë nga programet e stërvitjes praktike se sa nga aspekti teorik. Këtu farkëtohej e ardhmja e Ushtrisë Kombëtare shqiptare që më vonë u quajt “Ushtria Popullore”. Përgatitja e drejtuesve të

strukturave ushtarake ishte imediate. Dy vjet pas hapjes së shkollës së pionierëve me urdhër, Nr. A 1-85, datë 11.2.1947, shkolla e Pionierëve të Luftës mori emrin Shkolla Ushtarake “Skënderbej”, dhe pati një vlerësim maksimal të strukturave politike dhe shtetërore ushtarake. Vendosija e këtij emri ishte nder dhe respekt që iu bëhej brezave të rinj ushtarakë, ndërkohë që shkolla nisi veprimtarinë në garnizonin ushtarak të Laprakës, më tej tek Regjimenti i Ndërlidhjes e, së fundi, u vendos në ish-kompleksin e shkollave ushtarake (aty ku sot është SHISH). Në mjediset e shkollës kurdoherë u tregua kujdes që skënderbegasve t’u krijoheshin të gjitha kushtet e mundësitë për studim e stërvitje. Nga viti në vit kushtet dhe procesi mësimor edukativ erdhën duke u përmirësuar. Në periudhën 1947 deri më 1953, skënderbegasit morën arsim 7-vjeçar, disa klasë të mesme dhe njohuri ushtarake, ku drejtuesit e gjithë niveleve punuan shumë edhe për krijimin e laboratorëve për fizikë e kimi. Kjo përkon edhe me masat që kjo shkollë potenciale pra Shkolla “Skënderbej” të bëhej shkollë e mesme e arsimit të përgjithshëm, duke përfshirë në të edhe lëndë të karakterit formal ushtarak. Në programet mësimore Komanda e shkollës përfshiu lëndë si përgatitja rreshtore, njohje e rregulloreve të jetës ushtarake, si të jetës së brendshme, të shërbimit dhe të disiplinës, përgatitje zjarri, njohuri në përdorimin e armatimit të lehtë dhe automobilizëm. Shkolla mbështetej me një trupë pedagogjike të përgatitur dhe me nivel të lartë, ku mësuesit dhe oficerët ishin këmbëngulës dhe të përkushtuar. Shumica e tyre kishin studiuar e mësuar në shkollat e huaja, si në Itali, Gjermani, BS, Austri etj. Si shkollë e mesme e përgjithshme bëhej kujdes

i madh që të mësohej mirë gjuha shqipe dhe letërsia, historia e gjeografia e Shqipërisë si dhe lëndët e domosdoshme si matematika e fizika, kimia e biologjia e ato që shërbenin për studimet në fushën e njohjes dhe të përdorimit të armëve vetjake luftarake. Lëndë të rëndësishme konsideroheshin përgatitja fizike dhe marrja e njohurive ushtarake, që jo vetëm të bëheshin qytetarë me formim të shëndoshë, por të përballonin sa më mirë lodhjet dhe vështirësitë si bashkudhëtarë në ushtri. Në vitin 1963 u krijua një kompani me skënderbegas, që studiuuan në mjaft shkolla profesionale të vendit, si në Politeknikumin “7 Nëntori”, në Shkollën e Mesme Ekonomike, në Politeknikumin Mjekësor, në shkollën e kulturës, pra në ato profile ku ndihej nevoja e profilizimit në ushtri. Nga viti 1968 e në vazhdim, maturantët me rezultate të larta në mësim ndiqnin studimet në Universitetin e Tiranës, dhe i dhanë vlerë edhe më të lartë shkollës, pasi nxënësit që u përgatitën në këtë shkollë shkëlqyen në shumë fusha të jetës. Fakt është se struktura organizative e shkollës “Skënderbej” përbëhej nga tre shtylla kryesore: Komanda dhe trupa ushtarake e mbështetëse, drejtoria arsimore dhe mësuesit civilë, trupa e nxënësve. Komandanti i shkollës ishte përgjegjësi kryesor për të gjithë efektivin e shkollës, ushtarak dhe civil. Ai drejtonte shkollën në bazë të ligjeve, urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Arsimit dhe rregulloreve ushtarake. Ai përgjigjej për gjendjen moralo- psikologjike e disiplinore të nxënësve, për kushtet e jetesës dhe mësimdhënies, si dhe detyra të tjera të përcaktuara në rregulloret e kohës. Drejtori dhe trupa pedagogjike civile përgjigjej për drejtimin dhe zhvillimin e procesit mësimor në bazë të programit të shkollës së mesme të përgjithshme në rang vendi. Aty mësohej historia, gjeografia, gjuha shqipe, letërsia, fizika, kimia, biologjia, astronomia, trigonometria, gjuha ruse dhe angleze etj. Lëndë të rëndësishme konsideroheshin edhe përgatitja fizike, marrja e njohurive ushtarake në bazë të kodit moral të ushtarakut: “Detyra – Nderi – Atdheu”. Komandanti dhe drejtori civil i shkollës ishin dy figurat kryesore, më autoritare dhe më të respektuara, që harmonizonin programin e edukimit civilo-ushtarak. Edhe pse jeta e brendshme dhe aktiviteti ishte për njëzetekatër orë, kryhej si në një repart ushtarak, trupa pedagogjike





ishte e lidhur ngushtë me këtë organizim. Oficerët, nënoficerët e mësuesit civilë dalloheshin për kujdesin e jashtëzakonshëm dhe dashurinë ndaj nxënësve skënderbegas, që ishin nga më të mirët të përzgjedhur në ushtri apo gjimnazet e vendit. Shquheshin për meritat e tyre në lidhje me korrektësinë, kreativitetin, performancën e lartë profesionale dhe qytetare, duke kultivuar te skënderbegasit pasionin dhe dashurinë për atdheun dhe profesionin e ushtarakut. Shkolla ishte repart dhe shtëpia e dytë për drejtuesit e kësaj shkolle, ku performanca ishte ndër më elitaret e shkollave të mesme të vendit.

Komandanti, Komisari dhe drejtuesit e parë të Shkollës “Skënderbej”

Në arkivat dokumentare ushtarake shqiptare rezulton se, “komandanti i parë i shkollës ishte Mehmet Dermenli me gradë kapiten I, komisar, toger Dule Pashaj, Shefi i degës mësimore, kapiten i parë Vangjel Doga e kapiten Thoma Frashëri. Në fillim u krijuan tre batalione me komandant e komisar kapiten Shuaip Shazi, kapiten Miço Kola e kapiten Filip Stefani. Ndërsa struktura e parë organizative u krijua si më poshtë me dy brigada: brigada IV me studentë ish-pjesëmarrës në luftë, me komandant Myfit Guxholli dhe komisar Gafer Shyti; (komandant i batalionit të parë Vasfi Rexhepi); si dhe Brigada I me uniformë kadife blu: Ylber Sevrani komandant dhe Xhevrie Golemi, komisare... Batalioni i parë, komandant Qemal Tuzi dhe Faik Meko. Veçojmë vajzat partizane që iu bashkuan kësaj shkolle që në ditët e para, ndërkohë që sipas ish-bashkëkohësve në ditën e parë të shkollës në inaugurimin e shkollës, më 28 mars 1945, mori pjesë gjeneralmajor Spiro Moisiu, komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Skënderbegasit, pjesëmarrës në luftë, armët i mbanin nën jastëk dhe nuk i dorëzonin në depo, një e dhënë e përsëritur dhe e rishkruar si fenomen, që në atë kohë e quanin të ligjshëm mbajtjen e armës pranë vetes. Por në historikun e zhvillimeve ushtarake edhe vajzat kanë qenë prezent që në ditët e para të shkollës sikurse kanë qenë Veronika Murzaku, Katerina Prifti, Xhevrije Golemi, Bukurie Malo etj., (në mënyrë plotësisht institucionale vajzat u pranuan për oficerë në SHLBO në vitet 1967-1969). Drejtuesit e Shkollës u kujdesën që të përthithin që në fillim ajkën e mësuesve të Tiranës. Kështu stafi i mësuesisë përbëhej nga emra të njohur të kohës si, Barie Kopliku, Halit Narazuni, Hysni Alimerko, Ahmet Tufa, Eftimiadhi, Stavri Angjeli,

Valeria Drenova e shumë të tjerë. Puna e kualifikuar e trupit pedagogjik dhe komandës, përkushtimi i nxënësve dhe studentëve bindën drejtuesit e Ministrive të Arsimit dhe Mbrojtjes që shkolla të vlerësohej dhe të merrte emrin “Shkolla e Mesme Ushtarake Skënderbej”. Për arsye se shkolla nuk kishte klasa të dyta e të treta të mesme, skënderbegasit dërgoheshin në gjimnazin “Qemal Stafa” si p.sh. Pavlo Dede, Myfit Guxholli, Agron Starova dhe shumë të tjerë. Edhe me kalimin e viteve kujdesi dhe vëmendja e drejtorisë së Kuadrit në Ministri të Mbrojtjes ishte pikërisht për trupin pedagogjik cilësor, sikurse edhe strukturat e tjera drejtuese në Ministri dhe në Shtab të Përgjithshëm kujdeseshin për jetë të gjallë dhe të përkushtuar, me kabinetet e reja, laboratorët, ambientet e komandës dhe të një jetese normale, bënë që shkolla “Skënderbej” të rriste treguesit cilësorë dhe sasiorë. Cilësitë dhe virtytet e skënderbegasve si besa, trimëria, solidariteti, dashuria e devotshmëria për Atdheun, familjen e shokun, ishin më të çmuarat për skënderbegasit, që në çdo çast ecnin në gjurmët e lavdishme të LANÇ-it. Këto cilësi e virtyte u demonstuan më së miri gjatë provokacionit të gushtit kur monarko-fashistët grekë tentuan të preknin kufirin tonë shtetëror. Shumë skënderbegas kërkuar të shkonin vullnetarisht në mbrojtje të kufirit, por Ministria e Mbrojtjes konsideroi pjesërisht kërkesën e tyre. Bijtë e popullit që zbritën nga formacionet partizane antifashiste shkruan historinë e ditëve dhe të viteve të para të shkollës, duke zhvilluar një program të ndërthurur ushtarak dhe lëndët e arsimit të përgjithshëm, duke ofruar një kulturë të përgjithshme. Në tërë veprimtarinë e saj shkolla bashkë me trupën pedagogjike e komanduese u rrit cilësisht ndërkohë që arsimimi dhe kualifikimi i tyre vijoi edhe jashtë shtetit, sidomos në BS, ku numri i studentëve shqiptarë e kaloi shifrën prej 1500, në rreth 44 shkolla, akademi dhe universitete. Me njohuritë e gjera shkencore, trupa pedagogjike në këtë shkollë bëri përpjekje të vijueshme që dijet e fituara t’ua jepnin me devotshmëri e përkushtim nxënësve të shkollës elitare “Skënderbej”. Mësuesit dhe kuadrot ushtarakë, i gjeje në çdo kohë pranë skënderbegasve, duke treguar kujdes të veçantë. Në fillimet e para të saj shkolla nuk kishte bazë materiale mësimore, as kabinete e laboratorë, por falë punës pasionante e këmbëngulëse të oficerëve e mësuesve, shkolla u modernizua dhe u transformua shumë shpejtë. Programi arsimor i shkollës realizonte ndërthurjen e arsimit të mesëm me atë të edukimit fizik e ushtarak. Stërvitja ushtarake ishte e planifikuar dhe zhvillohej me intensitet tepër të lartë. Në këtë drejtim,

një vend të rëndësishëm zinte përgatitja rreshtore, përgatitja e zjarrit, njohja dhe përdorimi i armëve me të cilat ishte e pajisur ushtria, aftësimi i nxënësve për qitje, si dhe përgatitja taktike. Është e natyrshme se përgatitja e lartë profesionale e begsave shpalohej edhe në syrin e publikut, që p.sh., në parakalimet në Tiranë vëmendjen maksimale e merrnin kuadratet e Skënderbegsave, por dhe në olimpiada të vendit SHM “Skënderbej” shkëlqente në matematikë, letërsi, gjuhësi, shkenca etj. Në çdo veprim që kryenin skënderbegasit, vihej re një organizim i përsosur ushtarak, rreshtimet dhe parakalimet çdo ditë të hënë, marshimet pas Malit të Dajtit, pjesëmarrja në stërvitje me trupa, në spartakiada e manifestime, në parada, vizitat në fabrikat e uzinat ushtarake, në regjimentet e Aviacionit e të Flotës Luftarake Detare, në reparte ushtarake, formonin dhe shtonin më shumë dashurinë e skënderbegasve për karrierën e tyre ushtarake. Një fakt që duhet evidentuar është se, gjatë vitit shkollor 1945-1946 shkolla ishte pajisur me mjetet e nevojshme për mësim dhe jetesë, por edhe Programet këtë vit ishin më të studiara dhe mësimi zhvillohej në rregull. Nxënësit kishin në përdorim tekstet e para. Kultura e përgjithshme jepej sipas programit të aprovuar nga Ministria e Arsimit. Në këtë shkollë zhvilloheshin dhe dy gjuhë të huaja, jugosllavishtja dhe rusishtja. Më shumë pionierë kishte në klasat e fillores dhe 7-vjeçares. Këtë vit u krijua dhe një klasë me nxënës që vazhdonin mësimet në shkollën e mesme “Qemal Stafa”. Prej këtu nisi rrugëtimi i suksesshëm i kësaj shkolle. Fakt është se kuadrat drejtues, oficerët komandues, mësuesit dhe gjithë ata që punonin në këtë shkollë përzgjidheshin në të gjithë dekadat. Edhe nxënësit përzgjidheshin për të studiuar në këtë shkollë me kriteret specifike, natyrisht vetëm për djemtë më të mirë, ndër vite e dekada. Këtu niste rrugëtimi i jetës ushtarake, këtu përgatiteshin elitat e ardhshme të Ushtrisë, këtu përgatitej dhe formoheshin personalitetet ushtarake të vendit në radhë të parë. Por

nga kjo shkollë kanë dalë edhe personalitete të tjera që kanë shkëlqyer në fushën e diplomacisë, shkencës, inxhinierë, mjekë, në fushën e letrave shqipe, pushtetarë, deputetë, ministra e presidentë. Dhjetëra e qindra skënderbegas kanë rrezatuar në sektorët më delikate e prioritarë të vendit. Nga kjo shkollë kanë dalë drejtues me frymë të lartë kolektiviteti dhe bashkëpunimi që kanë qenë dobiprurës, ku morën metodologjinë e drejtimit tek stafi komandues e pedagogjik i shkollës “Skënderbej”. Janë me qindra drejtuesit komandantët, komisarët, drejtorët e shkollës, mësuesit dhe komandantët e togave që kanë qenë në çdo orë pranë skënderbegsave, janë të shumtë me qindra dhe arkivat flasin qartë edhe për SHMU “Skënderbej”. Kjo ishte shkollë e disiplinës, ku rreshtorja, rreshti i ndiqte kudo që shkonim, në mësim, në studim, në mensë, fjetinë, në gjimnastikë e kudo. Aty merrnim elementet e parë të disiplinës ushtarake, aty e dëgjuan begsat për herë të parë se në ushtri: “do të flesh kur nuk të flihet dhe do të hash kur nuk të hahet”, pasi çdo veprim që kryenim vihej re një organizim i përsosur ushtarak, që përgatiste elitën e ardhshme ushtarake të vendit.

Por le të sjellim disa prej tyre si nderim, respekt e mirënjohje për ata që jetën e shkrinë për lartësimin në dije të Begsave të njohur në mbarë hapësirën shqiptare: Kapiten I Mehmet Dermenli, toger Dule Pashaj, Shefi i degës mësimore, kapiten I Vangjel Doga, kapiten Thoma Frashëri, kapiten Shuaip Shazi, kapiten Miço Kola, kapiten Filip Stefani, Isuf Bobaj, Shuaip Llaze, Filip Stefani, Kadri Mulleti..., 25 arsimtarë që erdhën fillimisht si: Mellani Hanxhari, Vlash Çepiku, Dervish Bejleri etj. Drejtues të tjerë të talentuar të kësaj shkolle kanë qenë: Luto Haxhiu, Meço Starja, Agim Tepelena, Mikail Vaso, Novruz Sako (Turku), Drini Nikolla, Behar Salillari, etj., apo mësuesit Stavri Angjeli, Adriatik Kallulli, Perikli Jorgoni, Kozma Vasili, Flutura Xoxe, Agime Cela, Marije Nano, Viron Cinxo, Viron Tane, Vedat Cami, Ali Neviri, Hëna Golemi e dhjetëra e dhjetëra të tjerë që janë e do të mbeten modeli i mësimdhënësve. Në 47 vite të funksionimit të Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, në të kanë punuar qindra mësues, pedagogë, ushtarakë dhe punonjës të shërbimeve të ndryshme. Në Arkivin Qendror të Ministrisë së Mbrojtjes ruhen regjistrat themeltar, dosjet përkatëse, së fundi dhe të dixhitalizuar, burime të cilat kanë shërbyer për hartimin e listës në vazhdim me 866 komandantë, komisarë, drejtorë, dhe mësues dhe funksione të tjera mbështetëse. Nderimi dhe mirënjohja shkon për: Ali Muharrem Neviri, mësues; Anastasi Dhame Pite, mësuese; Afërdita Neki Leskaj (Çepani), mësuese; Asimaq Misto Proko, mësues; Avdi Xhuglini, mësues; Ana Ndoc Prifti, mësuese; Andon Vasil Gjymshana, mësues; Ana Palok Ngjeçi, mësuese; Aleksandër Eftim Dheri, mësues; Arta Leka (Raveli)-mësuese, administratore; Ali Kasmi, mësues, Asimaq



Proko, mësues; Aleksandër Gjollma, mësues; Ali Kastrati, mësues; Aqif Muça, oficer; Agim Çela, mësues; Abaz Balla, oficer; Agim Hasan Poturi; Agim Tepelena, komisar shkollë; Bajram Shamku, drejtor shkollë; Bedri Gjergji, komisar shkollë; Et'hem Ruçi, komisar shkollë; Ferit Radovicka, komandant shkollë; Hysen Ymeri mësues ushtarak; Koço Lako, komisar shkollë; Islam Poçi, shef Shtabi i shkollës; Meço Starja, komandant shkollë; Mikail Vaso, Komandant shkollë; Sotir Polena, komandant shkollë; Skënder Kulbara, komisar shkollë; Thoma Frashëri, komandant shkollë; Tahir Minxhozi, Sek. Komitetit Partisë; Zija Baja, komandant shkollë; Limoz Velu komisar shkollë e deri tek kolonel Petrit Malaj që ka qenë komandant i fundit i kësaj shkollë, dhe mjaft të tjerë të spikatur të përshkruar në kolanën e veprës “Skënderbegasit ndër vite...”, i autorëve Maksim Fejzulla e Kujtim Boriçi. Komandantët, drejtuesit dhe mësuesit e shkollës “Skënderbej”, shkruan një faqe të ndritur lavdie edhe si edukator edhe si prindër. Ishin po këta “prindër” që do të vazhdonin të shkruanin, të rrënjosnin tek ata atdhetarizmin, idealet e larta të besnikërisë ndaj Atdheut, dashurisë për Shqipërinë, për familjen, për shokët, për të dhënë edhe jetën po të ishte nevoja në emër të këtyre idealeve.

Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej”

që diplomonte intelektualë ushtarakë

Shkolla “Skënderbej” në 47 vite diplomoi 34,800 nxënës. Suksesi i saj ka qenë i padiskutueshëm. Për gati gjysmë shekulli (1945–1992) nga kjo shkollë dolën kontingjente për Shkollën e Këmbësorisë, Aviacionit dhe Marinës, por edhe për degët dhe shërbimet e tjera në radhët e Ushtrisë Popullore. Për nevojat e tjera të ushtrisë kontingjentet plotësues merreshin nga gjimnazet dhe shkollat 4-vjeçare profesionale të vendit, ku në pamje të parë duken shifra të larta për një vend të vogël si Shqipëria, por në politiken e sigurisë dhe të strategjisë mbrojtëse të vendit. Shteti shqiptar i para viteve 1990, parashikonte që ushtria do të funksiononte mbi bazën e parimit të rekrutimit të përgjithshëm të resurseve njerëzore në rast lufte si dhe mbrojtjen territoriale të vendit “pëllëmbë për pëllëmbë”, një koncept i aplikueshëm sipas AUP. Në përputhje me këtë parim, ushtrisë shqiptare (1945–1990) i duhej një strukturë e nevojshme me të gjitha llojet e forcave tokësore, ajrore e detare, duke arritur kulmin me organizimin e 22 divizioneve me mbi 150 brigada e regjimente, qindra batalione, njësi speciale e logjistike. Një forcë të madhe përfaqësonin edhe Forcat Ajrore, Forcat Detare, Forcat e MKA, akademitë dhe shkollat ushtarake të Trupës, Forcat e Rinise Studentore të Armatosur, Forcat Vullnetare në shkallë vendi, industria ushtarake etj. Kjo strukturë kërkonte kuadrot e saj për të organizuar, drejtuar dhe udhëhequr të gjitha kapacitetet e saj njerëzore, të armatimit, teknikës luftarake, mbështetjes logjistike, edukimit, stërvitjes, industrisë ushtarake,

fortifikimit, zhvillimit të shkencës ushtarake etj. Ushtria shqiptare, sipas konceptit “gjithë populli ushtar”, në organikat e luftës kishte një efektiv mbi gjysmë milionë të aftë për luftë, të përfshirë në forcat operative dhe vullnetare. Të dhënat arkivore flasin qartë se duke filluar nga viti 1960 rreth 60% e nevojave të ushtrisë për oficerë merreshin nga Shkolla “Skënderbej”. Në këtë rrugë të gjatë historike, që nga brezi i parë me pionierët e luftës, deri në vitin 1992, kur shkolla u mbyll, shumë skënderbegas kanë dhënë jetën në krye të detyrës dhe janë shpallur dëshmorë të atdheut si në aviacion, këmbësori, xhenio, artileri etj. Me mijëra kanë dalë në pension dhe të tjerë vazhdojnë të shërbejnë në radhët e Forcave të Armatosura si drejtues e komandantë të të gjitha niveleve, deri në nivelet e drejtimit në Shtabin e Përgjithshëm.

Si përfundim: Shkolla “Skënderbej” ishte misionare e suksesshme e strukturës së mbrojtjes së vendit që ishte e suksesshme, por rruga e saj u ndërpre dhunshëm dhe në mënyrë të padrejtë. Vendet homologe miq e partnerë i kanë ende këto shkolla dhe i kanë forcuar dhe konsoliduar këto në një situatë kaotike ndërkombëtare. Fakt është se skënderbegasit kanë shkëlqyer në artin e të drejtuarit si komandantë e komisarë të njësive, reparteve e nënreparteve të ushtrisë, si shtabnikë të niveleve të larta profesionale. Edhe në punën krijuese të dhjetëra e qindra intelektualëve të artit e kulturës, edhe drejtuesit e sportistët e talentuar të të gjitha llojeve të sporteve, që janë me dhjetëra e qindra të tillë, baza e suksesit të tyre, ka qenë natyrshëm Shkolla Ushtarake Skënderbej. Por jo vetëm kaq. Të gjithë këta, kanë meritën që Shqipërinë, e kanë bërë aq të njohur edhe në arenën ndërkombëtare, e njohur për talentet e rekordmenët e shumtë në të gjitha llojet e sporteve, dhe pjesëmarrjen e tyre në spartakiada të ndryshme, brenda e jashtë vendit. Gjatë tetëdhjetë e tetë viteve të funksionimit të saj, historia e Shkollës Ushtarake “Skënderbej” është histori suksesi, dhe si e tillë, të suksesshëm e të lavdishëm i bëri të gjitha kontingjentet e saj. Gjurmët e historisë së kësaj shkollë, jo vetëm nuk do të fshihen, por do të përcillen nga njëri brez në tjetrin në të ardhmen. Populli dhe strukturat ushtarake krenohen edhe sot mbas kaq viteve e do të krehohen edhe në të ardhmen me dramaturgë, publicistë, shkrimtarë, gazetarë, piktorë, studiues e kritikë të tillë si: Arben Duka, Kujtim Boriçi, Shpendi Topallaj, Bashkim Kozeli, Halil Qëndro, Filip Rrumbullaku, Sazan Gjomema, Spiro Xhavra, Demir Rusi, Fluturak Gërmenji, Zenun Ferro, Halil Laze, Petraq Kote, Arben Bllaci, Fuat Çeliku, Demokrat Anastasi, Mina Qirici, Shefqet Vangjeli, Apostol Duka, Thanas Tane, Pandeli Ristani, Bibë Kaza, Agron Goga, Roland Qafoku, Apostol Duka, Fejzo Lala, Bashkim Alushi e dhjetra e qindra të tjerë. Në 47 vite të funksionimit të Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”,



në të kanë punuar qindra mësues, pedagogë, ushtarake dhe punonjës të shërbimeve të ndryshme. Në Arkivin Qendror të Ministrisë së Mbrojtjes ruhen regjistrat themeltar, dosjet përkatëse, së fundi dhe të dixhitalizuar, burime të cilat kanë shërbyer për hartimin e listës në vazhdim me 866 komandantë, komisarë, drejtorë, dhe mësues dhe funksione të tjera mbështetëse. Këto janë dokumentuar më së miri në serinë e librave sinjifikativ të Kujtim Boriçit dhe Maksim Fejzullahut.

Urdhrat që hapën dhe mbyllën Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”

Vitet e jetës së shkollës “Skënderbej”, ku nisi dhe ku përfundoi rrugëtimi i Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej” (sipas burimeve arkivore autentike, dokumente pa koment):

- Urdhri që çoi në hapjen e Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej”

Udhëzim drejtuar Shtabit të Korparmatës së Parë Partizane, për t’i hequr nga ushtria partizanët me moshë të vogël dhe për t’i dërguar në shkollë! Datë 8 dhjetor 1944./ Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. / Shtabit të Korpunit I, Tiranë/ Në rreshtat e ushtrisë sonë ndodhen mjaft partizanë në moshë prej 12 deri në 15 vjeç, të cilët kanë luftuar së bashku me shokët e tyre të mëdhenj. Meqenëse për së shpejti çelen shkollat dhe duke marrë parasysh se ajo kategori ka nevojë më shumë se kushdo për arsim, kjo komandë ka vendosur që t’i heqë nga ushtria dhe të interesohet t’i verë nëpër shkolla të ndryshme, sipas

gjendjes arsimore të secilit. Prandaj do të na paraqitin urgjentisht listat e partizaneve dhe partizanëve që përfshijnë kategorinë e mësipërme, duke shënuar në të: emrin e mbiemrin, moshën, vendin e lindjes e të banimit, repartin ku bën pjesë, vjetërsinë si partizan, shkollën që ka bërë, ku, sa klasë, kur është larguar nga shkolla dhe për çfarë arsye. Për ata që s’kanë bërë shkollë do të shënohet nëse kanë marrë pjesë në kurse analfabetizmi dhe në ç’gradë janë (kulturë), ose nëse janë krejt analfabetë. Listat e përpiluara me kujdes do të na paraqiten sa më parë, sipas reparteve që i dërgojnë, pa pritur që të vijnë të gjithë për t’i dërguar./ (Shumica e këtyre luftëtarëve të UNÇL me moshë të vogël, 12-15 vjeç, u grumbulluan në shkollën e kadetëve (shkolla ‘Skënderbej’)/ Vdekje fashizmit-Liri popullit./ Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare/ Gjeneral Kolonel Enver Hoxha./ (Firmë, vulë).

- Urdhri shtetëror për mbylljen e Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej”:

Fonde arkivore të AQFA, nr. 1 viti 1992 (Titulli i dosjes), me titull “Urdhër i komandës së repartit Nr. 2222, mbi mbylljen e aktivitetit të kësaj njësie, (me cilësime të dosjes: Afat i ruajtjes së përhershme, sasia e fletëve 2, filluar më 25.8.1992, mbaruar më 25.8.1992), tekstualisht thuhet (Urdhri i plotë): Republika e Shqipërisë/ Shkolla Ushtarake “Skënderbej”/ Nr. 127. Regj. Sekret./ Tiranë, 25.8.1992./ Urdhër për mbylljen e aktivitetit të Shkollës “Skënderbej”.

Për të gjetur zbatim të plotë sipas afateve, Vendimi Nr. 3, datë 14.8.1992 i Këshillit të Mbrojtjes dhe Urdhri Nr. 159 datë 17.8.1992 të Ministrit të Mbrojtjes “Për mbylljen e Shkollës së Mesme Ushtarake ‘Skënderbej’, urdhërojmë: 1- Brenda datës 18.8.1992, të merren në ruajtje ambientet e shkollës nga truproja e Reparti Ushtarak Nr. 2350 në Tiranë./ 2- Sektori i prapavijës dhe dega mësimore e shkollës të verifikojnë gjendjen fizike të ambienteve, kabineteve, laboratorëve dhe bazës tjetër materiale teknike dhe të dërgojnë në Ministri, në Drejtorinë e Logjistikës, evidencën e materialeve./ 3- Shefi i personelit, i financave dhe dega mësimore të përgatisin dokumentacionin shkollor (dëftesat, etj.) dhe trajtimin financiar për skënderbegasit dhe brenda datës 10 shtator t’i dërgojnë ato pranë degëve ushtarake të rretheve./ 4- Shefi i personelit dhe financës, brenda datës 19.8.1992 të dërgojnë në Ministrinë e Mbrojtjes, Drejtorinë e Personelit dhe Organizimit, listën e kuadrove ushtarake sipas specialiteteve dhe deri në datën 15.9.1992, të përgatit dokumentacioni për daljen në asistencë të personelit mësimdhënës dhe punonjësve civilë të shkollës./ 5- Ky urdhër të punohet me të gjithë efektivin e shkollës brenda datës 17.8.1992/ 6- Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet shefi i degës mësimore dhe shefat e shërbimeve sipas përkatësisë./ Komandanti/ Kolonel Petrit Malaj/ (Firma, vulë).

JETË, PËRTEJ UNIFORMËS USHTARAKE....



NËNKOLONEL ALBAN KURTI

KAPITEN MARJANA KOTARJA

Të duash një ushtarak do të thotë të duash një hero të përditshëm!

Të qenit ushtarak është një profesion që kërkon shumë përkushtim dhe shpesh na ndan nga të dashurit tanë, veçanërisht në raste të veçanta si ky. Megjithatë, kjo ditë mbetet e rëndësishme, pasi më kujton sa e vlefshme është dashuria dhe sa shumë rëndësi ka për të mbajtur lidhjet e forta, edhe në distancë.

Intervistoi:

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

Shpeshherë, parë nga larg nën uniformën e gjelbër dhe staturën ‘hijerëndë’ që iu jep madhështia e saj, na krijojnë përshtypjen e njerëzve të hekurt. Por ushtarakët janë njerëz si gjithë të tjerët, kanë ndjenja, dashuri dhe lidhje të forta emocionale. Prandaj, pavarësisht sfidave, shumë prej tyre gjejnë mënyra për të shprehur dashurinë dhe për të festuar ditët e veçanta në mënyrën e tyre. Ushtarakët shpesh janë të angazhuar në misione, në zona lufte ose në detyra të largëta, që i pengon të jenë pranë të dashurve të tyre në ditë romantike.

Në kulturën ushtarake, emocionet personale shpesh vendosen në plan të dytë për shkak të përkushtimit ndaj detyrës dhe disiplinës.

Ushtarakët shpesh perceptohen si njerëz të përmbajtur dhe të fokusuar në misionin e tyre, prandaj ideja e tyre duke festuar një ditë romantike mund t’i befasojë disa.

Për të na treguar më shumë për dashurinë, këtë ndjenjë sublime, sakrificat në rrugëtimin e tyre të përbashkët për gazetën “Ushtria”, kapiten Marjana Kotarja dhe nënkolonel Alban Kurti, sjellin një pjesë të jetës bashkëshortore.

Faleminderit që pranuat të flisni me ne sot! Si një ushtarak, si e përjetoni Ditën e të Dashuruarve, sidomos kur jeni larg familjes?

Nënkolonel Albani: Përhëndetje dhe faleminderit për mundësinë që na jepni, që nëpërmjet shtypit ushtarak, të shprehim dhe ndjenjat tona, për ata që janë suportuesit tanë në këtë rrugëtim të vështirë, nën uniformën ushtarake. Të qenit ushtarak është një profesion që kërkon shumë përkushtim dhe

shpesh na ndan nga të dashurit tanë, veçanërisht në raste të veçanta si ky. Megjithatë, kjo ditë mbetet e rëndësishme, pasi më kujton sa e vlefshme është dashuria dhe sa shumë rëndësi ka për të mbajtur lidhjet e forta, edhe në distancë.

Si ia dilni të mbani gjallë romancën, kur jeni larg për shkak të detyrës?

Nënkolonel Albani: Teknologjia na ndihmon shumë në këtë aspekt. Komunikojmë përmes mesazheve, video-thirrjeve apo edhe letrave kur është e mundur. Gjithashtu, përpiqemi që, sa herë që jemi bashkë, ta bëjmë kohën sa më cilësore. Më ka ndodhur që të dërgoj dhurata surprizë nga larg, për t’i treguar partneres sime se, edhe pse fizikisht nuk jam aty, ajo është gjithmonë në mendjen dhe zemrën time.

A mendoni se të qenit ushtarak ndikon në mënyrën si e shprehni dashurinë?

Nënkolonel Albani: Patjetër. Të qenit në një profesion si ky më ka mësuar të vlerësoj më shumë momentet me të dashurit e mi dhe të jem më i ndërgjegjshëm për kohën që kalojmë së bashku.



Kur ke pak mundësi për të qenë pranë personave të zemrës, çdo moment bëhet më i çmuar dhe dashurinë e shpreh ndoshta më thellë, jo vetëm me fjalë, por edhe me veprime të vogla që kanë shumë domethënie. **A keni ndonjë mesazh për ata që kanë partnerë ushtarakë dhe e ndiejnë mungesën e tyre në Ditën e të Dashuruarve?**

Nënkolonel Albani: E kuptoj shumë mirë se sa e vështirë është të ndash jetën me dikë që është shpesh larg për shkak të detyrës. Por do t'u thosha që dashuria nuk matet me kilometrat. Mbështetja, mirëkuptimi dhe besimi janë baza për ta bërë lidhjen e fortë. Dhe më besoni, edhe ne ushtarakët e ndiejmë po aq mallin dhe dashurinë për ata që kemi larg.

Si jeni njohur ju me partneren tuaj?

Nënkolonel Albani: Ah, është një histori e veçantë për ne! Jemi njohur krejt rastësisht. Unë isha në një periudhë trajnimi dhe kisha një fundjavë të lirë. Një mik më ftoi në një kafene dhe aty ishte edhe ajo, (bashkudhëtarja e jetës sime) me disa shoqe. Fillimisht bëmë një bisedë të thjeshtë, por kishte diçka tek ajo që më tërhoqi menjëherë, thjeshtësia dhe buzëqeshja e saj.

Kush e bëri hapin e parë?

Nënkolonel Albani: Duhet ta pranoj që isha unë! Më pëlqeu energjia e saj dhe guxova t'i kërkoj numrin. Ajo qeshi dhe më tha: "Ushtarakët qenkan të vendosur, apo jo?" (qesh). Kështu filluam të flasim më shpesh dhe kuptuam se kishim shumë gjëra të përbashkëta.

Çfarë ndodhi më pas?

Nënkolonel Albani: Fillimisht nuk ishte e lehtë, sepse shërbimi më kërkonte të largohesha shpesh. Por ajo më kuptoi dhe më mbështeti në çdo hap. Kjo më bëri ta dua edhe më shumë. Çdo herë që kthehesha, ishte si një fillim i ri për ne. Tani, sa herë që jemi bashkë, e vlerësojmë çdo moment.

Faleminderit që ndatë këtë histori me ne! Urojmë që dashuria juaj të mbetet gjithmonë e fortë!

Nënkolonel Albani: Faleminderit juve! Dashuria është forca më e madhe, qoftë në distancë apo afër!

Jeta në një familje ushtarake me siguri ka sfidat dhe bukuritë e saj. Si është të bashkëjetosh me dikë që është pjesë e ushtrisë?

Kapiten Marjana: Është një përvojë unike, me shumë emocione dhe sfida. Nga njëra anë, ndiej krenari të madhe për partnerin tim dhe sakrificat që bën për vendin. Nga ana tjetër, ka momente të vështira, sidomos kur ai duhet të largohet për periudha të gjata. Nuk është e lehtë të menaxhosh mungesën, por me kohën mësohesh dhe gjen mënyra për ta bërë lidhjen të funksionojë.

Si ndikon disiplina ushtarake në jetën e përditshme familjare?

Kapiten Marjana: (Qesh) Oh, ndikon shumë! Ata janë shumë të organizuar, çdo gjë ka vendin e vet dhe respektojnë një rutinë strikte. Ndonjëherë më duket sikur edhe në shtëpi funksionojmë sipas një "regjimi" të vogël ushtarak! Por kjo ka edhe anën pozitive, shumë përgjegjësi dhe përkushtim ndaj familjes. Për shembull, ai është gjithmonë i përpiktë, i përkushtuar dhe e merr seriozisht çdo detyrë, qoftë në ushtri apo në familje.

Po për fëmijët, si është të rriten në një familje ushtarake?

Kapiten Marjana: Fëmijët rriten duke parë një model disipline dhe përkushtimi. Nga njëra anë, ndonjëherë ndiejnë mungesën e babait ose nënës në raste të veçanta, por nga ana tjetër, mësojnë të jenë të pavarur, të fortë dhe të respektojnë vlerat e sakrificës dhe shërbimit. Ata e kuptojnë që prindi i tyre ka një mision dhe kjo i bën krenarë.

Si e kaloni kohën kur jeni të gjithë bashkë?

Kapiten Marjana: Çdo moment bashkë është i shenjtë. Përqijemi të kalojmë kohë cilësore, të bëjmë aktivitete familjare, të dalim në natyrë ose thjesht të shijojmë qetësinë e shtëpisë. Për ne, edhe momentet e vogla kanë shumë vlerë, sepse e dimë që ndonjëherë koha bashkë mund të jetë e kufizuar.

Cili është sekreti për ta mbajtur familjen të fortë, pavarësisht sfidave?

Kapiten Marjana: Besimi, komunikimi dhe durimi. Nuk është e lehtë të jetosh me dikë që mund të largohet



në çdo moment për detyrë, por kur ka dashuri dhe mirëkuptim, çdo sfidë mund të kalohet. Dhe mbi të gjitha, gjithmonë duhet të mbështesësh njëri-tjetrin, kjo është forca që e mban familjen të bashkuar.

Cili është mendimi i parë që ju vjen në mendje kur e shihni të veshur me uniformë?

Kapiten Marjana: Mendoj për gjithë rrugëtimin e tij, për sfidat dhe përkushtimin që kërkon kjo punë. Më kujtohet momenti i parë kur e pashë me uniformë dhe ndjeva një ndjenjë sigurie, si dhe një respekt të madh për të dhe për të gjithë ata që mbajnë atë uniformë me dinjitet.

Uniforma e ndryshon mënyrën si e shihni atë si person?

Kapiten Marjana: Në një farë mënyre, po. Kur është në rrobat e përditshme, është njeriu im i dashur, ai që qesh, bën shaka dhe ndan momentet më të bukura me mua. Kur është me uniformë, duket më serioz, më i përqendruar dhe më i fortë. Është sikur përfaqëson një ideal më të madh se vetja. Por pavarësisht uniformës, ai është i njëjti person që unë dua dhe admiroj çdo ditë.

A ka ndonjë moment të veçantë që ju ka mbetur në mendje kur e keni parë me uniformën e tij?

Kapiten Marjana: Po, një moment që nuk do ta

harroj kurrë ishte dita kur u gradua. Kur e pashë me uniformën e re, të rregullt dhe plot krenari në sy, ndjeva një lumturi të madhe. Ishte një moment që më bëri të kuptoj sa shumë ka punuar dhe sakrifikuar për atë që është sot.

Sa e vështirë është të duash dikë që vesh këtë uniformë dhe që shpesh është larg për detyrë?

Kapiten Marjana: Nuk është e lehtë, por kur dashuria është e fortë, gjithçka bëhet e mundur. Ka net kur mungesa ndihet shumë, por më ngushëllon fakti që ai po bën diçka të rëndësishme. Dashuria dhe mirëkuptimi janë çelësi për ta përballuar këtë jetë. Çfarë do t'i thoshit partnerit tuaj nëse do ta lexonte këtë tani?

Kapiten Marjana: Do t'i thosha: "Jam krenare për ty, për atë që përfaqëson dhe për forcën që ke. Edhe kur je larg, unë jam gjithmonë pranë teje. Të dua dhe do të pres gjithmonë me të njëjtën dashuri".

Faleminderit shumë për ndarjen e kësaj përvojë të veçantë! Ju urojmë shumë lumturi dhe forcë!

Kapiten Marjana: Faleminderit juve! Familjet e ushtarakëve janë si një skuadër, bashkë mund të përballojmë çdo sfidë!

Të duash një ushtarak do të thotë të duash një hero të përditshëm!

INTERVISTA

Prof. asoc. dr. Teki Ali Kurti



PA ARKIV NUK KA HISTORI, PA HISTORI NUK KA KOMB

Baza për krijimin e Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, ishin dokumentet me karakter ushtarak të hartuara nga formacionet politike dhe ushtarake të vendit gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, si dhe ato të veprimtarisë së Forcave të Armatosura Shqiptare në dy dekadat e para të pasçlirimit.

Sot Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura disponon rreth 537 fonde arkivore, ku totali i dokumenteve është afërsisht 4,630 m/l, ku përfshihen fonde arkivore administrative dhe të klasifikuara, gjithashtu Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura administron 326 copë flamuj luftarak, 3735 fletë harta topografike të paplotësuar, si dhe në sektorin e Digjitalizimit, Restaurimit dhe Fototekës administrohen 2219 bobina, 249 shirita incizimi, 12 copë filma rikuanicione, 28,788 copë foto digjitale, 28,503 foto letër, dhe 56 copë albume.

Intervistoi:

Shefe e Sektorit të Botimeve,

ANJEZA MUSOLLARI

Për të herë të parë është kryer procesi i deklasifikimit masiv të dokumenteve që përmbajnë informacion të klasifikuar, si më poshtë: Dokumente të personel-organizimit, 1945-1993, dokumente të arsimimit ushtarak, 1945-1993, dokumente të degëve ushtarake për 28 rrethe, dokumente teknike të hartografisë ushtarake, deklasifikim periodik sipas kërkesave të veçanta të paraqitura nga institucione shtetërore dhe publike; Fondi i Komitetit Qendror të PPSH-së, Drejtoria Politike, dokumente të informacionit të klasifikuar, niveli “tepër rezervat”, “rezervat”, “tepër sekret” dhe “sekret”, për vitet 1946-1974.

Kush është Drejtori i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, që prej një dekade drejton këtë institucion?

Prof. asoc. dr. Teki Ali Kurti ka lindur në fshatin Gjon të Martaneshit, më 25 prill 1966. Është diplomuar në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Në vitet 2000-2006 ka qenë për dy mandate rresht i zgjedhur si kryetar në organet e qeverisjes vendore. Në vitin 2005 mori gradën shkencore “Master” në fushën e historisë, me temën “Mbi strukturën kushtetuese dhe veprimtaritë institucionale të Republikës së Italisë dhe të Republikës së Shqipërisë”. Në vitin 2010 mori gradën shkencore “Doktor” në fushën e historisë, pranë Universitetit të Tiranës, ku mbrojti temën “Institucionet dhe Qeverisja Vendore në Shqipëri 1912-1939”. Në vitin 2014 mori titullin “Profesor i Asociuar” pranë Universitetit të Tiranës. Në vitin 2007 ka përfunduar studimet pasuniversitare pranë Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, e hapur në Shqipëri me mbështetjen e Këshillit të Europës. Po në këtë vit ka kryer kursin për Demokraci në Strasburg-Francë, drejtuar nga Terry Davis, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Nga viti 2007 e në vazhdim është lektor i jashtëm pranë Universitetit të Tiranës dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Gjithashtu është lektor në shkolla e universitete private, si brenda ashtu dhe jashtë vendit.



Është autor i disa botimeve në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit. Është kryetar i Bordit të revistës “Buletini Arkivor Ushtarak”, Botim i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura. Ka organizuar dhe drejtuar dy konferenca shkencore për trevën e Martaneshit, në bashkëpunim me Qendrën e Studimeve Albanologjike, si dhe ka realizuar një dokumentar për këtë trevë.

Aktualisht kryen detyrën e Drejtorit të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura në Ministrinë e Mbrojtjes. Është anëtar i Këshillit të Lartë të Arkivave të Republikës së Shqipërisë dhe anëtar i Asamblesë së Institutit Shqiptar të Sociologjisë.

Drejtor, mund të na bëni një përmbledhje të shkurtër të historikut të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura?

Baza për krijimin e Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, ishin dokumentet me karakter ushtarak të hartuara nga formacionet politike dhe ushtarake të vendit gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, si dhe ato të veprimtarisë së Forcave të Armatosura Shqiptare në

dy dekadat e para të pasçlirimit.

Në ditën e Çlirimit të Tiranës, më 17 nëntor 1944, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, me një urdhër dërguar Korparmatës, kërkoi krijimin e një komisioni, ku do të merrte pjesë një anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, që do të merrte në dorëzim të gjitha dokumentet zyrtare të shtetit shqiptar, të ministrive, të bashkive, të kuesturave, të ushtrisë kuislinge, të cilat do të administroheshin prej Forcave të Armatosura. Këto dokumente përbënin bazën e krijimit të fondit arkivor kombëtar dhe, më pas, të krijimit të institucioneve që do të merreshin me pasurimin, sistemimin, ruajtjen dhe vënien në shfrytëzim të këtyre dokumenteve. Këtë veprimtari para-arkivore, Forcat e Armatosura e ushtruan deri në vitin 1949, ku me Vendim të Këshillit të Ministrave, u krijua Arkivi Qendror i Shtetit.

Këtij arkivi iu ngarkua misioni të grumbullonte dokumente nga lashtësia deri në vitin 1944, si dhe dokumente të institucioneve në veprim, që mbushnin 20 vjet nga data e Çlirimit të vendit (nëntor 1944), të institucioneve që pushonin veprimtarinë e tyre dhe

nuk vazhdonin të ushtronin këtë veprimtari në një institucion tjetër, të personave publikë me rëndësi (pas vdekjes së tyre) dhe të dokumenteve që flisnin për historinë e vendit tonë që ndodheshin jashtë vendit.

Në vitin 1961, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 21.04.1961, në kuadër të “Riorganizimit të Arkivave Shtetërore”, në Ministrinë e Mbrojtjes organizohet Arkiva e Përkohshme.

Më Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 89, dt. 21.03.1964 u zyrtarizua për herë të parë si institucion më vete Arkivi i Ministrisë së Mbrojtjes, me vendndodhje në Ministrinë e Mbrojtjes së asaj kohe. Në vitin 1983, Arkivi Qendror i Ushtrisë (AQU) del institucion autonom në varësi të Ministrit të Mbrojtjes. Ndërsa në vitin 1994, Arkivi Qendror i Ushtrisë (AQU) transferohet nga godina në zonën e Ali Demit në garnizonin e shkollës së lartë të bashkuar të oficerëve “Skënderbej”, ku ndodhet edhe sot. Në viti 1999 emërtohet Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, emër që e mban aktualisht.

Cili është organizmi i AQFA-së sot?

Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura ka në strukturë 8 (tetë) sektorë, si më poshtë:

- Sektori i Ruajtjes dhe Administrimit të Dokumenteve
- Sektori i Dokumenteve të Klasifikuara
- Sektori i Përpunimit të Dokumenteve
- Sektori i Komunikimit dhe Shfrytëzimit të Dokumenteve
- Sektori i Digjitalizimit, Restaurimit dhe Fototeka
- Sektori i Inspektimit dhe Trajnimeve
- Sektori i Sekretarisë dhe Arkivit
- Sektori i Financës dhe Shërbimeve

Arkivi ka një personel të kualifikuar prej 26 (njëzet e gjashtë) punonjësish.

Cili është misioni i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura?

Misioni kryesor i AQFA-së është pranimi, ruajtja, administrimi, përpunimi tekniko-shkencor dhe vënia në shfrytëzim, për interesa studimore a private, të dokumenteve që janë krijuar e krijohen gjatë veprimtarisë në rrjetin arkivor të FA-së, të cilat shpallen me rëndësi historike kombëtare. Njëkohësisht AQFA-ja kontrollon zbatimin e Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat” dhe jep ndihmë metodike në sekretari, sekretari- arkiva e arkivat e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të

Përgjithshëm të FA-së, komandave, njësive, reparteve dhe institucioneve në vartësi të tyre.

Gjatë periudhës Tuaj si drejtues i AQFA-së, cilat kanë qenë disa nga arritjet kryesore?

Deklasifikimi i dokumenteve

Për të herë të parë është kryer procesi i deklasifikimit masiv të dokumenteve që përmbajnë informacion të klasifikuar, si më poshtë: Dokumente të personel-organizimit, 1945-1993, dokumente të arsimit ushtarak, 1945-1993, dokumente të degëve ushtarake për 28 rrethe, dokumente teknike të hartografisë ushtarake, deklasifikim periodik sipas kërkesave të veçanta të paraqitura nga institucione shtetërore dhe publike; Fondi i Komitetit Qendror të PPSH-së, Drejtoria Politike, dokumente të informacionit të klasifikuar, niveli “tepër rezervat”, “rezervat”, “tepër sekret” dhe “sekret”, për vitet 1946-1974. Gjithsej 2172 dosje; Informacioni i klasifikuar, prodhuar nga komitetet e partisë në ushtri, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, komandat, njësitë, repartet dhe institucionet në varësi të tyre, për titullim, gradim, emërim, transferim, lëvizje, vënie në dispozicion, dalje në rezervë, dalje në lirim, dalje në pension, dalje në asistencë të kuadrit oficerë, nënoficerë, rezervistë dhe punonjës civilë; Dokumente nga Fondi i Sekretariatit, (Sektori i Përgjithshëm), Shtabi i Përgjithshëm, Drejtorisë Operative dhe Stërvitjes, Drejtorisë së Organizim Mobilizimit vitet 1954-1994. Në zbatim të VKM nr. 487, datë 17.10.1994, “Për kalimin e Fondit Arkivor të Këshillit të Mbrojtjes nga Arkivi i Shtetit te Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura”, pas 26 vitesh, në vitin 2020, më nismën e AQFA, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, ky fond u bë pjesë e fondeve të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura. Këto dokumente tashmë janë të hapura, në dispozicion të studiuesve si dhe studenteve të masterit e doktoraturës.

Puna për deklasifikim vazhdon dhe sot, ku është përgatitur bibliografia e të gjithë fondeve arkivore të drejtorive të Ministrisë së Mbrojtjes të dokumenteve të klasifikuar “Sekret shtetëror” përpara vitit 1991, të cilat priten të kalojnë në Komisionin e Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit.

Shërbimi arkivor

Në zbatim të legjislacionit për të drejtën e informimit, shërbimit arkivor, transparencës dhe



anti-korrupsionit, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (AQFA) ka shërbyer dokumente sipas kërkesave: të qytetarëve (ushtarakë aktivë, ish-ushtarakë e punonjës civilë të FA-së), të Qendrës së Personel Rekrutimit (për plotësimin e dosjeve të ushtarakëve dhe për efekt llogaritje të përfitimeve për dalje në pension), të studiuesve (vendas dhe të huaj) apo institucione të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe është punuar për përmirësimin

e shërbimit arkivor, duke ofruar publikimin në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes (online) të të gjitha shërbimeve dhe tarifave përkatëse. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 153, datë 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 1.1.2020", Arkivi Qendror i FA-së ka filluar implementimin e 17 shërbimeve online në platformën e-Albania nëpërmjet dy sistemeve

SQDNE (Sistem shkëmbimi kërkesë-përgjigje midis AQFA dhe institucioneve) dhe AMS (Sistem shkëmbimi kërkesë-përgjigje midis AQFA dhe çdo qytetari). Çdo qytetar apo institucion mund t'i drejtohet për informacion elektronikisht AQFA-së në lidhje me 17 shërbimet e listuara në sistem dhe të marrë përgjigje brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj.

17 shërbimet që ofron AQFA janë këto:

1. Aplikim për dokumente të ushtrive të huaja në Shqipëri.
2. Aplikim për dokumente të veprimtarisë politike të partisë shtet në FA.
3. Aplikim për dokumente të veprimtarisë së brigadave, komandave dhe divizioneve partizane.
4. Aplikim për fotokopje dokumentesh të fondeve arkivore për efekt studimi ose botim, si dhe shërbimi të kuadrit ushtarak dhe civil në Forcat e Armatosura.
5. Aplikim për fotokopje dokumentesh të karakterit historik për krijimin, veprimtarinë dhe suprimimin e strukturave të Forcave të Armatosura.
6. Aplikim për manuale dhe rregullore të veprimtarisë ushtarake në FA.
7. Aplikim për shtypin ushtarak.
8. Fotokopje dokumentesh mbi gradime, titullime, emërim, transferime dhe largime nga detyra të personelit ushtarak dhe civil në FA.
9. Fotokopje dokumentesh mbi kryerjen e shërbimit ushtarak.
10. Fotokopje dokumentesh për dërgim me shërbim, studime, kualifikim jashtë vendit.
11. Fotokopje dokumentesh për përfitime strehimi dhe dokumente teknike të objekteve ushtarake.
12. Fotokopje dokumentesh për të dhëna nga dosjet personale për ushtarakët në FA, para vitit 1971.
13. Fotokopje dokumentesh teknike (gentplane, planimetri, etj.) për repartet dhe objektet ushtarake.
14. Fotokopje të programeve mësimore të shkollave

të larta ushtarake.

15. Kartonë evidence për të dhëna personale të oficerëve rezervistë.

16. Vërtetim dhe lista notash përkryerjen e studimeve në shkollat ushtarake.

17. Vërtetime për ngjarje të jashtëzakonshme të ndodhura në FA.

Në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat, i ndryshuar me ligjin 27/2024, në nenin 29", përcaktohet se Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura kalon në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, duke sjellë që shërbimi online i ofruar nga AQFA, nga data 1 janar 2025, ka kaluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, ku deri më sot për shkak të periudhës tranzitore të kalimit, AQFA po bashkëpunon me DPA-në për kthimin e përgjigjeve për të qenë sa më korrekt me institucionet dhe qytetarët.

Administrimi i dokumenteve

Sot Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura disponon rreth 537 fonde arkivore, ku totali i dokumenteve është afërsisht 4,630 m/l, ku përfshihen fonde arkivore administrative dhe të klasifikuara, gjithashtu Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura administron 326 copë flamuj luftarak, 3735 fletë harta topografike të paplotësuar, si dhe në sektorin e Digjitalizimit, Restaurimit dhe Fototekës administrohen 2219 bobina, 249 shirita incizimi, 12 copë filma rikuanicione, 28,788 copë foto digjitale, 28,503 foto letër, dhe 56 copë albume.

Është kryer me urdhra të Ministrit të Mbrojtjes përthithja e dokumenteve të reparteve të suprimuara ndër vite, të cilat rrezikonin zhdukjen fizike. Ndër më kryesoret janë: Komanda e Forcës Tokësore, Forcës Detare, Mbështetëse, e Doktrinës dhe Stërvitjes, si dhe Reparteve Ushtarake Nr. 6630, dhe Nr. 6640 kanë dorëzuar dokumentet e ish - Reparteve Ushtarake, ku janë përthithur afërsisht 238 m/l.



Janë marrë në administrim dokumente me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), të Qendrës së Radio Zbulimit (Reparti Ushtarak Nr. 6614, 5555), për vitet 2008 - 2009 dhe Sekretarisë së AQFA-së (Reparti Ushtarak Nr. 6622,4407) për vitet 2004-2010, të cilat i shtohen fondeve arkivore me 233 dosje.

Një gjë që është për t'u evidentuar, në AQFA është përthithur për herë të parë, pas gati 80 vitesh, lënda arkivore në fotografi dhe video nga njësitë e repartet e Forcave të Armatosura bazuar në ligjin Nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" dhe janë bërë pjesë e Arkivit Qendror të FA-së, si më poshtë:

- Foto digjitale, gjithsej 29.071 foto.
- Video digjitale me USB dhe DVD, gjithsej 90 video.

- Kasketa VHS, gjithsej 29 kaseta.

- Foto nga veprimtari të ndryshme të Forcave të Armatosura, gjithsej 20.102 foto.

Cilat kanë qenë aktivitetet dhe bashkëpunimet më të rëndësishme të kryera ndër vite?

- Botimi periodik i Buletinit Arkivor Ushtarak; ekspozitë me dokumente arkivore në raste përvjetorësh të FA-së;

- Vizitë pune nga ekipi i arkivave të Forcave të Armatosura Turke dhe të Emirateve të Bashkuara Arabe;

- Marrëveshje për bashkëpunim në fushën e botimeve dhe shfrytëzimin e fondeve arkivore. Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura dhe Instituti i

Akademisë së Studimeve Albanologjike lidhën marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre me qëllim nxitjen e kërkimit shkencor në fushën e studimeve albanologjike, me fokus studimet historike të Shqipërisë dhe Kosovës, si prioritete kyçe për të dy institucionet.

- Pjesëmarrës si përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes në takimin ndërinstitucional, me qëllim njohjen dhe plotësim e dokumentacionit hartografik, për periudhën 1934-1942 të Republikës së Shqipërisë, në Institutin Gjeografik Ushtarak të Firences, Itali.
- Vizita të studentëve të nivelit master të degës së Historisë, Universiteti i Tiranës;
- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe me strukturat e Forcave të Armatosura për metodologjinë e punës me dokumentet, si dhe kualifikimin e personelit;
- Bashkëpunim me drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore të qarqeve, për shërbimin arkivor të dokumenteve të kërkuara, për ushtarakët e punonjësit civilë të FA-së, si dhe për dorëzimin pranë këtyre drejtorive të gjithë listëpagesave që gjendeshin në fondet arkivore, të cilat kaluan në procesin e inventarizimit.
- Ekspozitë fotografike dhe dokumentare me rastin e 60-vjetorit të krijimit të AQFA-së, 80-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, 25-vjetorit të Çlirimit të Kosovës dhe 15-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.

Ç’punë është bërë për digjitalizimin e Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura? Cilat janë planet për të ardhmen?

Në përmbushje të misionit të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura janë vendosur prioritete dhe janë hartuar kërkesat për projekte të investimeve për modernizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Inovacionit dhe Automatizimit në Ministrinë e Mbrojtjes u arrit miratimi i projektit “Sistemi i digjitalizimit të fondeve të arkivore”. Sot janë vënë në përdorim pajisjet elektronike dhe linja e internetit në sektorin e informacionit, për implementimin e shërbimeve arkivore online në portalin e-Albania nëpërmjet “Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me nënshkrim Elektronik”.

Prioritet i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, në përmbushje të misionit të tij, dhe rritjes së cilësisë



së shërbimit arkivor ndaj publikut, mbetet zbatimi i projektit “Sistemi i digjitalizimit të fondeve të arkivore”.

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2024”, janë ndjekur procedurat për Planifikimin Buxhetor Afatmesëm për shpenzimet operative dhe prioritetit të projekteve për investime, ku Arkivi Qendror i janë përcaktuar fondet për “Digjitalizimin e Dokumenteve Arkivore”, si më poshtë:

- Për vitin 2024: 68,392,000 lekë
- Për vitin 2025: 137,568,000 lekë
- Për vitin 2026: 137,568,000 lekë

Për shkak të ndryshimeve në ligjin “për Arkivat”, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura ka kaluar në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, ku është strukturuar në një sektor të kësaj drejtorie me emërtesën “Sektori i Forcave të Armatosura”, të cilët do të administrojnë të gjithë dokumentacionin e administruar më parë nga AQFA, përveç dokumenteve teknike të tipologjisë së veçantë të armatimit, pajisjeve teknologjike ushtarake të Forcave të Armatosura, të cilat mendohet se do të administrohen nga Arkivi Qendror në Veprim, ku Ministri i Mbrojtjes po jep mbështetjen maksimale për krijimin e këtij arkivi.



**Bëhupjesë
Forcat E Armatosura
Karrierë Ushtarake
FA Shqiptare**



BASHKOHU FAMILJES SË MADHE FA

Forcat Speciale, 13 janar deri më 31 janar, çelin aplikimin për kursin Special

<https://www.mod.gov.al/>

REVISTA "MBROJTJA"

botim i Ministrisë së Mbrojtjes

